NË KËTË NUMËR LEXONI


3 Serbia si peng i Kosovës

Lajme 2

Milazim Krasniqi: Serbia si peng i Kosovës 3

Intevistë me kryetarin e OEK -ut, Besim Beqajn ..4-6

Koço Danaj: Pse jemi të "dënuar" të bashkohemi ...7-8

Avni Avdiu: Eksperimenti për krijimin e vetë kënaqësisë maqedonase 9-10

Fadil Maloku: Cilat janë mundësitë e anëtarësimit të Kosovës në BE? 10-11

Fitim Veliu: Kur reformat në arsim bëhen me diktat 12

Erblin Zhubi & Gëzim Qerimi: Studentët e Prishtinës njihen me strategjitë dhe planet e BE 13

Sead Ujkani: Nuk ka vend për panik 14

Iljasa Salihu: Urtësia e ndalimit të kamatës 15

Emine A. Vezaj: Emocionet si pjesë përbërse të njeriut 16-17

Demir Reshiti: Po vjen BE-ja... 18-19

Osman D. Gashi: Kush do të na udhëheqë? 20-21

Fitim Flugaj: Kremtimi i Vitit të Ri mes legjendës dhe të vërtetës 22-23

Muhamed Jusufi–Kajolli: Kur'ani kishte paralajmëruar për fitoren e Bizantit ndaj Persisë 24-25

Hamza Jusuf: Islami, si një traditë progresiste 26

Mehmet Shkëmbi: Atentati që trazoi Lindjen e Mesme 27-28

Nijazi Ramadani: Drithërimat lirike të dashurisë ndaj urrejtjes 29

Flamur Maloku: Diskurs për tokën e braktisur (2) 30-31

Poezi 32

Berat Dakaj: Rezerva e Dorit! 33

Elda Cenalia: Si ta bësh një karrierë në shtëpi si përkthyese 34-35

Arber Zeka: Zhurma, grumbull tingujsh që dëmton 35-36

Mirsad Kuteli: Përçapjet drejt familjes së shëndoshë..37

Artan Bejta & Iliriana Alloqi: Diabeti- 38-39

Fjalëkryqi 40


4 Intervistë me Besim Beqajn


7 Pse jemi të "dënuar"...


10 Cilat janë mundësitë e Kosovës


37 Përçapjet drejt familjes së ...



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 14
19 Janar 2008
Botues
Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor gjuhësor
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redaksisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

KUVENDI MIRATON QEVERINË E RE TË KOSOVËS

Më 9 janar Kosova është bërë me Qeveri të re, e cila do të udhëhiqet nga lideri i PDK-së, Hashim Thaçi. Për miratimin e saj kanë votuar 84 deputetë të përbërjes së re të Kuvendit, e dyta me radhë, që nga vendosja e UNMIK-ut në Kosovë. Kundër miratimit të kësaj Qeverie kanë votuar 22 deputetë, ndërsa 2 kanë qenë të përmbajtur.

Për koalicionin qeveritar, përpos PDK-së, LDK-së dhe minoriteteve, ka votuar edhe partia Aleanca Kosova e Re, e Behgjet Pacollit, i cili këtë qëndrim e ka bërë publik gjatë seancës së Kuvendit.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, pas tri rretheve të votimit, kanë rizgjedhur në postin e kryetarit të Kosovës, Fatmir Sejdiun. Në rrethin e tretë, nga 118 deputetë të pranishëm, Sejdiu ka marrë 68 vota, ndërsa kundërkandidati i tij, Naim Maloku nga AAK-ja, 39 vota, ndërkaq.

Sipas marrëveshjes së koalicionit PDK-LDK, deputetët, kanë zgjedhur edhe kryetarin dhe kryesinë e Kuvendit. Me 88 vota pro, një kundër dhe asnjë abstenim, Jakup Krasniqi nga radhët e PDK-së, është zgjedhur në postin e kreut të Kuvendit.

Në seancën parlamentare është zgjedhur edhe Kryesia e Kuvendit. Nga radhët e PDK-së në kryesi do të jetë Xhavit Haliti, nga LDK-ja, Sabri Hamiti dhe Eqrem Kryeziu, nga AKR-ja, Ibrahim Gashi, nga koalicioni LDD-PSHDK, Nexhat Daci, ndërsa dy anëtarë të tjerë nga pakicat është lënë që të zgjidhen në seancat e ardhshme parlamentare.

Qeveria e re, në krye me Hashim Thaçin është votuar me një proces të hapur votimi. Për kabinetin e ri qeveritar kanë votuar 85 deputetë, 22 kanë qenë kundër dhe katër kanë abstenuar.

Në fjalën e tij, pas miratimit të Qeverisë së udhëhequr prej tij, kryeministri Hashim Thaçi ka falënderuar deputetët e Kuvendit të Kosovës për besimin e dhënë dhe ka thënë se Kosova ndodhet në udhëkryqin më të rëndësishëm të historisë, por me këto institucione tha ai do të përballen me sukses sfidat që e presin.

Të gjitha institucionet e zgjedhura sot burojnë nga rezultati i zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007. Dy partitë kryesore parlamentare PDK më parë kanë nënshkruar marrëveshjen për koalicion, e cila përveç tjerash parasheh një kryetar me mandat të zgjatur në pesë vjet dhe një kryeministër të fuqishëm me të drejtën e emërimit dhe shkarkimit të ministrave. ■

Përbërja e Qeverisë së re:

Ministre e Energjisë dhe e Minierave Justina Pula Shiroka - zv/ministër Blerim Rexha
Ministre e Drejtësisë Nekibe Kelmendi – zv/ministër Arsim Janova
Ministër i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë - Enver Hoxhaj – zv/ministër Agim Hyseni;
Ministër i Shëndetësisë Alush Gashi – zv/ministre Mubera Mustafa;
Ministër i Punëve të Brendshme Zenun Pajaziti – zv/ministër Fatmir Xhelili;
Ministër i Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe i Çështjeve Jorezidente Skënder Hyseni – zv/ministre Lirie Kajtazi;
Ministër i Bujqësisë, Idriz Vehapi - zv/ministër Sylë Sylani;
Ministër i Tregtisë dhe i Industrisë, Lutfi Zharku – zv/ministër Naser Osmani;
Ministër i Pushteti Lokal, Sadri Ferati – zv/ministër Shpend Tërdeva;
Ministër i Ekonomisë dhe i Financave, Ahmet Shala – zv/ministër Bedri Hamza;
Ministër i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Fatmir Limaj – zv/ministër Adem Grabovci;
Ministër i Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami – zv/ministër Rifat Blakaj;
Ministër i Ambientit dhe i Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagicilar – zv/ministër Emin Krasniqi;
Ministër i Kthimit dhe i Komuniteteve Boban Stankoviq;
Ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale Nenad Rashiq;

Larry Rossin, emërohet zëvendësshef i UNMIK-ut

Kreu i OKB-së, Ban Ki Moon, ka emëruar amerikanin Lary Rossin si zëvendësshef të UNMIK-ut. Rossin zëvendëson në këtë post gjeneralin amerikan, Stiven Shuk, i cili u largua nga detyra më 19 dhjetor. Autoritetet e OKB-së kishin vendosur t'i ndërprisnin kontratën para afatit Shukut, pasi ndaj tij u hapen hetime rreth disa aferave derisa ishte në detyrë. Rossin, 55-vjeçar, e mori detyrën e re dje. Nga viti 2004 deri në vitin 2006 ai ka ushtruar të njëjtën detyrë në Kosovë, ku më pas ishte zëvendësuar nga Steven Schook. Po ashtu ka qenë me të njëjtin mision edhe në Haiti. Para se të punonte për OKB-në, Rossin ka punuar në shërbimin diplomatik amerikan. Ai ka qenë ambasador në Kroaci, ka shërbyer në Këshillin e Sigurimit Kombëtar si dhe ka qenë zëvendësndihmës i sekretarit të Shtetit për çështjet evropiane dhe euroaziatike.



Ana tjetër e medaljes

SERBIA SI PENG I KOSOVËS

Deri tash është provuar se Serbia ka potencial ta dëmtojë Kosovën, por nuk ka potencial ta mposhtë. Po ashtu është provuar se Kosova ka potencial ta mbajë peng Serbinë në të kaluarën e saj të errët, por nuk arrin që e vetme të lirohet prej saj. Kjo do të thotë se nëse mbeten të përballen edhe më tutje sipas modelit serbomadh, do të ketë konflikte, dhunë e jostabiltet



Milazim KRASNIQI

Qëndrimi i përsëritur i kryeministrit të Serbisë, Vojisllav Koshtunicës, sipas të cilit Serbia do t'i refuzojë integrimet evropiane, nëse Bashkimi Evropian pranon një Kosovë të pavarur, është qëndrim që tregon se e ardhmja e Serbisë është peng i Kosovës. Sipas këtij qëndrimi qeveritar, inkuadrimi i Serbisë në strukturat evropiane, nuk varet nga interesi dhe nga vullneti i qytetarëve të saj, e madje nuk varet as nga pozita dhe rrethimi gjeografik i Serbisë. E shndërruar në njërin nga shtetet më të varfra të Ballkanit, edhe pse e rrethuar në pjesën më të madhe të kufijve shtetërorë nga shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe e ftuar që t'i bashkohet me përparësi këtij bashkimi, Serbia e sotme paraqet një paradoks sui generis. Ajo refuzon ta përmirësojë gjendjen aktuale ekonomike, sociale dhe kulturore të qytetarëve të vet dhe refuzon ta pranojë kooperimin me fqinjët e vet që janë anëtarë të bashkimit më të fuqishëm ekonomik në botë, vetëm për shkak të një perceptimi mitologjik të historisë së vet të kaluar. Por, ngatërrimi në këtë pezhishkë të së kaluarës dhe të së harruarës, nuk i ka ndodhur vetëm qeverisë serbe. Edhe më e rëndë paraqitet gjendja e perceptimit mitologjik të realitetit nga ana e Kishës Ortodokse Serbe, e cila edhe në mesazhin e fundit të Krishtlindjeve ka përdorur një gjuhë edhe më korrozive se ajo e nacionalistëve radikalë serbë. Në këtë mesazh, ndër tët tjera thuhet se "për tokën tonë të shenjtëruar llazariane, të fuqishmit e kësaj bote po e hedhin ashtin, ashtu sikundër e hodhën ashtin të pabesët për veladonin e Krishtit dhe në mënyrë të paturpshme po fyejnë ndjenjat tona dhe krenarinë tonë, duke e rrezikuar qenien tonë, drejtësinë e Zotit, drejtësinë e vërtetë njerëzore dhe të drejtat e njeriut…". Fjalor të këtillë antievropian kanë përdorur dinjitarët e kësaj kishe edhe në vitet nëntëdhjetë, kur i bekonin terroristët serbë që niseshin në ekspedita masakruese kundër civilëve në Kroaci, në Bosnjë e në Kosovë.

Sille nga ta sillesh, mendimi dhe veprimi politik e fetar serb kanë mbetur peng i të kaluarës së vet të errët, gjë që provohet edhe nga evokimi i ngjarjeve të kaluara. Fjala vjen, një betejë e humbur me turp në Kosovë në vitin 1389, ende mbahet si ngjarje kulmore, nga e cila paskësh lindur "toka e shenjtëruar e Llazarit" dhe "Jerusalemi serb" dhe se aty qenkësh ngurtësuar dhe paskësh mbetur peng historia serbe për jetë të jetëve. Edhe ngjarje të mëvonshme si dy luftërat pushtuese ballkanike, kolonizimet e "viseve jugore" nga shteti serb, terrori i Rankoviqit dhe dëbimi i shqiptarëve nga vatrat e veta në vitet pesëdhjetë e gjashtëdhjetë të shekullit XX, janë ngjarje që kanë në vete farën e kompleksit shqiptar të injektuar me mendësinë politike dhe nacionale serbe. Ideja fikse e tyre ka qenë dhe ka mbetur dëbimi i shqiptarëve nga Kosova dhe serbizimi i saj sipas përfytyrimeve mitologjike për "tokën e shenjtëruar me gjakun e Llazarit".

Edhe ngjarjet e ndodhura në muzgun e ish-Federatës Jugosllave e kanë pasur në vete këtë virus nacionalist-mitologjik. Fjala vjen, reagimi me një represion të madh ndaj demonstratave të shqiptarëve në vitin 1981, e kishte synim krijimin e pretekstit për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova. Edhe ngjarja përcaktuese e drejtimit politik në Serbi, Konferenca e Tetë e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë e vitit 1987, në të cilën fitoi Milosheviqi, ka qenë e motivuar nga qëndrimi ndaj Kosovës. Opsioni i atëhershëm ishte "kundër Jugosllavisë, për Kosovën", krejt njësoj si tash që është "kundër Evropës, për Kosovën".

Për shkak të mbetjes peng të fiksionit për Kosovën, Serbia u bombardua nga NATO-ja në vitin 1999, sepse ai fiksion mitologjik për Kosovën si "tokë e shenjtëruar e Llazarit", rezultoi me spastrim etnik dhe me gjenocid të llahtarshëm kundër shqiptarëve.

Nëse mbahet edhe më tutje kjo linjë e mendimit dhe veprimit politik e nacional në Serbi, gjasat janë që Serbia edhe një herë t'i vuajë pasojat e konfrontimit me Perëndimin. Zgjedhjet presidenciale që mbahen gjatë këtij muaji janë edhe një provë që do të tregojë se nga shkon peshorja serbe, nga e kaluara e mbetur peng i përfytyrimeve mitologjike për Kosovën si djepi i serbizmit, apo nga e ardhmja evropiane.

Sidoqoftë, mbetet fakt që Serbia ende është peng i Kosovës dhe kështu do të mbetet derisa të ndodhë një shkëputje finale mes tyre, ngjashëm me operacionin që u bëhet motrave siameze. Deri tash është provuar se Serbia ka potencial ta dëmtojë Kosovën, por nuk ka potencial ta mposhtë. Po ashtu është provuar se Kosova ka potencial ta mbajë peng Serbinë në të kaluarën e saj të errët, por nuk arrin që e vetme të lirohet prej saj. Kjo do të thotë se nëse mbeten të përballen edhe më tutje sipas modelit serbomadh, do të ketë konflikte, dhunë e jostabiltet. Prandaj, zgjidhja e vetme mbetet operacioni ndërkombëtar, i cili i ndan përfundimisht këto dy entitete dhe u mundëson që të projektojnë të ardhmen e vet si shtete të pavarura nga njëra-tjetra. ■

Intervistë me kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Besim Beqaj

Viti 2008 -vit i shpresës për ringjallje ekonomike të Kosovës

- **OEK-u duhet të trajtohet me prioritet nga institucionet;**
- **Politikat ekonomike janë krijuar nga njerëz të cilët nuk e kanë kuptuar biznesin;**
- **Në një të ardhme jo fort të largët, Kosova dhe Shqipëria do të integrohen ekonomikisht;**
- **Kosova vendi më i varfër i rajonit;**

Intervistoi: Demir Reshiti

Ndërlidhja ekonomike e Kosovës me Shqipërinë është e domosdoshme dhe kjo do të ndodhë shumë më lehtë me ndërtimin e rrugës Durrës-Prishtinë, por është detyrë e biznesit, e qeverive dhe e mediave të promovojnë një ndërlidhje të tillë sa më shpejt, ka thënë në intervistën ekskluzive për revistën Paqja, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës Besim Beqaj.

Kreu i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), flet për problemet me të cilat po ballafaqohet aktualisht ekonomia e Kosovës, bashkëpunimin me institucionet vendore e ndërkombëtare, bashkëpunimin me organizatat simotra në rajon, planet për vitin 2008, etj.

OEK-u duhet të trajtohet me prioritet nga institucionet

Paqja: Çfarë statusi ka Oda Ekonomike e Kosovës?

Beqaj: OEK-u është institucion i pavarur, profesional dhe apolitik i rregulluar me Ligjin mbi Odën Ekonomike të Kosovës. Ky ligj i jep OEK-ut autorizime publike si dhe të drejtën e përfaqësimit të punëdhënësve në Kosovë. Kjo e shpjegon faktin se OEK-u nuk është organizatë joqeveritare, siç nganjëherë edhe pretendohet të paraqitet nga mekanizma të ndryshëm.

Unë besoj se OEK-u duhet të trajtohet me prioritet nga institucionet, sepse kështu mund të zhvillohet një partneritet konstruktiv i Qeverisë me biznesin. OEK-u është i obliguar me ligj, por edhe ka kapacitete profesionale dhe njerëzore që t'i ofrojë qeverisë partneritet të mirëfilltë.

Paqja: Si e vlerësoni punën e deritanishme të OEK-ut?



Beqaj: Oda Ekonomike e Kosovës ka qenë e fokusuar në përmirësimin e shërbimeve të saj ndaj biznesit. Përveç se kemi bërë një ristrukturim të përgjithshëm, ne kemi qenë shumë aktiv në dy drejtime, të cilat besojmë fuqishëm se janë forma më e mirë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Kemi bërë një analizë të politikës fiskale dhe nga kjo analizë kemi nxjerrë një propozim konkret në këtë fushë, por fatkeqësisht edhe pse kishim konfirmim nga ish-qeveria, asnjë hap konkret nuk është ndërmarrë në këtë drejtim. Kjo ishte dhe do të mbetet përgjegjësi e MEF-it, e cila pa ndonjë arsye të fortë e ka prolonguar ketë proces.

Perceptimi im ka qenë atëherë dhe është tani se zyrtarët e MEF-it nuk e kanë kuptuar se si mblidhet dhe menaxhohet buxheti, kështu që edhe përkundër shumë bisedave me ta nuk kemi gjetur asnjë lloj gatishmërie për lëvizje pozitive. Kjo fatkeqësisht është argumentuar disa herë me raste konkrete.

OEK-u ka qenë anëtare e grupit negociator për marrëveshjet e tregtisë së lirë (MTL), si dhe për CEFTA-n, andaj në këtë drejtim kemi koordinuar aktivitetet e biznesit dhe kemi paraqitur qëndrimet e tyre lidhur me liberalizimin e tregut. Së bashku me MTI-në, SHDK-në dhe me drejtoritë komunale për ekonomi, u kemi shpjeguar bizneseve marrëveshjen e CEFTA-s nëpër të gjitha rajonet e Kosovës.

Aktivitetet tona lobuese kanë qenë të koordinuara me biznesin dhe në këtë drejtim kemi bërë shumë gjëra në të mirë të biznesit. Kemi kontribuar në propozime dhe amandamentime të ligjeve. Me propozimin tonë kemi filluar procesin e rinegocimit të kontratës kolektive, kemi ndikuar në debllokimin e kufirit me Maqedoninë, me rastin e bllokimit të tij, si pasojë e moskoordinimit qeveritar.

Kemi qenë shumë aktiv në përfaqësimin e shumë rasteve individuale të biznesit dhe njëherësh kemi pasur sukses në krijimin e bashkëpunimit me USAID-in, AER-in, GTZ-në, FMN-në, BB-në, si dhe me shumë zyra diplomatike të akredituara në Kosovë.

Fusha e dytë e angazhimit tonë ka qenë dhe është e orientuar drejt promovimit të biznesit dhe investimeve në Kosovë. Problemet në këtë sferë kanë qenë të shumta, sepse OEK-u nuk ka pasur mundësi të mëdha buxhetore për të investuar në këtë drejtim, por megjithatë suksesi nuk ka munguar.

Politikat ekonomike janë krijuar nga njerëz të cilët nuk e kanë kuptuar biznesin

Pagja: Me çfarë problemesh po ballafaqohet aktualisht ekonomia e Kosovës?

Beqaj: Ekonomia e Kosovës përballet me shumë probleme, sikurse edhe shoqëria në përgjithësi. Këto probleme janë të lidhura ngushtë me mosdefinimin e statusit, por janë edhe pasojë e një qasjeje të pa koordinuar mirë të institucioneve të Kosovës në përgjithësi.

Ekonomia ka përjetuar një vit me kriza të mëdha dhe ngritje të vogël që nga paslufta, edhe pse është shumë vështirë të flitet për rritje reale të ekonomisë, sepse rritja prej 3 për qind nuk është e bazuar në indikatorët e përgjithshëm të rritjes ekonomike. Andaj, rritja ekonomike kryesisht është llogaritur në bazë të konsumit dhe jo në bazë të indikatorëve tjerë siç janë rritja e prodhimit dhe eksportit, rritja e kursimeve dhe e punësimit.

Problemet me të cilat po ballafaqohet ekonomia e Kosovës janë legjislacioni jo i implementueshëm, mosfunksionimi i ligjit i cili ka krijuar favore personale në kundërvlerë të korrupsionit. Kjo sepse politikat ekonomike janë krijuar nga njerëz të cilët nuk e kanë kuptuar biznesin, ndërsa qasja e tyre në këtë drejtim ka qenë shumë frigjide, etj.

Po ashtu probleme tjera janë edhe mungesa e energjisë elektrike dhe e investimeve kapitale, mungesa e infrastrukturës fizike dhe lidhja e Kosovës me vendet e rajonit, si dhe moskoordinimi për tërheqjen e investimeve qofshin të huaja apo vendore. Ndër problemet e rëndësishme është edhe funksionimi shumë i dobët i ATK-së në mbledhjen e tatimeve brenda Kosovës.

Kosova është vendi më i varfër i rajonit dhe së voni është shpallur edhe një nder vendet më të korruptuara. Kjo na tregon se duhet ndryshuar tërësisht qasja ndaj zhvillimit ekonomik. Njerëzit e varfër asnjëherë nuk mund të kontribuojnë për shtetin, sepse prioritet i tyre është mbijetesa.

Prej popullsisë së Kosovës, 50% e tyre, gjatë ditës, javës, muajit dhe vitit, mendojnë vetëm për të siguruar kafshatën e gojës, andaj mund të paramendohet se sa ata janë në gjendje të kontribuojnë për shtetin.

Pagja: Si e shihni daljen nga kjo situatë?

Beqaj: Rritja ekonomike, investimet kapitale, thithja e fondeve zhvillimore dhe ngadalë largimi nga kërkesat për donacione duke marrë përgjegjësitë për qytetarin, punësimin e tij dhe krijimin e perspektivës për të, janë çështje shumë urgjente, të cilat duhet trajtuar nga qeveria e ardhshme me prioritet të lartë dhe me shpejtësi profesionale.

Biznesi i Kosovës është i gatshëm t'i marrë përgjegjësitë e veta për të krijuar mirëqenie dhe zhvillim ekonomik, andaj dalja nga kjo situatë është e mundshme, duke krijuar ambient për investime, duke ndihmuar biznesin për të gjetur tregje, duke kontrolluar shumë rreptë shpenzimet publike, duke ndalur korrupsionin, duke shpenzuar në mënyrë efektive buxhetin, duke ngritur nivelin e shërbimeve publike si dhe duke ngritur nivelin e përgjegjësisë profesionale dhe njerëzore në të gjitha nivelet e shoqërisë së Kosovës.



Pagja: Sa ka ndikuar moszgjidhja e statusit politik në (mos)zhvillimin ekonomik të Kosovës?

Beqaj: S'do mend se çështja e pazgjidhur e statusit politik të Kosovës ka ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik.

Vetë fakti se Kosova nuk është e kualifikuar për fonde zhvillimore të EU-së, se Kosova nuk mund të përfitojë nga institucionet financiare ndërkombëtare, se pamundësia për kontrollin e kufijve të Kosovës hap rrugë për evazion fiskal, se transportuesit i Kosovës nuk kanë mundësi për transport rajonal dhe ndërkombëtar, se asnjë ndërmarrje i Kosovës nuk mund të jetë përfaqësuese ekskluzive dhe ligjore për ndërmarrje ndërkombëtare si dhe mospasja e identitetit ekonomik të Kosovës, tregon se problemet janë të shumta dhe se shumica prej tyre lidhen me definimin e statusit.

Defekti më i madh i institucioneve qeveritare në Kosovë ka qenë se ato kanë konsideruar se shteti, ekonomia, biznesi, shoqëria civile si dhe qytetari është pronë e tyre dhe ata kanë të drejtën që me të hollat e taksapaguesve të krijojnë favore personale në dëm të procesit zhvillimor dhe demokratik.

Pagja: Sa e pengon zhvillimin ekonomik mungesa e infrastrukturës ligjore?

Beqaj: Infrastruktura ligjore ka shënuar një përmirësim të vogël në krahasim me atë se çka do të duhej të ishte. Pavarësisht sugjerimeve shumë aktive të OEK-ut dhe pjesëmarrjes nëpër takime për diskutim të ligjeve, gati asnjëherë nuk janë përfillur sugjerimet e biznesit. Kjo ka ndodhur, sepse në shumicën e rasteve nëpër ministritë përkatëse, krijues të politikave kanë qenë njerëz joprofesionistë, të cilët jo se nuk e kanë kuptuar rëndësinë e implementimit të ligjeve të miratuara, por në shumicën e rasteve me arrogancën e vet kanë pamundësuar që arsyet funksionale të pranohen.

Kjo ka treguar se defekti më i madh i institucioneve qeveritare në Kosovë ka qenë se ato kanë konsideruar se shteti, ekonomia, biznesi, shoqëria civile si dhe qytetari është pronë e tyre dhe ata kanë të drejtën që me të hollat e taksapaguesve të krijojnë favore personale në dëm të procesit zhvillimor dhe demokratik.

Pagja: Sa i ka shkaktuar dëm zhvillimit ekonomik të Kosovës suficiti buxhetor?

Beqaj: Çështja e suficitit buxhetor

është fenomen i veçantë i cili duhet të studiohet nga dikush, sepse Kosova ka pasur vite me radhë suficite buxhetore dhe shpenzime shumë të ulëta për investime kapitale, kur aq shumë ka nevojë për investime në Kosovë.

Kritika më e madhe e biznesit për qeverinë ka qenë se nuk kanë tentuar asnjëherë për t'i kuptuar ata të cilët investojnë në Kosovë, por gjithmonë është folur për gjëra globale, të cilat ishin jashtë realitetit i Kosovës.

Paqja: Cili është bashkëpunimi i OEK-ut me organizatat simotra në rajon dhe më gjerë?

Beqaj: Bashkëpunimi është shumë i mirë. Kemi bashkëpunim me të gjitha Odat e rajonit dhe gjithashtu kemi bashkëpunim edhe me Odat Evropiane. Ky bashkëpunim është i orientuar në promovimin e investimeve në Kosovë dhe në hapjen e mundësive për eksport në rajon dhe më gjerë. Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi me Oden Federale të Austrisë në fushën e trajnimeve profesionale, me Odën e zejtarëve të Dortmundit me Informest nga Italia, me Odën ekonomike të Turqisë, Greqisë etj.

Në një të ardhme jo fort të largët, Kosova dhe Shqipëria do të integrohen ekonomikisht

Paqja: Çfarë raportesh keni me Odën ekonomike të Shqipërisë?

Beqaj: Sikurse ekziston një lloj ngërçi në këto raporte dhe se nuk ka ndonjë mirëbesim të ndërsjellë në këtë proces. Unë isha tani së voni në Shqipëri dhe pata takime me homologun tim dhe me ministrin Ruli, ku diskutuam këtë gjendje dhe u pajtuam se duhet angazhim më i madh institucional dhe biznesor për të rritur nivelin e këmbimeve ekonomike në mes të vendeve tona.



Jemi në përgatitje për të krijuar një trup të përbashkët në mes të biznesit të Shqipërisë dhe Kosovës dhe institucioneve nga të dy vendet, trup ky i cili do të takohej së paku dy herë në vit dhe do të trajtojë problemet dhe mundësitë për ngritjen e bashkëpunimit ekonomik në mes vendeve tona.

Ndërlidhja ekonomike e Kosovës me Shqipërinë është e domosdoshme dhe kjo do të ndodhë shumë më lehtë me ndërtimin e rrugës Durrës-Prishtinë, por është detyrë e biznesit, e qeverive dhe e mediave të promovojnë një ndërlidhje të tillë sa më shpejt. Unë shpresoj se në një të ardhme jo fort të largët, Kosova dhe Shqipëria do të integrohen ekonomikisht, dhe kjo do të ndikojë në integrim kulturor edukativ dhe njerëzor.

Populli shqiptar është populli më i madh në rajon dhe më me perspektivë, sepse kemi një rritje të shpejtë të popullsisë, andaj është përgjegjësi e jona që të krijojmë kushte që gjeneratat e ardhshme të jenë lider në rajon.

Paqja: Çfarë bashkëpunimi keni me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare në Kosovë?

Beqaj: Bashkëpunimi me institucionet vendore në të kaluarën ka qenë mjaft i limituar, por me disa progrese të caktuara, ndërsa tani mendojmë se me kapacitetet e Qeverisë aktuale rritja e bashkëpunimit do të jetë evidente, sepse kabineti qeveritar dhe prioritetet e tyre janë në harmoni me atë qe neve kemi kërkuar më herët nga institucionet tona vendore.

Ndërsa bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare ka qenë në nivel të duhur. Kemi pasur bashkëpunim me AER-in, USAID-in, Bankën Botërore, BERZH-in, GTZ-në, SIDA-n suedeze si dhe me zyrat e jashtme që operojnë në Kosovë.

Kosova vendi më i varfër i rajonit

Kosova është vendi më i varfër i rajonit dhe së voni është shpallur edhe një ndër vendet më të korruptuara. Kjo na tregon se duhet ndryshuar tërësisht qasja ndaj zhvillimit ekonomik. Njerëzit e varfër asnjëherë nuk mund të kontribuojnë për shtetin, sepse prioritet i tyre është mbijetesa.
Prej popullsisë së Kosovës, 50% e tyre, gjatë ditës, javës, muajit dhe vitit, mendojnë vetëm për të siguruar kafshatën e gojës, andaj mund të paramendohet se sa ata janë në gjendje të kontribuojnë për shtetin.

Paqja: Cilat janë planet tuaja për vitin 2008?

Beqaj: Lobimi për përmirësimin e ambientit ekonomik, duke punuar për rritje të konkurrentshmërisë së ndërmarrjeve tona në Kosovë dhe jashtë, është prioriteti i parë, ndërsa prioriteti i dytë është promovimi ekonomik i Kosovës brenda dhe jashtë duke tentuar që të tërheqim investime sa më të mëdha dhe sa më cilësore. Këto aktivitete mendojmë se do të hapin vende të reja të punës dhe se do të jenë kontribut i drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarit të Kosovës.

Paqja: Në fund cili është mesazhi i Juaj për lexuesit të revistës Paqja?

Beqaj: Viti 2008 është vit i shpresës për ringjallje ekonomike të Kosovës, prandaj mesazhi im është t'i përgjigjemi obligimeve shtetërore sa më shumë dhe njëherit të kërkojmë nga të gjitha institucionet punë të palodhshme për të ardhmen tonë dhe të vendit në përgjithësi. Oda Ekonomike e Kosovës është zëri i biznesit në Kosovë dhe ai do të jetë shumë aktiv në përmirësimin e kushteve për biznes të mirëfilltë në vend dhe jashtë. ■

PSE JEMI "TË DËNUAR" TE BASHKOHEMI?!

Bashkimi ndërshqiptar është evropeizëm siç është edhe euroatlantizëm. Shqiptarët duhet ta realizojnë atë, bashkimin midis tyre në këtë fillim shekulli. Përse? …Janë arsye më madhore, janë jetike, para se të jenë thjesht etnike. Janë globaliste para se të jenë thjesht nacionaliste



Koço DANAJ

Shqiptarët janë të dënuar të bashkohen. Janë të tillë në të gjithë hapsirën shqiptare. Janë të tillë në rajonin artificial politik të emërtuar Ballkan Perëndimor.

Por titulli pyetës, është më shumë se një shkrim, është më shumë së një libër; është titull sa një Histori e së shkuarës dhe sa një Vizion i së ardhmes!!

Po përse bashkimi i një kombi konsiderohet si "dënim", kur duhet të jetë tjetër fare. Kur në rastin e shqiptarëve, duhet të jetë siç thotë De Rada: Erdhi Dita e Arbërit?

Përse bashkimi konsiderohet imperativ kur duhet të jetë vullnet? Përse konsiderohet një mision i pamundur, kur duhet të jetë një mundësi si shumë të tjera? Ky është problemi i parë që duhet sqaruar, prandaj le të merremi fillimisht me atë.

-Është normale për një qytetar shqiptar që më shumë të preferojë shijen e jetës se sa stërmundimin e saj. Prandaj edhe ky qytetar përdorë njëmijë e një arsye gjoja objektive për ta bërë të pamundur bashkimin kombëtar. Prandaj edhe ky qytetar thotë se: "Edhe pse është një ëndërr e mrekullueshme ashtu si pershkruhet… është e pamundur. Ndoshta në 100 vjet, kush e di, ndoshta". Ose dikush tjetër shprehet se: "Tani është koha kur duhet të diskutojmë se: A u leverdis shqiptarëve bashkimi?."

-Ka një kategori tjetër qytetarësh që fshihen pas parzmores së integrimit evropian. Dhe në këtë parzmore shkruhet se: Integrimi evropian është kundër bashkimit të kombeve, sepse ai është për asimilimin e tyre. Pra relativizimi i kufirit konsiderohet si asimilim i kombit. Mburoja e integrimit për të penguar bashkimin është teza më e përhapur në mjedisin mbarëshqiptar.

Por në çdo komb, ka qytetarë, por ka edhe politikanë. Shumësia e mendimeve tek qytetarët për një problem kaq madhor, është e pashmangshme. Por kur kjo shumësi nxitet dhe ushqehet nga politikanët e shqiptarëve, problemi bëhet shumë herë më serioz dhe shtrohet se formën e titullit të trajtesës: Jemi të "denuar" të bashkohemi!!

Dhe vijmë kështu tek problemi i dytë madhor. Ajo që është normale për qytetarin, është anormale për politikanin. Qytetari ka të drejtë të mendojë deri tek pragu i shtëpisë. Politikani e ka për detyrë të mendojë përtej pragut të shtëpisë. Qytetari ka të drejtë të mendojë deri në fund të ditës. Ndërsa politikani e ka për detyrë të mendojë e pakta deri në fund të vitit. Qytetari e ka për detyrë të mendojë për jetën, për njeriun, ndërsa politikani e ka për detyrë të mendojë edhe per njerëzimin, për kombin. Qytetari edhe mund të mendojë sipas mentalitetit që pas meje, "flaka i rentë", ndërsa politikani e ka për detyrë të mendojë që pas meje është fati i një shteti, vendi apo kombi të tërë.

Ky përbashkim në identitet dhe kjo ndarje në mentalitet përbën edhe dallimin midis politikanit dhe qytetarit.

Sa kohë që bashkimi shtrohet në formë dënimi, aq kohë, do të thotë se tek shqiptarët ka politikanë, por nuk ka shtresë politikanësh. Ka bashkësi njerëzore, por nuk ka Shoqëri Civile.

Konceptimi i bashkimit, si një "dënim", ka të bëjë edhe me një dukuri të pranishme në mjedisin qytetar dhe politik shqiptar.

Ky është edhe problemi i tretë madhor. Cila është dukuria? Një pjesë e këtij mjedisi i lejon të drejtën vehtes së saj që jo vetëm të shprehet se nuk e do bashkimin. Por ajo i lejon vehtes që të atakojë, të sulmojë, të satanizojë ata që janë pro bashkimit dhe që japin edhe ide, fakte, argumente. Pra i lejon të drejtën vehtes që të përdorë diktaturën e stabilitetit apo te pushtetit ndaj atyre që mendojnë ndryshe.

Ndërsa mjedisi politik shkon edhe më tej. Ai edhe kur vetw nuk është dakord me idenë e bashkimit, edhe kur harron se kjo ide është e shkruar edhe në Preambulën e Kushtetutës së Shqipërisë nuk mjaftohet me kaq. Ai shkon më tej, ai përdor shoqërinë juridike për të denuar partizanët e bashkimit dhe për të trembur simpatizantët e tyre.

Dhe sa kohë që ekziston një mjedis i tillë, aq kohë edhe bashkimi do të konsiderohet si "Dënim". Pra jemi "të denuar" të bashkohemi!!

Po nuk u bashkuam sot, do të sodisim shpërbërjen kombëtare nesër!!

Bashkimi ndërshqiptar është evropeizëm siç është edhe euroatlantizëm. Shqiptarët duhet ta realizojnë atë, bashkimin midis tyre në këtë fillim shekulli. Përse? Thjesht për një nacionalizëm të verbër? Përse? Thjesht sepse kështu kanë bërë edhe të tjerët para tyre? Jo!

Janë arsye më madhore, janë jetike, para se të jenë thjesht etnike. Janë globaliste para se të jenë thjesht nacionaliste.

Në mënyrë figurative, duhet pohuar se po nuk u shtrua sot bashkimi shqiptar si problem për zgjidhje atëhere nesër do të flasim për amerikanë, gjermanë, grekë, maqedonas etj etj me origjinë shqiptare. Nesër do të duhet, që nga ata të cilët do të mbeten shqiptarë të kërkohet të analizojnë, përse shqiptarët janë i vetmi komb i cili prodhon masivisht dhe historikisht të huaj me origjinë shqiptare, më shumë se kushdo komb tjetër tjetër? Shëmbujt që do të sillen, flasin për një realitet trishtues:

Shëmbulli i parë: Shqiptarë në histori, grekë ne realitet

Ngushëllimi vdekjendjellës me nocione integrimi apo globalizmi, nuk zgjidh asgjë. Ashtu si çfardo lloj ngushëllimi, nuk zgjidh asgjë. Fjalët e "pasvdekjes kombëtare", janë thjesht një ritual dhe asgjë tjetër. Tek rituali ndryshojnë fjalët, termat, thëniet, por mbetet

shekullor vetë rituali. A nuk përbëjnë një ngushëllim pasvdekjeje shkrimet, librat,legjendat, këngët e sotme mbi grekët me origjinë shqiptare? Ngushëllimi shkon deri atje sa ata i quajmë arvanitas, apo se ata na ditkan disa fjalë shqip. Është një ritual Morti Kombëtar. Dhe është i tillë pasi ata janë pjestarë të kombit grek. Janë shqiptarë në historinë e largët, por grekë në realitet.(Sa prej tyre kanë marrë pjesë në aneksimin e tokave shqiptare në vitin 1914? Sa prej tyre kanë qenë pjestarë të Napoleon Zervas dhe kanë marrë pjesë në masakrën ndaj shqiptarëve të Çamërisë? Nuk ka rëndësi shifra, rëndësi ka pjesmarrja)

Përgjatë shekujve shqiptarët kanë prodhuar grekë me shumicë, kanë marrë pjesë duke u shkombëtarizuar në pavarsinë e Greqisë etj etj, por nuk kanë mundur të realizojnë dot komb-shtetin e tyre. Eshtë një faqe e palavdishme e tyre, e cila synon të përsëritet edhe në fillim shekullin e 21-të. (Greqia-Atdheu im i dytë-Kështu e ka titulluar sitin e tij në internet, një shqiptar që jeton në Greqi. Ndërsa për fëmijët e tij, Greqia do të jetë, Atheu i parë, pas të cilit nuk ka tjetër. Shqipëria do të mbetet thjesht një origjinë e largët.)



Shëmbulli i dytë: Shqiptarë në këngë, italianë në realitet

A nuk përbëjnë një ngushëllim pasvdekjeje librat, thëniet, këngët për italianët me origjinë shqiptare? Ngushëllimi shkon deri atje sa i konsiderojmë arbëreshë apo se ata kanë ruajtur disa këngë apo fragmente historie nga mesjeta. Përsëri në thelb kemi të bëjmë me një Ritual Morti Kombëtar. Ata nuk janë shqiptarë. Ata janë pjestarë të kombit italian. Por që të parët e tyre para disa shekujsh kanë qenë shqiptarë. Shqiptarë në këngë dhe italianë në realitet. Ndërsa shqiptarët e sotëm, mburren me italianët me origjinë shqiptare!! Mburren me një këngë apo me pesë fjalë shqip të mbetura qysh nga mesjeta. Përse?

Shëmbulli i tretë: Shqiptarë në legjenda, turq në realitet

A nuk përbën një ngushëllim mortor historia e miliona turqve me origjinë shqiptare? A nuk e kini vërejtur se si politikanë, historianë, qeveritarë etj etj, mburren dhe flasin për qindra vezirë, pashallarë, gjeneralë turq me origjinë shqiptare? Dhe mburrja mortore shkon deri atje sa pohojmë që: Shqiptarët mbajtën në këmbë Perandorinë Turke!! (Dhe nuk pranuan të bënin Shqipërinë!!).

Ndërkaq ata janë pjestarë të kombit turk, ashtu siç janë të tillë edhe miliona të tjerë që shekuj me parë kanë qenë shqiptarë. Por që sot stërnipërit dhe stërmbesat e tyre janë turq!!! Shqipëria për më shumë se katër shekuj ishte e pushtuar nga perandoria turke. Shumica e atyre që ushtronin ligjet e pushtimit dhe mbanin gjallë pushtimin ishin vezirë dhe pashallarë më origjinë shqiptare. Kundër Ali Pashë Tepeëlenës, Sulltani dërgoi dy shqiptarë, Ismail Pasho Beun dhe më vonë Hurshid Pashën. Ndërsa sot, nw histori apo legjenda, këta pushtues konsiderohen pjesë e historisë!! (Ndërsa komandanti që u printe forcave turke në rrethimin e dytë të Vienës ishte një Vezir i Madh. Por jo vetem kaq, ai ishte një shqiptar nga fisi i Qyprilinjve, i quajtur Mustafa Qypriliu.)

Përfundim i pjesshëm

Vargu i ngushëllimit mortor është i gjatë. Por edhe shembujt e sjellë janë të mjaftueshëm për të konkluduar, për të mos u mashtruar. Por shëmbujt e sjellë janë të mjaftueshëm për të analizuar. Pse ka ndodhur një gjë e tillë dhe përse nuk duhet të ndodhë përsëri?

Edhe në kohën kur grekët me origjinë shqiptare, nuk e kishin vendosur ti nënshtroheshin shpërbërjes kombëtare, edhe atëherë ka pasur politikanë dhe nocione politike që e kanë fshehur shpërbërjen kombëtare. Ata nuk kanë pranuar zyrtarisht se po shkombëtarizohen. Kanë luajtur me nocionet e kohës. Por koha pastaj ka bërë të sajën. Nuk ka qenë shpërbërje kombëtare me anë të shpatës, por me anë të shijes së jetës. (Odiseja dhe Itaka janë të një periudhe më të hershme se sa shpërbërjet kombëtare të shqiptarëve.) Edhe në kohën kur italianët me origjinë shqiptare nuk e kishin vendosur ti nënshtroheshin shpërbërjes kombëtare, edhe atëherë ka pasur politikanë të cilët e kanë fshehur këtë shpërbërje me anë të gjoja të ikjes nga raprazaljet e ushtrisë turke.

E njëjta ka ndodhur edhe me turqit me origjinë shqiptare. Edhe në kohën kur ata miliona shqiptarë nuk kishin vendosur ti nënshtroheshin shpërbërjes kombëtare, ka pasur politikanë dhe funksionarë shqiptarë që e kanë fshehur këtë shpërbërje në emër të nocioneve të kohës. (Perandoria turke zgjati shekuj, jeta e njeriut zgjat me dekada. Shekujt shërbejnë për njerëzimin, dekadat janë për njeriun) Emërimet në skaje të ndryshme të perandorisë, synimet drejt një jetë më komode në krahasim me disa popuj të tjerë të saj, gradualisht por pandërprerë realizuan atë që sot shqiptarët të flasim për miliona turq me origjinë shqiptare. Nocioni integrim, internacionalizëm apo globalizëm ka ekzistuar edhe atëherë, pavarsisht nga përmbajtja e tij apo nga formulimi ndryshe. ■

Korrespodencë nga Shkupi

EKSPERIMENTI PËR KRIJIMIN E VETËKËNAQËSISË MAQEDONASE

Në kohën kur kufijtë në Evropë po bien, ashpërsimi i regjimit të kalimit kufitar me shtetin shqiptar ka një domethënie të veçantë. Ky vendim, para së gjithash, synon ta kufizojë lëvizjen e lirë të shqiptarëve në trekëndëshin Tiranë-Shkup-Prishtinë



Avni **AVDIU**

Sa herë që i është dashur ndonjë eksperiment pushtetarëve maqedonas i kanë shërbyer shqiptarët si laboratorë. Kjo ka ndodhur në Maqedoninë jugosllave, kjo ndodhi në Maqedoninë tranzitore dhe kjo po ngjan edhe në Maqedoninë e sotme synuese për BE dhe NATO.

Vendimi i Qeverisë maqedone për vendosjen e masave rigoroze në dhënien e vizave për shtetasit shqiptarë prej muajit shkurt të këtij viti, është një ndër eksperimentet që në vete ngërthen megalomani dhe iluzion. Maqedonia para Shqipërisë nënshkroi marrëveshjen e asocim-stabilizimit me BE dhe me këtë gjest sikur dëshiron t'i japë sinjale komunitetit ndërkombëtar se duhet të jetë vendi i radhës që do ta meritonte hyrjen në BE. Vetë fakti se për pajisjen me vizë ose edhe për kalim transit në territorin e Maqedonisë kërkohet ndjekja e procedurave si në vendet e BE-së, dëshmon për iluzionin e përzier me megalomani, që përshkon vetëkënaqësinë e rreme maqedonase se janë më superiorët që meritojnë t'i takojnë familjes evropiane përpara dikujt tjetër. Në kohën kur kufijtë në Evropë po bien, ashpërsimi i regjimit të kalimit kufitar me shtetin shqiptar ka një domethënie të veçantë. Ky vendim, para së gjithash, synon ta kufizojë lëvizjen e lirë të shqiptarëve në trekëndëshin Tiranë-Shkup-Prishtinë. Edhe pse një vendim i tillë godet edhe ekonominë maqedonase, si duket më e rëndësishme për Qeverinë maqedone është politika e provokimit sesa politika e afrimit. Gabohen iniciatorët e këtij veprimi politik nëse mendojnë se me këtë akt krijohet përshtypja se Maqedonia është vend atraktiv si ato të BE-së. Përkundrazi, me këtë është dëshmuar papjekuri politike, në kohën kur pritet integrimi i dy vendeve (Shqipërisë e Maqedonisë) në strukturat veri-atlantike dhe zgjidhja e statusit të Kosovës me pavarësimin e saj. Në këtë kontekst padyshim ekonomikisht më e dëmtuara është Maqedonia dhe për këtë dëshmon reagimi i menjëhershëm i Odës Ekonomike të Maqedonisë (veriperëndimore). Pastaj Maqedonia nuk është ndonjë Itali e dytë të frikësohej nga fluksi i emigrantëve, ngaqë këtu s'ka punë për vendësit e lëre më për të huaj. Së këndejmi, nuk ka asnjë arsye ky vendim: as arsyen ekonomike, as të sigurisë dhe as të plotësimit të standardeve për inkuadrim në strukturat veriatlantike. E vetmja "arsye", edhe atë nëse mund të quhet kështu!, është ajo politike.

Komuniteti ndërkombëtar i ka bërë gjithnjë thirrje Qeverisë maqedonase ta përshpejtojë zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit. Ndërkaq pala maqedonase sikur me inat po e zvarrit atë. Në vend të implementimit të saj ajo merret me incidente (Brodeci), me vendimin e gjykatës kushtetuese (rreth përdorimit të flamurit - shqiptar) dhe së fundit me vendimin e vizave (shtrëngimin e procedurave për shtetasit shqiptarë). Kësaj populli i thotë: "merrja bukën e harron edhe djathin".

Qeveria e Shkupit shumë e interesuar t'i ngacmojë shqiptarët

Pa u marrë me kualifikime të mëdha, duhet thënë se Qeveria e Shkupit është shumë e interesuar t'i ngacmojë shqiptarët, edhe atë me çdo kusht. Çdo akt provokimi duhet të presë kundërpërgjigje me masë të njëjtë. Kjo do të thotë se edhe Qeveria shqiptare mund të ndërmarrë masa nga ana e vet. Nuk do të jetë në sedrën kombëtare lejimi i nënvlerësimit nga një vend tjetër.

Nisur nga kjo "logjikë" rrjedhimisht në vend se të liberalizoheshin kufijtë, bëhet e kundërta, edhe atë në kundërshtim me sugjerimet e instancave euro-atlantike për zgjerimin e bashkëpunimit dhe frymës rajonale, ku liria e qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe vlerave kulturore duhet ta paraqesë preludin e hapjes së vendeve drejt BE-së. Në këtë pikë politika maqedone është treguar e dobët përpara mekanizmave ndërkombëtarë të vendosjes, e që, sipas të gjitha gjasave, nuk do të kalojë pa u vërejtur.

Komuniteti ndërkombëtar i ka bërë gjithnjë thirrje Qeverisë maqedonase ta përshpejtojë zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit. Ndërkaq pala maqedonase sikur me inat po e zvarrit atë. Në vend të implementimit të saj ajo merret me incidente (Brodeci), me vendimin e gjykatës kushtetuese (rreth përdorimit të flamurit - shqiptar) dhe së fundit me vendimin e vizave (shtrëngimin e procedurave për shtetasit shqiptarë). Kësaj populli i thotë: "merrja bukën e harron edhe djathin".

Dhe pas një sërë masash që vijnë në dëm të shqiptarëve nga Qeveria maqe-

donase, shtrohet pyetja: "cili është funksioni i ministrave shqiptarë aty ose i partive shqiptare të koalicionit"?!

Kalimi në heshtje i të gjitha vendimeve që janë në disfavor të shqiptarëve, ose është strategji e tyre ose paraqet naivitet. Sido që të jetë, edhe njëra edhe tjetra për momentin janë të pavend. Kjo ngaqë në momentet kur strukturat ndërkombëtare të vendimmarrjes përgatisin terrenin për t'i bërë ftesën Maqedonisë për inkuadrim në BE dhe NATO, pjesëmarrja (në heshtje) e shqiptarëve në qeveri, është dekori më i mirë përpara botës se ky vend njëmend ia vlen t'i ketë të gjitha prioritetet e duhura. Zaten këtë partitë shqiptare të koalicionit e duan me gjithë shpirt, madje më shumë se realizimin e të drejtave të votuesve të tyre. Kjo u dëshmua me demonstratat më paradoksale që janë mbajtur ndonjëherë në këto hapësira me moton: "Kosova e pavarur – Maqedonia në NATO!".

Shqiptarët nuk janë ata që duhen t'i tregojnë botës se Maqedonia duhet të hyjë në NATO (se ndryshe s'bën), e aq më pak të organizojnë demonstrata përpara maqedonasve për këtë qëllim. Kjo nuk është naivitet, po diçka edhe më tepër.

Përpara kësaj shqiptarët duhen t'ia bëjnë me dije maqedonasve formulën "ose-ose", sipas së cilës: "ose duhen të plotësohen të gjitha të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, që garantohen sipas standardeve evropiane, ose shqiptarët do ta pengojnë Maqedoninë për t'u inkuadruar në BE e NATO, edhe atë me të gjitha mjetet demokratike.

Nëse qeveritarët maqedonas tregojnë vullnet të mirë dhe gatishmëri politike për këtë, atëherë padyshim shqiptarët do të duhej ta përkrahnin integrimin euroatlantik të vendit, sepse Maqedonia është edhe atdheu i tyre.

Gjerat janë të qarta dhe shumë domethënëse për secilin. Ato nuk i kuptojnë vetëm ata që të verbuar nga postet e pushtetit kalkulojnë për hesape të tjera.

Është e domosdoshme që zëri i shqiptarëve të dëgjohet, kur cenohet interesi i tyre. Heshtja në rastet e tilla është e dëmshme, sepse qeveritarët do ta kuptonin si shenjë dobësie, kështu që do të pasonin me vendime të tjera edhe më të disfavorshme.

Mentalitetet ballkanike mbeten edhe më tej rigjide

Në këto hapësira duhet të ndërpritet njëherë e përgjithmonë praktika e provokimeve që daton nga koha moniste. Para së gjithash duhen të ndërrohen mentalitetet, edhe atë në frymën evropiane. Kot mbushet goja plot fjalë me dëshira për heqje kufijsh, integrime evropiane dhe liberalizim të tregut, kur në praktikë bëhet e kundërta. S'ia vlen dot ndryshe të flitet e ndryshe të veprohet.

Evropa në projektin e saj dëshiron ta inkuadrojë edhe Ballkanin në gjirin e vet. Nënshkrimi i marrëveshjeve për asocim-stabilizim ka qenë një hap para drejt këtij objektivi. Por mentalitetet ballkanike mbeten edhe më tej rigjide, lag të qenurit "open mind". Evropa një hap para, ato dhjetë hapa mbrapa.

Qeveria maqedone duhet ta dijë këtë. Kjo është, para së gjithash, në të mirë të saj. Tekefundit vendimi i fundit për ashpërsimin e vizave, ndonëse i dëmton shqiptarët, prapëseprapë nuk i dëmton aq sa mendon Shkupi zyrtar.

Mirëpo, përpara se të bëhet fjalë për dëmin, duhet të flitet për një çështje tjetër: është fjala se ky vendim është sinjal përçmues që drejtohet në drejtim të faktorit shqiptar si brenda ashtu edhe jashtë kufijve, prandaj çështja është pikësëpari e karakterit të luftës për prestigj: se "ne vlejmë më shumë – e ju më pak". Ndonëse kjo mund të shihet vetëm në lojëra fëmijësh, prapëseprapë nuk është e çuditshme që për mentalitetet që kultivohen në këto hapësira, kjo "logjikë" të hyjë edhe në instancat e politikave shtetërore. ■

Perspektiva e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian

Cilat janë mundësitë e anëtarësimit të Kosovës në BE?



Fadil MALOKU

Shikuar me dioptrinë e një përkushtimi në nivel kombëtar, sfida e integrimit të Kosovës në BE nuk duket edhe aq shumë "mission impossible"!

Çështja e integrimit në shekullin e ri është një sfidë jo vetëm për Evropën por përgjithësisht edhe për vendet të cilat kanë pasur një të kaluar pak a shumë të trazuar në kuptimin e krijimit të një shoqërie më të gjerë të jo vetëm komunikimit, por edhe të tregtisë dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror.

Ideja e integrimit nuk është e re. Ajo si e tillë është e vjetër qysh në periudhat më të hershme të ndërtimit të kapaciteteve shtetërore. Në të vërtetë, ideja për të hyrë në iniciativa integruese e vendeve postkomuniste (që shumica prej tyre tashmë janë integruar në Bashkimin Evropian) ishte një karrem i dobishëm që shumëfish u shpagua me hapjen e vendeve të reja të punës si edhe beneficioneve të tjera shtesë. Problemet që aty këtu shfaqën te disa vende që kanë shfaq një lloj zhgënjimi, si p.sh. Rumania, Bullgaria, etj., më shumë do thoshim ndërlidhen me procesin fillestar të mospërmbushjes së "standardeve" kualifikuese për t'u bërë pjesë përbërëse e një projekti të madh çfarë në fakt është ai i Bashkimit Evropian.

Në literaturën politike rreth procesit të integrimeve, pra procesit të krijimit të një identiteti përafërsisht të rrumbullakuar të kontinentit të Evropës hasim kategorizime të ndryshme të procesit të identitetit të Evropës. Ne do të përmendim kalimthi vetëm tri prej tyre që pak a shumë kanë zgjuar interesimin e debateve publike edhe sot e kësaj dite, e ato janë: koncepti i qytetarisë evropiane, ai i solidaritet vullnetar, si edhe koncepti etno-kulturor që më së shumti është në thembër të kritikave dhe rezervave të shteteve dhe vendeve që kanë peshë kryesore në Evropë, siç janë: Gjermania, Franca, Anglia dhe Italia.

Ideja e bashkimit të Evropës ishte, para së gjithash, ide politike...

Për shkak të hapësirës së kufizuar në këtë shkrim, nuk do të hyjmë në ndonjë analizë më të thellë të kësaj problematike, por vetëm do të theksojmë se koncepti i qytetarisë sot është koncepti që më së shumti ka ar-

ritur të afirmohet si në vendet me traditë demokratike ashtu edhe në ato të cilat janë duke e përfunduar procesin e tranzicionit, si proces apo si test provues për t'i filluar nismat e një integrimi më serioz integrues.

Integrimi është një proces i cili që nga e kaluara ka zgjuar interesime sidomos për identitetet dhe vendet të cilat kanë fuqi dhe ekonomi të zhvilluar në nivel të lartë. Ky prejudikim, në rastin e Evropës padyshim që i takon një Gjermanie e një France, të cilat kanë me vete kapacitete njerëzore dhe resurse ekonomike që ta iniciojnë dhe ta fuqizojnë gjerë në fund idenë njëherë e asocim stabilizimit e më pastaj edhe të integrimit.

Që nga koha kur ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, z. Joschka Fischer, me rastin e festimit të pesëdhjetëvjetorit të "Deklaratës së Schumanit", në mënyrë publike e bëri idenë e Evropës si federatë e njëtrajtshme për gjithë kontinentin, filloi krajata e diskutimeve publike dhe jopublike lidhur me këtë projekt aspak joutopik në kohën kur u lansua.

Më 9 maj të vitit 1950 Franca e deklaroi "Deklaratën e Schumanit", mbi formimin e një trupe mbinacionale, që do të kujdeset me raportet ndërmjet Gjermanisë dhe Francës. Të dy këto shtete lidhën marrëveshje për prodhim të çelikut dhe thëngjillit. Nënshkruese të kësaj deklarate më 18 prill të vitit 1950 janë: Gjermania, Franca, më pastaj kyçen edhe Italia dhe Shtetet e Baneluksit.

Në të vërtetë, ideja e bashkimit të këtij kontinenti ishte ide, para së gjithash, politike, që aludonte në krijimin e mekanizmave të atillë mbinacional, të cilët, sipas eksperiencës amerikane, do të mund të krijonin një substrat jo ideologjik, por politik dhe ekonomik. Është e qartë se kësaj ideje do t'i paraprijë ideja e tanishme e Bashkimit Evropian, por jo me të gjitha konturat dhe grandiozitetin e saj burokratik. Nëse i adresohemi historikut të projektit për një Evropë të tërësishme dhe stabile, ashtu siç e imagjinojnë eurokratët e sotëm, atëherë me siguri do të kuptojmë se kjo ide nuk është edhe aq e vjetër sa të kontestohet pa nevojë.

Në të vërtetë, menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore në Francë është aktualizuar i ashtuquajturi "Plani i Schumanit" mbi krijimin e trupave mbinacionale. Kurse marrëveshjet mbi krijimin e BEE-s (Bashkësia Ekonomike Evropiane) dhe EUROTAOM-it (Agjencioni Atomik Evropian) janë nënshkruar në vitin 1957. Kësaj marrëveshjeje, pas një periudhe gati dy dekadash iu bashkëngjitën Danimarka, Irlanda e Veriut dhe Britania e Madhe, kurse Greqia në vitin 1981.


Pas një periudhe prej vetëm katër vjetësh nënshkruhet e ashtuquajtura "Marrëveshje e Shengenit", pra në vitin 1985, sipas të cilës lejohej qarkullimi i lirë i njerëzve dhe i mallrave pa ndonjë kontrollim rutinor, siç bëhet ende zakonisht në vendet e tranzicionit.

Kosovës do t'i duhet ndoshta një dekadë e tërë për t'i tejkaluar të gjitha testet

Do theksuar që këtë bashkësi të parë transnacionale në Evropë e kanë karakterizuar disa veçori që ishin produkt i aprovimit të "Planit të Schumanit". Ndër to, katër sosh janë më të rëndësishme për t'u përmendur:

1. Liria e vendosjes së mekanizmave të apostrofuar në mënyrë të pavarur nga organet dhe mekanizmat e vet shtetërorë dhe nga qeveritë e tyre;

2. Vendimet e aprovuara drejtpërdrejt i obligonin të gjitha shtetet anëtare, edhe atëherë kur vendimet nuk merreshin në mënyrë unanime;



3. Vendimet e organeve të këtij mekanizmi mbinacional i obligojnë të gjithë personat juridikë të vendeve nënshkruese të marrëveshjes;

4. Anëtarët pjesëmarrës të këtij mekanizmi mbinacional, në mënyrë të drejtpërdrejtë janë njëherësh edhe përfaqësues të qytetarëve të vendeve prej nga vijnë, e jo të shteteve, ngaqë zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vota e qytetarëve.

Duket se për t'u realizuar "ëndrra" e bashkimit të Evropës, ajo më parë duhet të kalojë nëpër disa pengesa apo procese gati të patejkaluara integrative, në formë konglomeratesh.

Pikësëpari, procesi i konsolidimit ende të pamjaftueshëm të institucioneve të Bashkimit, që në këtë fazë ende konsiderohen si embrionale, pra të papjekura për ta shtrirë ndikimin e vet nëpër sovranitetet e reja që pretendojnë të inkuadrohen;

Së dyti - pabarazia ekonomike, një element gjithsesi domethënës dhe tejet i rëndësishëm në krijimin e rrjetit të ri integrativ që është duke u ndërtuar mes shteteve udhëheqëse në këtë projekt afatgjatë dhe vendeve që presin të integrohen në të;

Së treti, procesi i papjekurisë për të rezistuar vlerat e reja integrative të vendeve apo shteteve që synojnë këtë tendencë të re integrative.

Sa i përket pengesës së parë të konsolidimit të pamjaftueshëm të institucioneve të qendrës për t'i absorbuar anëtarët e interesuar dhe të dalë nga pjesët e sidomos Evropës Lindore dhe të asaj Jugore, është e vërtetë që këto institucione ende janë të brishta dhe, si të tilla, të paautoritetshme (nëse e përdorim termin eurokrat, kurzivi im F. M.) sa duhet për t'i fuqizuar këto vende në drejtim të interesimit për t'u anëtarësuar në këto institucione të reja edhe për vetë bartësit e këtij projekti. Kjo sepse, principi i pranimit të vendeve të reja bazohet kryesisht në madhësinë e vendeve të interesuara për anëtarësim.

Kosova, si një vend i Ballkanit perëndimor me vetë faktin se ende nuk i ka realizuar dy fondamente kryesore që ndërlidhen me kushtëzimin permanent fillestar për çdo vend, siç janë ai i njohjes së pavarësisë së saj dhe fundamentin e dytë atë të ndërtimit të kapaciteteve demokratike të cilat do ta fuqizonin dhe formalizonin procesin e fillimit të negocimit për t'u bërë pjesë përbërëse e të ashtuquajturit Projekt "Agjenda 2000", ku janë paraparë standardet dhe kushtet themelore për të filluar procesi i asocim stabilizimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Vitet, e ndoshta edhe një dekadë e tërë Kosovës do t'i duhet për t'i tejkaluar të gjitha testet ("standardet") që do t'i paraqesë trusti i Bashkimit Evropian. Ardhja e kontingjentit të ri Evropian, sidomos nga sfera e sigurisë dhe mbrojtjes me siguri do ta përshpejtojë këtë proces që është jo vetëm nevojë (shkaku i ziolimit apo getoizimit aktual që është duke e përjetuar Kosova gjatë gjitha viteve të pas luftës) por, para së gjithash, edhe interes kombëtar i Kosovës.

Në ndërkohë qeveria e re do të duhej t'i kushtonte një rëndësi të posaçme kësaj sfide që do të ndikojë edhe në standardin dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Shikuar me dioptrinë e një përkushtimi në nivel kombëtar, sfida e integrimit të Kosovës në BE nuk duket edhe aq shumë "mission impossible"!

Autori është sociolog i globalizimit (www.fadilmaloku.zor.org) ■

Perspektiva e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian

KUR REFORMAT NË ARSIM BËHEN ME DIKTAT...

Reformat kanë qenë të dirigjuara nga faktor të ndryshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, si duket kanë pasur qëllim për ta degraduar arsimin fillor si celulë e dijes. Kjo për faktin se ato janë aplikuar në formë e dhunshme, me urdhër të prerë, pa u marrë parasysh efekti dhe defekti i tyre.



Fitim VELIU

Kur flasim për reformat në arsimin fillor, kemi parasysh ndryshimet të cilat janë bërë në ciklin e ulët, pas vitit 2002. Këto reforma që i ka iniciuar MASHT-i, si institucion më i lartë i dijes në vendin tonë nuk janë mirëpritur, as nga personeli shkollor dhe as nga prindërit e nxënësve, dhe kanë shkaktuar kaos të paparë nëpër të gjitha shkollat fillore.

Reformat kanë qenë të dirigjuara nga faktor të ndryshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, si duket kanë pasur qëllim për ta degraduar arsimin fillor si celulë e dijes. Kjo për faktin se ato janë aplikuar në formë e dhunshme, me urdhër të prerë, pa u marrë parasysh efekti dhe defekti i tyre.

Këto reforma janë lansuar, duke filluar me strukturat udhëheqëse shkollore, pastaj modifikimi i literaturës, ndryshimet në plan-programe dhe disiplinë.

Struktura udhëheqëse e shkollës

Reformat në strukturën udhëheqëse shkollore, të ciklit të ulët, janë realizuar sipas planit ABC të MASHT-it. Pra, ndërrimi i strukturës udhëheqëse të shkollës, si fillim do të ishte përgatitje e terrenit të pastër për të ndryshuar kahen e shkollës drejt plan-programeve të instaluara si virus.

Së pari ndërrimi i drejtorëve nëpër shkolla fillore, ndodh në mënyrë arbitrare. Shkarkohen drejtorët e mëparshëm dhe vendosen të rinjtë pa konkurs, apo me ndonjë konkurs formal. Formaliteti i këtij konkursi shihet në aplikim, ku nuk precizohen kritere kualifikimi, Pra kjo ndodh si emërim, si instancë drejtuese.

Struktura udhëheqëse nuk mbaron me kaq, sepse çështja e sekretarit të shkollës dhe pedagogut vazhdimisht ka qenë pezull duke ndryshuar statusi i tyre nga viti në vit. Ata pas vitit 2002 janë pushuar nga puna, por më vonë janë rikthyer përsëri, sepse është vërejtur mungesa e tyre në punët administrative të shkollës në edukim dhe reformim të mëtutjeshëm të shkollës, prandaj problemi i tyre është i pazgjidhur edhe sot. Definimi i statusit të tyre do të krijonte një rend rregull dhe emancipim të shkollës, drejt zhvillimit normal të arsimit fillor, në të kundërtën degradimi do të vazhdoj edhe me tutje, dhe kjo do të na sjell drejt dobësimit të institucionit të shkollës dhe do të vonoheshim shumë në inkuadrimin e shoqërive të përparuara botërore.



Reformat dhe disiplina në shkollë

Reformat të cilat kanë të bëjnë me sjelljen e nxënësve në shkollë, si dhe sjelljen e personelit arsimor ndaj tyre nuk kanë hasur në mirëkuptim, sepse liria e nxënësve në shkollë në shumë raste është keqpërdorur nga nxënësit, të cilët duke e ndier vetën si autoritet, jo vetëm që kanë polemizuar me arsimtarët e tyre, por kanë shfaqur edhe sjellje ekstreme ndaj tyre. Sot nxënësi mund të themi se ka një imunitet të plotë sikur deputeti i një kuvendi, sepse çfarëdo qoftë sjellja e tij në shkollë, nuk ka masa përjashtimi, përveç një tërheqje vërejtje verbale, e cila kalon pa ndonjë pasojë!

Reforma e cila ka të bëjë me sjelljen e nxënësve në shkollë ka pasojën e vet edukative dhe arsimore, e kjo vie si pasojë e mosformimit të personelit arsimor në aspektin metodik. Kjo shihet në mosfunksionimin e një ore të qetë në klasë, kur nxënësit bëjnë zhurmë dhe arsimtari nuk di se si të veprohet për qetësimin e tyre. I vetmi mjet të cilin kanë të drejtë ta përdorin arsimtaret ndaj nxënësve të padisiplinuar është gjindshmeria e tyre, e cila lidhet me formimin metodik, që për fat të keq mungojnë në mbi 80 % të personelit arsimor.

E gjithë kjo amulli është si pasojë e mosfunksionimit të një rregulloreje, e cila do të ndëshkonte të padisiplinuarit dhe do të evitonte problemin në fjalë.

Reforma dhe planprogrami mësimor

Sa u përket reformave në planprogramet mësimore për shkollën fillore, ato duken të pa aplikueshme për moshën e këtyre nxënësve. Duhet ta përmendim mësimin në dy gjuhë që në klasën e tretë. Kjo nuk është e qëlluar, sepse niveli i tyre për të mësuar një gjuhë të huaj, pa e ditur alfabetin e gjuhës së tij amtare, është jologjike dhe aspak funksionale.

Pastaj defekti tjetër është se personeli arsimor që e mban këtë lëndë është i fushave të tjera, gjë që nuk i përgjigjet kërkesave të nxënësve fillestarë. Inkuadrimi i disa lëndëve të inxhinierisë mekanike dhe ndërtimtarisë është një ngarkesë e papërballueshme për nxënësin e kësaj moshe, sepse pengon në nxënien e diturisë bazike për formim të mëtutjeshëm. ■

Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Bashkimin Evropian (BE) do ta realizojnë edicionin e parë të projektit "Universiteti Dimëror i Prishtinës"

Studentët e Prishtinës njihen me strategjitë dhe planet e BE-së

Programi i Universitetit Dimëror për Ligjin e BE-së, i pari i këtij lloji në Universitetin e Prishtinës, pritet të përfshijë rreth 50 studentë aktual të Universitetit të Prishtinës, të cilët do të hulumtojnë në detaje për formimin institucional dhe ligjbërës të BE-së dhe strukturës së ligjeve të saj



Erblin ZHUBI &
Gëzim QERIMI

Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Bashkimin Evropian (BE) do ta realizojnë edicionin e parë të projektit "Universiteti Dimëror i Prishtinës" që do të mbahet nga data 01.03.2007 - 21.03.2007 në Prishtinë.

Ky projekt, ndryshe nga Universiteti tradicional Veror i UP-së, do të jetë i përqendruar në një modul, me temën: "E drejta evropiane" dhe do të realizohet këtë vit (vetëm) për studentët e Universitetit të Prishtinës, dhe realizohet në vazhdën e projektit "Ndihmë Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-ve) për përputhshmëri më të madhe me Bashkimin Evropian". Marrëveshja është nënshkruar më datë 17.12.2007, në ambientet e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës.

Ky modul do të jetë i organizuar për studentët e të dy niveleve, Bachelor dhe Master dhe do të jetë i vlerësuar me kredi evropiane ECTS.

Projekti do të realizohet në gjuhën angleze dhe do të mund të zëvendësojë një kurs zgjedhor nga plan-programi i rregullt akademik dhe do të synoj t'i ndihmojë hartimit të kurrikulës (planit) së programit të ri për shkallën Master në "Studime Evropiane" që pritët të fillojë në vitin akademik 2008/2009 dhe do të synoj të shndërrohet në një projekt tradicional të specializuar të UP-së.

Pjesëmarrësit në këtë projekt, përveç se do të marrin një informacion më të gjerë dhe një rezyme më të përgjithshme në lidhje me BE-në, do të njihen më për së afërmi me strukturat, institucionet dhe kompetencat e BE-së.

Ky programi është i dizajnuar për studentë të profileve të ndryshme, duke u mundësuar atyre që edhe të zgjerojnë njohuritë e tyre dhe të vlerësojnë më tepër natyrën shumë kombëshe të Evropës.

Programi fokusohet në dhënien e njohurive për normat, obligimet dhe të drejtat që i lidhin së bashku anëtarët e BE-se dhe njerëzit e saj.

Gjithashtu ky projekt ka për qëllim t'i informojë pjesëmarrësit edhe për mënyrën se si forcat politike, sociale, historike, legale dhe ekonomike po i japin formë Evropës Bashkëkohore. Pjesëmarrësit, do të njoftohen edhe për strategjitë dhe planet e BE-së për të ardhmen, për mënyrën dhe planet e zgjerimit të tij.

Synimet e Universitetit dimëror të UP-së janë që nëpërmjet Memorandumit të Mirëkuptimit me Universitetin e Prishtinës, të paraqet një kornizë për Programin e Universitetit Dimëror për Ligjin e BE-së.

Programi i Universitetit Dimëror për Ligjin e BE-së, i pari i këtij lloji në Universitetin e Prishtinës, pritet të përfshijë rreth 50 studentë aktual të Universitetit të Prishtinës, të cilët do të hulumtojnë në detaje për formimin institucional dhe ligjbërës të BE-së dhe strukturës së ligjeve të saj.

Mësimdhënia do të jetë bashkëligjërim në mes të profesorëve e specialistëve të së Drejtës Evropiane nga Kolegji i Evropës në Belgjikë si dhe një ligjërues nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Juridik.

Ky projekt do të bashkëmenaxhohet nga Zyra për Marrëdhënie me Jashtë e UP-së dhe Projekti "Ndihmë IPVQ-ve për përputhshmëri më të madhe me BE-në".

Agjenda

Në javën e parë do të mbahen ligjërime për temat: Një përshkrim historik BE-së dhe zgjerimi i saj; Institucionet e BE-së; dhe Burimet e kushtetutës së BE-së;

Në javën e dytë, do të ligjërohet për: Traktatet (marrëveshjet); Rregulloret dhe direktivat; dhe Vendimet e Gjykatës Evropiane për Drejtësi

Ndërsa në javën e fundit, do të ligjërohet për Tri shtyllat e BE-së. (Shtylla e Komunitetit e cila mbikëqyrë politikat ekonomike,sociale dhe të ambientit; Shtylla e Politikave dhe Sigurisë e cila mbikëqyrë politikat e jashtme dhe çështjet ushtarake; dhe Shtylla e tretë ose Bashkëpunimi Policor dhe Juridik në Çështjet Kriminale që mbikëqyrë bashkëpunimin në luftimin kundër krimit).

Pjesëmarrësit do të përzgjidhen në bazë të njohurisë së gjuhës angleze, profilit akademik (studentët që janë duke studiuar shkencat politike ose juridike do të kenë përparësi), të jenë studentë në diplomim e sipër ose të diplomuar të UP-së, të njohin gjuhën angleze, të kenë së paku dy vite të përfunduara të studimeve të tyre. Gjithashtu pjesëmarrësve iu duhet të kenë dokument identifikues të UNMIK-ut ose dokumentin e udhëtimit.

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të jenë të obliguar që të marrin pjesë në të gjitha sesionet e Programit në mënyrë që të kualifikohen, duke iu nënshtruar një testi dhe në fund të pajisen me certifikatën përkatëse. ■

Pas paralajmërimeve për embargo tregtare nga Serbia

NUK KA VEND PËR PANIK!

Pjesëmarrja e Serbisë me produktet e saj në tregun e Kosovës vlerësohet të jetë e madhe. Statistikat flasin se në tërësinë e importeve që realizon vendi ynë, prodhimet serbe marrin pjesë me një përqindje prej 16, 24%, ndërsa gjatë vitit të kaluar vendkalimet me shtetin serb përbëjnë 31% të tregtisë së përgjithshme

Sead UJKANI

Shteti serb, përkatësisht zyrtarët e tij kanë paralajmëruar që në rast të shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe njohjes ndërkombëtare të saj, do t'i ndërmarrin një varg masash, përfshirë këtu edhe intervenim ushtarak në Kosovë dhe vendosje të embargos tregtare.

Mirëpo, në këtë kontekst çfarëdo ndërhyrje eventuale ushtarake, vështirë është për t'u realizuar, ndërsa sa i përket bllokimit të kufirit, përkatësisht vendosjes së embargos tregtare, një gjë e tillë do të mund të realizohej, por efekti i duhur i saj do të ishte shumë skeptik. Në realitet një vendosje e tillë e embargos nuk do të ishte gjë e lehtë për shtetin serb.

Gërxhaliu: Serbia eksporton mallra në Kosovë deri në 500 milionë euro

Duke folur rreth kërcënimeve përkatëse të qeveritarëve serb për embargo eventuale, Safet Gërxhaliu udhëheqës i zyrës për çështjet ekonomike ndërkombëtare nga Oda Ekonomike e Kosovës thekson: "Është një dukuri e cila është aktualizuar kohëve të fundit, kinse do te bëhet apo do të ketë embargo nga qeveria e Serbisë karshi pavarësisë së Kosovës, mirëpo më tepër kjo është një spekulim apo një pjesë speciale e luftës së ftohtë, e cila e ka të kaluarën dhe të tashmen dhe do të ketë edhe të ardhmen, kur është në pyetje Kosova dhe raportet me Serbinë".

Sipas Gërxhaliut, pretendime të tilla apo supozime të tilla ka çdo ditë e më tepër dhe të gjitha janë aktuale në konsumin e brendshëm të politikës serbe, mirëpo në realitetin ekonomik dhe në raportet Kosovë-Serbi. "Nuk e besoj se ata janë të krisur ta mbyllin një treg që në formë legale e ka një shumë të eksportit në Kosovë prej 190 milionë euro dhe në formë ilegale ia arrin shumën prej 500 milionë euro, dhe besoj që një gjë e tillë është e pamundur", konstaton Gërxhaliu.

Instrumente të tilla janë bërë mjeti kryesor i politikës së jashtme të shumë vendeve, që karakterizohen me një përdorim të shpeshtë të tyre. Është vërtetuar historikisht se imponimi vetëm nga një shtet i instrumenteve të tilla, nuk i ka dhënë rezultatet e duhura, duke ndikuar kështu në mosarritjen e objektivave përkatëse të parashikuara më vendosjen e embargove. Vështirësitë e realizimit të qëllimeve të vendosjes së masave të tilla janë identifikuar në interesat e veçanta të vendeve tjera për mosndalim të marrëdhënieve tregtare më vendit përkatës, objekt i embargos së vendosur, siç do të ishte rasti i reagimit të vendeve tjera në rajon në rast të aplikimit të një mase të tillë mbi Kosovën nga ana e Serbisë, përfshirë këtu në veçanti, Maqedoninë dhe Shqipërinë.



Edhe rasti i shtetit serb kalon nëpër këtë linjë, ndërsa është karakteristike të theksohet se vetë bizneset serbe kanë filluar ta përdorin këtë "armë", duke shikuar alternativat adekuate në mënyrë që të vazhdojnë pjesëmarrjen e tyre në tregun kosovar . "Gjithmonë ka edhe mundësi tjera alternative të daljes nga një situatë e tillë, ne kemi informata se shumë firma serbe kanë filluar t'i hapin degët përfaqësuese të tyre nëpër regjion, me të vetmin qëllim që produktet e tyre nëse vjen deri tek vendosja e embargos të jenë prapë aktive në Kosovë", thekson Gërxhaliu.

Gjithashtu, vendosja e embargos krijon edhe problemin e kompensimit të firmave (që realisht janë humbëset më të mëdha nga i tërë ky proces) që kanë marrëdhënie tregtare me shtetin, ndaj të cilit është aplikuar një instrument i tillë, kështu që në rastin në fjalë komuniteti i biznesit serb, respektivisht ndërmarrjet e tij nuk do të pranonin aq lehtë vendosjen e embargos ndaj Kosovës nga ana e qeverisë së tyre, ngase fundi i fundit efekti negativ i për-

Analiza e GAP-it

Menjëherë pas pohimeve përkatësisht kërcënimeve të shtetit serb për vendosje të embargos, Instituti për studime të avancuara "GAP" ka kryer hulumtimet relevante rreth implikimeve eventuale të një mase të tillë dhe ka publikuar një analizë rreth mbylljes potenciale të kufirit Kosovë-Serbi.

Disa nga përfundimet që dalin nga ky raport janë si vijon:


-Pengesat afatshkurtra do mund të ishin evidente sidomos në zinxhirin e furnizimit, mirëpo në periudhën afatgjate nuk do të ndeshemi me probleme të tilla, pasi që produktet mund të zëvendësohen ose mund të gjejnë rrugë tjera për të arritur në tregun e Kosovës;

-Prodhuesit serb do të humbin më së shumti nga aplikimi i embargos duke marrë parasysh importin që vie nga shteti i tyre;

-Në përgjithësi pjesa më e madhe e mallrave janë të zëvendësueshme, ndërsa gruri dhe misri do të ishin dy produkte për të cilat do të ndihej mungesa në periudhë afatshkurtër;

-produktet farmaceutike janë plotësisht të zëvendësueshme me produktet nga shtetet tjera dhe në shumicën e rasteve me kualitet më të lartë.

Urtësia e ndalimit të kamatës



Iljasa SALIHU

Kamata në sistemet bashkëkohore ekonomike gjithnjë e më shumë po shndërrohen si një gjë normale, pa të cilën sistemet financiare, bankare nuk mund ta kryejnë afarizmin e tyre. Kamata nuk përdoret vetëm në sistemet bankare, gjë që e bënë edhe më të komplikuar këtë dukuri, por ajo përdoret edhe nëpër institucione të ndryshëm siç janë: fondi pensional, fondi i sigurimit, investimi në letra me vlerë (aksione, obligacione, bono të thesarit etj) pra shihet qartë që një pjesë e madhe e veprimtarisë ekonomike është prekur nga kamata.

Njeriu si qenie më e përkryer nuk po e zgjedhë rrugën apo mjetin për të arritur deri te pasuria apo qëllimi, duke qëndruar në maksimën makiaveliste se "qëllimi e arsyeton mjetin" sepse për disa institucione financiare kreditore nuk është me rëndësi, apo nuk dëshirojnë t'i vërejnë dëmet që po i shkaktojnë në ekonomi, shoqëri por "profesionalizmi" i tyre është që sa më shumë të japin kredi me kamata mjaftë të larta qytetarëve...

Në veprimtaritë ku ndërmjetëson kamata, dëmet janë të shumëfishta. Së pari dëmtohet ai që merr kredi, pastaj institucioni financiar kreditues, sepse huamarrësit i ngushtohen punët edhe më shumë se që i ka pasur më parë, përpos kryegjësë ai duhet të kthejë edhe interesin gjë që në fund të aftit interesi është bërë më i madh se kryegjëja, prandaj si mund të kthehet huaja në këtë formë?

E keqja e kamatës vërehet edhe pa hyrë në analiza të thella ekonomiko-sociale, sepse Zoti pra 14 shekujve nëpërmjet Kur'anit na ka ndaluar përdorimin e kamatës: "**O ju që besuat, kini frikë All-llahun dhe nëse jeni besimtar të sinqertë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata".** *(El-Bekare, 278).*

Ndalimi i kamatës në vete ngërthen ruajtjen dhe mbrojtjen e interesit njerëzor, moralin, shoqërinë dhe ekonominë në përgjithësi.

Dijetarët Islam kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me urtësinë e ndalimit te kamatës. Mjafton të përmendim vetëm mendimet e Raziut në komentimin e tij të Kur'anit.

Kamata nënkupton marrjen e pasurisë së njeriut pa këmbim. Ai që shet një dërhem për dy, fiton një dërhem ekstra. Mbështetja në kamat i largon njerëzit nga puna, sepse pronari i dërhemit fiton një dërhem shtesë nëpërmjet kamatës, para ose pas kohës së caktuar dhe atë pa punuar fare.

Lejimi i kamatës i dekurajon njerëzit t'i bëjnë mirë njëri-tjetrit, ashtu siç kërkon Islami. Në shumë raste, marrësi i kamatës është i pasur kurse ai që merr hua me kamat, i varfër.

Përdoruesit e kamatës i kanë sjell shumë fatkeqësi njerëzimit

Pra përdoruesit e kamatës i kanë sjell shumë fatkeqësi njerëzimit. Në njërën anë është bërë pasurimi i tepërt, kurse në anën tjetër varfërimi i tepërt, me çka është bërë një ndarje mjaft e dukshme, derisa situata ka ardhur në ekstremin katastrofal me ç'rast, edhe ata që janë pasuruar nga kamata kanë pësuar dështim fatal.

Nuk duhet harruar ngjarja e viteve 1996-97 në Shqipëri, ku populli humbi paratë në institucione fantazma që punonin me kamatë, gjë që çoi në shkatërrimin, degradimin e djegien e vendit...

Kamatën jo vetëm feja që e ka ndaluar por edhe shumë ekspertë jomyslimanë e kanë etiketuar si virus i rrezikshëm për ekonominë. Njëri ndër këta që e ka parë kamatën si të rrezikshme është dr. Shahti (gjerman) i cili ishte drejtor i bakës gjermane "Rajh" i cili në një rast në Damask në vitin 1953 kishte deklaruar se përmes një llogaritje matematikore (të pa fund) vërehet qartë se, i gjithë kapitali në tokë sillet në duart e një numri të vogël të kamatëmarrësve...

Nga kjo mund të konkludojmë së i pasuri bëhet edhe më i pasur, kurse i varfëri bëhet edhe më i varfër, dmth: ai që ka pasuri mund të investoj në diçka që i sjell kamatë dhe kështu pasuria e tij rritet, kurse i varfëri që nuk ka edhe më tepër varfërohet. Pastaj edhe më brengosës është fakti se këta të pasur luajnë me të varfrit, duke i sjell në një gjendje edhe më të rëndë tashmë edhe psikike, sepse dihet- një njëri që pasurohet nëpërmjet kamatës ai kurrë nuk mundet të jetë njeri i mirë, sepse ai direkt është në konflikt me Zotin.


Nëse dëshirojmë jetë të qetë, shoqëri të shëndosh, ekonomi progresive, duhet heqim dora nga kamata, të huazojmë mes njëri tjetrit pa kamatë, sepse sistemet financiare mund të punojnë pa kamat si shembull i kemi bankat Islame ku punojnë pa kamatë, konformë parimeve Islame. Numri i këtyre bankave arrin mbi 180 dhe posedojnë kapital mbi 70 milion dollarë. Në këto banka përgjegjësia, fitimet dhe humbjet janë të njëjta në mes të klientit dhe bankës, këtu nuk ka fitim në kurriz të tjerëve.

Me anë të këtyre institucioneve financiare Islame do të kemi ekonomi stabile, afarizëm të ligjshëm, qytetar ku nuk i mbështesin punët vetëm në interes, motivim për punë, e shumë çka të mira. ■

dorimit të këtij instrumenti, fillimisht do të vërehej në afarizmin e tërësishëm të tyre.

Nga një vendosje e embargos ekonomia e Kosovës do të kishte përfitimet e veta. "Ajo çka është më interesante, duhet të mendohet se çka fiton Kosova nga një embargo e tillë. Në rend të parë do të kishte furnizim ndoshta me një çmim më të lartë, por me produkte kualitative, të cilat i plotësojnë standardet e kërkuara dhe deshëm apo jo do të imponohej mundësia e ngritjes së kapaciteteve shfrytëzuese të produkteve vendore, dhe kjo automatikisht ndikon në gjenerimin dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës", shprehet z. Gërxhaliu. Këtë lloj embargoje, Gërxhaliu e vlerëson si një dukuri që për Kosovën më shumë do të ndikonte pozitivisht se sa negativisht. Megjithatë, ai është i mendimit se nuk mund të ketë një embargo të tillë "sepse interesat Serbisë dhe interesat që produktet e saj të jenë në Kosovë, janë aq të mëdha saqë do gjendeshin alternativat indirekte që do të vazhdonin praninë e tyre në Kosovë". ■

Emocionet si pjesë përbërëse të njeriut



Emine A. VEZAJ


"O Zot, mos ma lë fenë pa kulturë!"
Dr. Ismail Bardhi (letër drejtuar vetvetes)

Dikur Dr. Ismail Bardhi kishte shkruar një letër drejtuar vetvetes, por si titullit ai kishte vërë këtë formulë; "O Zot, mos ma lë fenë pa kulturë!". Në atë kohë e kisha lexuar, madje edhe rilexuar atë letër, sepse me kishte pëlqyer struktura përmbledhëse e atij punimi. Unë në fakt, nuk mendova që të bëhem precedent i tij në këtë drejtim, megjithëse mirë do të ishte sikur të realizohej ajo që ai thoshte, por pak më ndryshe nga ai do të thosha; O Zot, largojë myslimanët nga emocionet dhe demagogjitë, udhëzoi ata drejtë shkencores dhe racionalizmit!.

Emocionet, janë tërësi e përjetimeve të thjeshta e të paqëndrueshme të njeriut që shkaktohen e shfaqen nën ndikimin e brendshëm, si mallëngjimi, shqetësimi a turbullimi i thellë. Dikur arabët hershëm thoshin se; zemra është burim i emocioneve. Zemra është ajo që donë, por edhe urren, kënaqet dhe zemërohet, dëshiron dhe frikësohet, gëzohet dhe mërzitet. Kështu njeriu nga vetë natyrshmëria e tij, nuk është vetëm trup dhe gjak, nuk është vetëm krijesë që ka vullnet dhe logjikë, por ka edhe anën tjetër të medaljes, ndjenjat dhe emocionet...

Në gjendjen emocionale, të cilën duhet të jetë besimtari i vërtet, duhet të jenë shembujt nga jeta e Pejgamberit a.s si dhe sahabëve të tij të ndershëm, e jo nga aktorët hoxhallarë të ditëve tona, të cilët aktrojnë para xhematëve të tyre. Tradita Pejgamberit a.s qartë tregon se emocionet dhe reagimet e momentit nuk mund t'i shpëtojnë asnjë njeriu, as edhe vet Pejgamberi a.s, pasi edhe ata gëzohen, qeshin, qajnë dhe mërziten, natyrisht janë krijesa të ngjashme me ne, përjashtimisht nga ne, janë të cilësuar si të Dërguar të Zotit dhe të ruajtur nga gabimet.

S'ka dyshim se ndjenjat janë pjesë përbërëse e njeriut dhe atyre askush nuk mund ti shmanget, njeriu nuk është rob dhe të jetë larg këtyre gjërave që janë pjesë e planit hyjnor, por njeriu duhet të dominoj, mbi ato si në raste gëzimi ashtu edhe pikëllimi, sepse sikur njeriu të ndjek ndjenjat dhe vrapon pas tyre kudo që e drejtojnë ato, kështu ai ka ndjekur epshin e tij. Pra, njeriu duhet të jetë i tillë, që të sillet në mënyrë të qetë dhe të butë ndaj secilit që vije të konsultohet më të, ashtu sikurse na ka mësuar edhe vet Pejgamberi Muhammedi a.s kur e këshilloi një njeri i cili në mes tjerash e këshilloi që të mos zemërohet. Pra, nga zemërimi mund të dalin edh fjalë, të cilat njeriu nuk do ti thoshte nëse ai do të ishte në gjendje të qetë, prandaj edhe gjykatësi kur gjykon duhet të jetë i qetë dhe transparent.



Teologëve të sotëm ju bie hise të përballen me sfida të rënda, ku shpesh ndodh që të kalojnë edhe nëpër faza emocionale. Por, gjithmonë duhet mu-nduar që të ruajnë personalitetin e tyre para çdonjërit që vije në xhami. Tani shtresa e xhematit tonë është heterogjene, (gjë e mirë) në xhami kemi prej intelektualit dhe deri te njeriu me i thjeshtë, secili e shikon hoxhën nga këndi i tij, dhe secili për hoxhën ka një imazh në vete.

Për një politikan, hoxha do të duket shumë i paskrupullt me mendimet e tij skandaloze rreth politikës aktuale, për një mjek, hoxha do të dukej një mostrum që flet për mjekësinë dhe simptomat e sëmundjeve që sjellë pirja e duhanit, për një historian hoxha do të dukej një injorant nëse thotë se Skënderbeu nuk është heroi ynë kombëtar. Kështu do të dukej një hoxhë në imazhin e xhamtit të tij, por si duket asnjëri nga xhematlinjët nuk ka dalë haptas të ja thotë hoxhës këto gjëra, ngase një pjesë prej tyre shkojnë në xhami vetëm për të kryer obligimin, e jo për të mësuar diçka të re, ndoshta edhe pse janë mësuar me avazin e vjetër të hoxhallarëve, ku secili ligjëron tema të përsëritura, madje shpesh. Por edhe ana tjetër e medaljes përgjegjësit e hoxhës. Nuk është në dorën e hoxhës mirëmbajtja 'estetike' e xhematit. Ndryshimi i faljes së namazit, hapja e këmbëve, shkurtimi i pantallonave pëshpëritja me zë të lartë gjatë aminit në namaz etj. Por, a është e udhës që hoxha të merë rolin e edukatorit e t'u tregojë xhematit se ti duhet t'i shkurtonin pantallonat më shumë se që duhet, duhet ta zgjasësh mjekrën, apo hoxhës i mbetet që me ligjërimin e tij të drejtë, xhematit të tij t'u mbushë zemrat me besim dhe t'i tregoj rrugën e drejt. A mund të konsiderohet edhe si fatkeqësi kjo që thash, apo vet hoxhallarët janë ata të cilët servirin për xhematët e tyre këso lloj temash?

Shumë teologë, hoxhallarë, krijojnë pa nevojë tregime...

Si myslimanët ashtu edhe vet hoxhallarët kanë probleme me vetveten e tyre, sepse myslimanët përderisa Islamin

e shohin si vlerë lokale, pjesë e traditës, i konservuar në disa interpretime të vjetruara, disa shekullore të shkollave të ndryshme juridike dhe i koncentruar vetëm në disa veprime periodike, si namazi, haxhi, agjërimi, të cilat edhe shpesh bëhen sa për t'u dukur atëherë, fatkeqësia nuk është vetëm të hoxha, por edhe vet myslimanët, gjithsesi se kjo do të ishte edhe një rezultat i hidhur i vet hoxhallarëve, të cilët ndjekin gjithmonë precedentin e gjeneratave të vjetra. Xhamia që nga zanafilla e saj është konsideruar dhe ka qenë qendra kryesore për informim të gjithëmbarshëm nga të gjitha aspektet. Ka qenë qendër informimi për mbarë botën, informim rreth shkencës, kulturës, artit historisë së kaluar etj. Nuk duhet keqkuptuar edhe këtë fakt se në xhami nuk shkohet që t'u mbushet truri njerëzve me dituri ekzakte, por larg asaj që në xhami të tregohen përralla. Xhamia është vend i shenjtë, por është edhe qendër informimi për besimtarët. Ajo si e tillë që nga e kaluara edhe sot ka këtë zanafillë, informimin e sigurt të njeriut me besimin e pastër.

Islami është besim i argumentuar dhe njeriu nuk ka se çka të flas prej mendjes së tij, ose të bëjë zhurmë pa nevojë në atë të cilët nuk mund ta ndryshoj. Shumë teologë, hoxhallarë, krijojnë pa nevojë tregime interesante shpesh të duken edhe si përralla e një mijë e një netëve, duke e paraqit Islamin si fe e trilluar dhe shpesh e argumentuar me përralla dhe trillime. Dikur, jo rastësisht hyra në xhami për të falë namazin e xhumasë. Pritja që hoxha të ligjëronte ndonjë temë të bazuar në argument dhe fakte, ngase argumenti është mënyra e vetme që t'ia mbush mendjen e njeriut. Jo rastësisht, ai filloi një rrëfim shumë 'interesant' të një njeriu i cili ishte ngritur nga varri...dhe vazhdonte hoxha tregimin e tij, derisa filloi edhe të qante kinse nga emocionet që i ngriheshin gjatë tregimit, në anën tjetër mendojë me vete, sa shkencore more hoxhë është kjo tema juaj, a nuk mendon se xhematin e ke shumë të formuar dhe duhesh të ndihesh krenar për këtë, dhe ata presin së paku një ditë në javë nga t'i, që të jesh i përgatitur si duhet, dhe t'i del këtu dhe na tregon përralla interesante... Si duket hoxhallarëve askush nuk i ka përkujtuar ajetin kuranor, ku Allahu xh.sh thotë "...Sillni argumentet tuaja (për çka thoni) po qe se jeni të drejtë?"

Sërish kthehem në fillim dhe them: O Zot, mos më lërë fenë të udhëheqin demagogët. Do të duhej të na ngushëllonte edhe ky fakt, se e gjithë kjo nuk ndodh vetëm me hoxhallarët tanë, ngase Allahu në mënyrë të përgjithësuar ka thënë se: **"Pra shkatërrimi është për ata që falen..."***(El-Maun:4-5)*

Besimi Islam nuk është vetëm dije fetare...

Kur flasim për argumente shkencore, nuk kam për qëllim që xhematit t'i ligjërohet për shkencat e natyrës, apo edhe shkencat tjera, por ajo që dua të nënvizoj është dituria për të cilën ka folur edhe Islami dhe dijetarët e mëhershëm. Besimi Islam nuk është vetëm dije fetare siç pretendojnë dhe ngatërrohen disa. Me dituri kam parasysh çdo gjë me anë të së cilës dalin në pah të vërtetat e gjërave cilado qofshin ato, rreth gjithësisë, njeriut etj. Por me shkencore përqëllimohet edhe njohja e rizgjimit Islam dhe çlirimi i tij nga emocionet e justifikimet, por vendimet tona në të gjitha sferat të burojnë nga mentaliteti shkencor.



Në kohën e përparimit më të madh të shkencës dhe teknologjisë ekzistojnë të gjitha mundësitë që hoxha para xhematit të tij të del sa më cilësor, duke filluar nga prezantimi i ligjërimit në mënyrën më serioze nëpërmjet projektorëve të ndryshëm, deri edhe te përgatitja e ligjëratës në mënyrë të shkruar si dhe shpërndarja e saj për të gjithë të pranishmit.

Islami nuk është i mbyllur vetëm në metodën tradicionale, ai është besim për çdo vend dhe kohë, për këtë ka garantuar edhe vet Zoti, dhe ne nuk duhet t'i frikësohemi ligjërimit modern dhe dështimit për humbjen e tradicionales. Hoxha nuk ka profesion ligjërimin e tij, ai duhet të dijë se rruga e tij është mision shumë me përgjegjësi dhe për çdo gjë do të përgjigjet, andaj sa më i kujdesshëm që të jetë aq më i dashur do të jetë si për Krijuesin ashtu edhe për ndjekësit e tij, xhematin.

Pra, rruga e rizgjimit Islam kërkon nga besimtari përdorimin e të gjitha metodave më të përparuar dhe më të mira për realizimin e qëllimit, duke përfituar edhe nga përvojat e të tjerëve, përfshirë këtu edhe kundërshtarët, sepse urtësia është ajo që kërkon besimtari, kudo që ta gjejë ai është më i meritueshëm për të.


Pejgamberi a.s është përpjekur të përfitoj nga statistikat që në fillim të formimit të shtetit Islam në Medinë. Transmetohet se Pejgamberi a.s kishte urdhëruar një sahabet të tij, që të llogaritet të gjithë ata që dëshmojnë se janë myslimanë. Me këtë, myslimanët do të informoheshin se sa është forca e tyre...

Ne tani çfarë na mbetet të llogarisim. Në bazë të statistikave që posedojmë, llogaritmi si përqindje më e madhe e përkatësisë myslimane, por që nga asnjë hoxhë nuk është komentuar gjendja reale e kësaj përqindje. Ndodh që të jenë vetëm statistika, por jo edhe gjendje reale llogaritur në bazë të asaj që praktikohet tek njerëzit dhe prezencës së xhematit në xhami.

Hoxhallarët duhet planifikuar çdo gjë për rrethanat dhe kohën, t'i përgatisin dhe t'i informojnë xhematin e tyre rreth çdo situate nëpër të cilën janë duke kaluar edhe myslimanët në mbarë botën, por gjithsesi edhe duke i informuar ata me metoda të reja për përballje edhe sfidat e kohës. E gjithë kjo do angazhim serioz. Allahu do të ndihmojë të gjithë ata që përpiqen në punë të hairit si dhe ata që kontribuojnë në ngritjen e fjalës së Tij, kurse fitorja do të vije si garanci për punëtorët e sinqertë dhe besimtarët besimdrejt. ■

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

PO VJEN BE-ja...



Demir RESHITI

Çështja e statusit të Kosovës ka qenë një nga ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare. Madje një sondazh i realizuar nga qendra ruse për hulumtimin e opinionit, negociatat për statusin e Kosovës i ka vlerësuar si ngjarjen kryesore ndërkombëtare për vitin 2007.

Gjatë muajit dhjetor, Liderët e Bashkimit Evropian janë pajtuar që të dërgojnë mision policor dhe civil në Kosovë. Edhe ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s janë pajtuar që të mbajnë një forcë të fuqishme paqeruajtëse në Kosovë, që do të jetë e gatshme t'i kundërpërgjigjet dhunës eventuale gjatë periudhës kur pritet përcaktimi i statusit të Kosovës.

Ndërkohë Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-Moon, i është dorëzuar raporti i Treshes ndërkombëtare për statusin e Kosovës, në të cilin është theksuar se negociatat shtesë kanë përfunduar pa sukses...

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit dhjetor 2007.

(3 dhjetor) "Treshja" ua dorëzon palëve raportin lidhur me përmbajtjen e negociatave



Masimo D'Alema

Prishtinë/Beograd - Treshja ndërkombëtare në bisedimet për statusin e Kosovës, është takuar në Prishtinë dhe Beograd me zyrtarët më të lartë të Kosovës dhe të Serbisë. Ata të dy palëve ua kanë dorëzuar raportin preliminar lidhur me përmbajtjen e negociatave, raport ky i cili me 10 dhjetor, do t'i procedohet Sekretarit te Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

(4 dhjetor) Craddok: NATO e përgatitur për t'ju përgjigjur dhunës

Uashington- Komandanti i lartë i NATO-s, John Craddok, gjatë një fjalimi në Klubin Kombëtar të Shtypit në Uashington ka thënë se forcat e tij janë të përgatitura për t'ju përgjigjur dhunës potenciale, derisa Kosova po përgatitet ta shpallë pavarësinë e saj.

(5 dhjetor) D'Alema: Pavarësia e Kosovës nuk ka alternativë

Romë-Ministri i Jashtëm dhe nënkryetari i Qeverisë italiane Masimo D'Alema i



NATO

ka deklaruar gazetës 'Matino' se nuk sheh alternativë për pavarësinë e Kosovës. "Në të ardhmen nuk shoh alternativë për pavarësinë e Kosovës. Por nga Kosova duhet kërkuar përgjegjësi, sepse nga ky proces Serbia nuk bën të dalë e humbur dhe e poshtëruar", ka thënë D'Alema.

(6 dhjetor) Rice kërkon shtyrjen përpara të pavarësisë së Kosovës

Bruksel-Sekretarja amerikane e Shtetit, Condoleezza Rice ka kërkuar vendosjen e sanksioneve të reja ndaj Iranit dhe shtyrjen përpara të pavarësisë së Kosovës. Rice përsëriti nevojën për zbatimin e planit të Ahtisaarit për "pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën", pas dështimit të bisedimeve shtesë.

Vjenë- Pavarësia e Kosovës është e pashmangshme, duke pasur parasysh dështimin e bisedimeve shtesë, ka thënë kancelari austriak Alfred Gusenbauer në një intervistë që do



Bashkimi Evropian - BE

botohet nesër në të përditshmen Kurier.

Bruksel- Kosova do të bëhet e pavarur në maj të 2008-ës nëse SHBA-të dhe vendet kryesore të BE-së do ta mbështesin vendosmërisht, thuhet në raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave.

(7 dhjetor) NATO do të mbajnë një forcë të fuqishme paqeruajtëse në Kosovë

Bruksel- Ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s janë pajtuar që të mbajnë një forcë të fuqishme paqeruajtëse në Kosovë, që do të jetë e gatshme ti kundërpërgjigjet dhunës eventuale gjatë periudhës kur pritet përcaktimi i statusit të Kosovës, pas dështimit të negociatave ndërmjet Prishtinës e Beogradit.

Nju Jork-Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-Moon, i është dorëzuar raporti i Treshes ndërkombëtare për statusin e Kosovës. Këtë, e ka konfirmuar zëdhënësi i tij, Brendon Varna.

Bratisllavë- Sllovakia "nuk do ta mbështesë pavarësinë e Kosovës nëse ajo e shpallë atë njëanshëm, e për këtë veprim nuk ka vendim të Kombeve të Bashkuara apo të ndonjë organizate tjetër ndërkombëtare relevante", ka thënë kryeministri sllovak, Robert Fico.

(10 dhjetor) Ischinger: Bashkimi Evropian do ta njohë pavarësinë e Kosovës...

Berlin - Bashkimi Evropian do ta njohë pavarësinë e Kosovës, shpejt pas shpalljes së pavarësisë nga Prishtina, ka deklaruar për mediat gjermane diplomati Volfgang Ischinger duke shtuar se Kosova nuk do jetë një shtet sovran si Gjermania

apo Franca, pasi do vazhdojë të jetë nën mbikëqyrje të ndjeshme ndërkombëtare.

(11 dhjetor) Harçenko: Rusia do të kërkojë që KS i OKB-së ta anulojë deklaratën e njëanshme për pavarësi për Kosovën

Moskë-Rusia do të kërkojë që Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ta anulojë deklaratën e njëanshme për pavarësi për Kosovën, ka thënë sot anëtari i Treshes ndërkombëtare, Aleksandar Bocan Harçenko.


Johan Verbeke

"Rusia do të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurimit pasi kjo do të jetë shkelje e rezolutës së këtij Këshilli", ka thënë zoti Harçenko.

(12 dhjetor) Rice: Kosova dhe Serbia kurrë nuk do të jenë një

Uashington-"Është fakt se Kosova dhe Serbia kurrë nuk do të jenë një dhe ky është realiteti", ka thënë sekretarja amerikane Condolezza Rice në një intervistë të botuar në të përditshmen USA Today.

(13 dhjetor) Khalilzad: procesi i negociatave ka përfunduar

Nju Jork -Vendet perëndimore kanë refuzuar propozimin e Rusisë për vazhdimin e mëtejmë të bisedimeve për statusin e Kosovës. Duke reaguar ndaj propozimit rus, ambasadori amerikan në Kombet e Bashkuara, Zalmay Khalilzad ka thënë se SHBA-ja dhe evropianët janë të pikëpamjes se procesi i negociatave për çështjen e statusit final ka përfunduar.

(14 dhjetor) Liderët e BE-së bien dakord që të dërgojnë mision policor dhe civil në Kosovë

Bruksel-Liderët e Bashkimit Evropian janë dakorduar që të dërgojnë mision policor dhe civil në Kosovë. "Ne morëm vendim formal që të dërgojmë misionin Evropian të Politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë në Kosovë", ka thënë kryeministri i Portugalisë, Jose Socrates pas samitit të udhëheqësve të BE-së në Bruksel. Bashkimi Evropian përgatitet të dërgojë rreth 1.800 veta për misionin civil dhe policor në Kosovë.

(17 dhjetor) Rusia bën thirrje për një plan të ri paqeje për Kosovën

Moskë -Ministria e Jashtme e Rusisë ka bërë thirrje për një plan të ri paqeje për Kosovën, duke paralajmëruar për mundësinë e "krizës së pakontrolluar", nëse Kosova do të ecë përpara me shpalljen e njëanshme të pavarësisë.

(19 dhjetor) Verbeke: Është shterrë potenciali për zgjidhje të negociuar për Kosovën

Nju Jork-Potenciali për zgjidhje të negociuar për Kosovën është shterrë, pasi Këshilli i Sigurimit i OKB-së dështoi t'i afrojë ndarjet lidhur me Kosovën, thuhet në qëndrimin e përbashkët të Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian, që u lexua nga ambasadori i Belgjikës, Johan Verbeke. Në deklaratë theksohet se Bashkimi Evropian është i gatshëm ta udhëheqë procesin për të ardhmen e Kosovës.

(21 dhjetor) Lavrov: BE-ja mund ta zëvendësojë OKB-në në Kosovë

Moskë - "Nëse Bashkimi Evropian dëshiron t'i zëvendësojë Kombet e Bashkuara në Kosovë, atëherë kjo nuk është një variant i pamundur", ka thënë shefi i diplomacisë ruse Lavrov për mediat në Moskë.


Condoleezza Rice

(22 dhjetor) Rice: Vendimi për statusin e Kosovës duhet të merret në javët e ardhshme

Uashington- Sekretarja amerikane e shtetit Condoleezza Rice në konferencën e fundvitit ka thënë se vendimi për statusin e Kosovës, duhet të merret në javët e ardhshme, sepse shtyrja do të destabilizonte Ballkanin.

Lubjanë - Përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri i BE-së, Havier Solana në një intervistë për të përditshmen sllovene Dnevnik ka deklaruar se dërgimi i misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë, nuk paraqet shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

(25 dhjetor) Jakovenko: Rusia do t'i vërë veto çdo vendimi që do të njihte shpalljen e njëanshme të pavarësisë

Moskë - Rusia do t'i vërë veto çdo vendimi të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që do të njihte shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës, ka thënë zëvendës ministri i jashtëm rus Aleksandar Jakovenko.

(28 dhjetor) Casey: Është koha të përcaktojmë statusin përfundimtar të Kosovës

Uashington - "Ne të gjithë, jo vetëm Shtetet e Bashkuara, por dhe bashkësia ndërkombëtare, ndajmë të njëjtin mendim se është koha të përcaktojmë statusin përfundimtar të Kosovës", ka thënë zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Tom Casey.

Moskë-Rusët konsiderojnë se negociatat për statusin e Kosovës janë ngjarja kryesore ndërkombëtare për vitin 2007, tregojnë rezultatet e një hulumtimi që e ka zhvilluar qendra ruse për hulumtimin e opinionit.


Sipas anketës, 14% e rusëve konsiderojnë se çështja e pavarësisë së Kosovës është ngjarja më e rëndësishme ndërkombëtare ndërsa në vendin e dytë radhitet Iraku me 12%. Anketa është zhvilluar me 22 dhe 23 dhjetor, në të cilën janë përfshirë 1600 vetë në 153 vendbanime në 46 krahina të Rusisë.

(29 dhjetor) Brenton: Vendimi për statusin duhet të merret në fillim të vitit

Moskë - Vendimi për statusin e Kosovës duhet të merret në fillim të vitit të ardhshëm, ka deklaruar ambasadori britanik në Moskë, Tony Brenton.

(30 dhjetor) Wisner: Pavarësia- zgjidhja më e logjikshme

Beograd- "Nuk ka mënyrë që Kosova të jetë e gatshme të kthehet nën sovranitetin e Serbisë", ka thënë përfaqësuesi amerikan në treshen ndërkombëtare për statusin e Kosovës, Frank Wisner në një intervistë për gazetën beogradase "Veçernje Novosti" duke shtuar se zgjidhja më e logjikshme që Kosovës i sjell stabilitet dhe krijon qartësinë shumë të nevojshme për gjithë rajonin, është pavarësia. ■


Aleksandar Jakovenko

Kush do të na udhëheqë?

Osman D. GASHI

Pas disa javë negociatash ndërmjet PDK-së dhe LDK-së, më 9 dhjetor, deputetët e përbërjes së re të kuvendit të Kosovës të dalë nga zgjedhjet e 17 nëntorit, kanë zgjedhur institucionet e reja qeverisëse të cilat do ta drejtojnë Kosovën për katër vitet e ardhshme.

Në vazhdim do t'i prezantojmë ata që do të na udhëheqin, me nga një biografi të shkurtër.

Fatmir Sejdiu – kryetar i Kosovës

U lind më 23 tetor 1951 në Pakashticë të Podujevës. Ka mbaruar Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, më 1974, ku edhe ka mbrojtur disertacionin e doktoratës. Ishte mësimdhënës në Fakultetin Juridik dhe në atë të Shkencave Politike të Universitetit të Prishtinës. Në Kuvendin e Parë Zgjedhor të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), në vitin 1991, është zgjedhur anëtar i Këshillit të Përgjithshëm dhe më 1992 anëtar i Kryesisë së LDK-së, ndërsa më 1994 Sekretar i Përgjithshëm i LDK-së. Më 2001, në zgjedhjet e para demokratike të pasluftës, është zgjedhur deputet në Kuvendin e Kosovës dhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit, dhe është rizgjedhur sërish më 2004. Më 10 shkurt 2006, Fatmir Sejdiu është zgjedhur kryetar i Kosovës. Flet gjuhën frënge dhe angleze. Jeton në Prishtinë.

Hashim Thaçi – kryeministër i Kosovës

U lind më 24 prill të vitit 1968 në Burojë të Skenderajt. Është themelues dhe Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Gjatë luftës së Kosovës, ishte drejtor i "Drejtorisë Politike të UÇK-së". Menjëherë pas luftës Thaçi ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (1999-2000). Ishte përfaqësues i UÇK-së në delegacionin e shqiptarëve nga Kosova në konferencën e Rambouillet në Paris. Ka studiuar histori në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës. Studimet pasdiplomike i ka vazhduar në Universitetin e Cyrihut. Ai flet edhe gjermanishten dhe anglishten. Banon në Prishtinë.

Jakup Krasniqi – kryetar i Kuvendit të Kosovës




U lind më 1 janar 1951 në Fatos (Negroc) të Drenasit. Ka diplomuar në Degën e Historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës ku edhe e ka mbrojtur tezën e magjistraturës (2003). Ishte pjesë e lëvizjes ilegale në Kosovë në periudhën 1973-1981 dhe i burgosur politik në vitet '81–'91. Ishte anëtar i Kryesisë së LDK-së në Drenas dhe deputet i Parlamentit të pakonstituuar të Kosovës. Dy vite ka qenë zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Me themelimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ishte zgjedhur Sekretar i Përgjithshëm i saj. Ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës dy mandate, ministër i Shërbimeve Publike në periudhën e pasluftës (2002-2004) dhe kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së në mandatin e dytë. Flet gjuhën angleze dhe serbokroate. Jeton në Prishtinë.

Hajredin Kuçi – zv/kryeministër



U lind më 2 janar1971 në Arbanë të Pejës. Ka përfunduar Fakultetin Juridik në Prishtinë, studimet për master në Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Universitetin e Bilkentit në Ankara të Turqisë dhe studimet për doktoraturë në Universitetin e Graz-it në Austri dhe në Universitetin e Prishtinës. Është ligjërues në disa universitete. Po ashtu është profesor në Fakultetin Juridik dhe në atë Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ka qenë drejtor i zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës deri më 1998. Flet gjuhën angleze dhe serbokroate. Jeton në Prishtinë.

Ramë Manaj – zv.kryeministër




U lind më 24 korrik 1954 në Gllarevë të Klinës. Ka kryer Fakultetin Juridik në Prishtinë. Ka punuar në arsim; në të përditshmen "Rilindja", kurse pastaj në kompaninë e boksiteve. Ka qenë nënkryetar i LDK-së në Klinë, anëtar i Kryesisë së LDK-së në Klinë. Në zgjedhjet e para lokale në Klinë ka qenë anëtar i Asamblesë Komunale, kurse kryetar i kësaj Asambleje në periudhën 2001–2006. Ka qenë këshilltar politik e ligjor i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha. Aktualisht është anëtar i Kryesisë dhe Sekretar i Përgjithshëm i LDK-së.

Nekibe Kelmendi – Ministre e Drejtësisë



U lind më 11 maj 1944 në Pejë. Ka kryer Fakultetin Juridik. Është avokatja e parë në historinë e gruas shqiptare në Kosovë. Ka punuar si arsimtare e Fizikës në fshatin Raushiq të Pejës, si referente në Ndërmarrjen e Banesave në Prishtinë, ka qenë gjyqtare në Gjykatën Komunale dhe në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, sekretare e Odës së Avokatëve të Kosovës, bashkëdrejtuese e Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, anëtare e Kryesisë së parë të LDK-së dhe është sekretare e LDK-së.

Enver Hoxhaj – Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



U lind në vitin 1969 në Peqan të Suharekës. Ka studiuar në Universitetin e Vjenës, ku ka marrë titullin e Doktorit të Filozofisë në Histori (1994-2000). Ka qenë bashkëpunëtor shkencor në Universitetin e Vjenës, pranë Ludwig Boltzmann Institute. Është profesor në Departamentin e Shkencave Politike të Universitetit të Prishtinës. Ka qenë bashkëpunëtor shkencor në London "School of Economics", pranë Qendrës për Studimin e Qeverisjes Globale. Ka qenë Kryetar i Komisionit për Arsim, Kulturë e Rini dhe Shef i Departamentit për Arsim, Shkencë e Teknologji në Kabinetin e Qeverisjes së Mirë të PDK-së. Ka qenë anëtar i delegacionit të Kosovës në procesin Vjenës për përcaktimin e statusit final të Kosovës.

Lutfi Zharku – Ministër i Tregtisë dhe Industrisë

U lind me 19 nëntor 1962 në Kaçanik. Ka kryer Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Ka qenë drejtor financiar i kompanisë "Sharri" të Hanit të Elezit, drejtor

komercial i të njëjtës kompani, asistent për Ekonomi në UNMIK, shtylla e IV-t. Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së në Kuvendin e Kosovës, anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.



Famir Limaj – Ministër i Transportit dhe Post-Telekomunikacionit



U lind më 4 shkurt 1971 në Banjë të Malishevës. Ka të kryer Fakultetin Juridik dhe studimet pasuniveristare në drejtimin Administrativo-Politik. Ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zv/ministër i Ministrisë së Mbrojtës të Kosovës, sekretar për Marrëdhënie me Publikun në PDK dhe shef i Grupit Parlamentar të PDK-së në Kuvendin e Kosovës. Tani mban postin e nënkryetarit në këtë subjekt politik. Ka pasur të lëshuar fletarrest nga Tribuanli i Hagës vitin 2003 për dyshimin se ka kryer krime mbi civilët gjatë luftës së Kosovës dhe pas një procesi gjyqësor është liruar si i pafajshëm. Flet gjuhën angleze, italiane dhe serbe. Jeton në Prishtinë.

Arsim Bajrami – Ministër i Shërbimeve Publike

U lind më 19 mars 1960. Është profesor i rregullt në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ka qenë prorektor i këtij universiteti. Është anëtar i kryesisë së PDK-së. Flet gjuhën angleze. Jeton në Prishtinë.



Alush Gashi – Ministër i Shëndetësisë



U lind me 4 tetor 1950. Ka gradën Dr. Sci. (Doktor shkence) në fakultetin e Mjekësisë. Ka qenë Sekretar për Marrëdhënie me Jashtë i LDK-së, anëtar i Kryesisë së po këtij subjekti politik. Deputet në kuvendin e Kosovës dhe shef i Grupit Parlamentar të LDK-së. Ishte anëtar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evro-Atlantik.

Skënder Hyseni – Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

U lind më 17 shkurt 1955 në Dobratin të Besianës. I ka kryer studimet e gjuhës dhe linguistikës në Universitetin e Prishtinës. Ishte këshilltar politik i kryetarit të Kosovës, Fatmir Sejdiu si dhe zëdhënës i Grupit të Unitetit. Jeton në Prishtinë.



Justina Pula-Shiroka – Ministre e Energjetikës dhe Minierave



U lind në Prishtinë. Ka përfunduar studimet themelore më 1976 në Prishtinë në Fakultetin Ekonomik. Gradën Doktor e ka marrë më 1997 në Universitetin e Prishtinës. Ka qenë menaxhere e shumë projekteve. Është profesoreshë e Fakultetit Ekonomik në UP, anëtare e Komitetit këshillëdhënës nga Qendra për shoqëri qytetare në Prishtinë dhe drejtoreshë e Qendrës afariste ndërkombëtare në Prishtinë.

Ahmet Shala – Ministër i Ekonomisë dhe Financave



Është profesor i Universitetit të Prishtinës, ligjëron lëndën e modelet e marketingut. Është zëvendësdrejtor i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, është i njohur në procesin e privatizimit. Ka punuar në Departamentin për Tregti dhe Industri, që funksiononte si një lloj Qeverie e Përkohshme e Kosovës. Ai në AKM ka punuar si shtetas i Shqipërisë, në mënyrë që të paguhet më shumë si shtetas i huaj. Ka qenë drejtor në njërën prej drejtorive në Ministrinë e Ekonomisë menjëherë pas luftës 1999.

Zenun Pajaziti – Ministër i Punëve të Brendshme



U lind në Prishtinë. Është kryetar i Federatës së Volejbollit të Kosovës. Ka qenë këshilltar i ish-Kryeministrit Bajram Rexhepi ndërsa në qeverinë nën hije, ishte udhëheqës i Departamentit të Sportit. Ka qenë i angazhuar në vitin 2000 si bashkëdrejtues i Departamentit për Rini dhe Sportit në Këshillin e Përgjithshëm Administrativ.

Idriz Vehapi – Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



U lind më 15 dhjetor 1964 në Zatriq, të Rahovecit. Ka magjistruar në Seksionin e Biologjisë të FSHMN-së në Prishtinë më 1989 ku e dhe ka mbrojtur disertacionin e doktoratës me titull: "Kontribut valorizimit të ujërave të lumit Drini i Bardhë në bazë të disa parametrave fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë". Ka botuar shumë punime shkencore si autor dhe koautor.

Mahir Yagcilar – Ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor



U lind më 6 maj 1961 në Prizren. Është Inxhinier i diplomuar i komunikacionit rrugor. Ka qenë zv/kryetar i dytë në Komisionin për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim, ka pasur poste të ndyshme nëpër komisionet parlamentare. Është Kryetar i KDTP-së (2000), Udhëheqës i stacionit të autobusëve në Prizren (2001), Deputet në mandatin e parë të Kuvendit të Kosovës dhe anëtar i Këshillit Transitor i Kosovës. Jeton në Prizren.

Sadri Ferati – Ministër i Pushtetit Lokal

U lind më 10 qershor 1957. Ka të kryer Fakultetin e Xehtarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë. Prej vitit 1985–1992 ka punuar si shef i sektorit të zhvillimit në industrinë e ngjyrave dhe llaqeve "Extra" në Vushtrri. Nga viti, 1993–2004, me disa ndërprerje të vogla ishte menaxher i ndërmarrjes private "Molitoria" në Vushtrri, 2004-2005 drejtori i Qendrës së Kulturës "Rexhep Mitrovica" në Mitrovicë. Nga muaji tetor 2005 ka punuar si kryeshef i Ekzekutivit të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës. Ka qenë sekretar dhe nënkryetar i Degës së LDK-së në Mitrovicë dhe deputet i Kuvendit të Kosovës.



Boban Stankoviq – Ministër i Kthimit



Ka lindur në Crkvena Vodicë, kurse jeton në Fushë Kosovë. Ka përfunduar shkollën e mesme për gjeometër. Deri para një viti ka punuar në zyrën për të ardhura publike në Fushë Kosovë. Është i martuar dhe baba dy fëmijëve.

Nenad Rashiq – Minstër i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

U lind në Dobrotin. Është teknik i ekonomisë. Vjen nga Partia e Pavarur Liberale të cilën e udhëheq Slobodan Petroviq. ■



KREMTIMI I VITIT TË RI MES LEGJENDËS DHE TË VËRTETËS

Kremtimi i Vitit të Ri ose i ndërrimit të moteve është një kremte pagane dhe është nga kremtet më të vjetra. Sipas një statistike botërore të publikuar nga amerikanët, 96 % e popullsisë së botës pa dallim feje, nacionaliteti, race apo vendi, e kremtojnë ndërrimin e moteve të bazuar në kalendarin gregorian



Fitim FLUGAJ

Besimtarët e feve të ndryshme, e veçmas ata të krishterë, festen e ndërrimit të moteve ia kanë arritur ta shndërrojnë në kremte të krishterë. Ata kanë shkuar aq larg sa e kanë shenjtëruar një njeri me emrin Nikolas. Ky i fundit as që kishte të bëjë me besimin krishterë dhe pikërisht kjo e cilëson këtë festë si festë me fillet e saja pagane.

Por, para se të flasim për fillet pagane të vitit të ri të kuptojmë çka është Shën Kolli ose i ashtuquajturi Nikolasi i shenjtë, çka është Babadimri, çka janë krishtlindjet dhe çka është Viti i Ri.

Nikolasi ose Shën Kolli

Edhe pse gjërat më shumë janë të mbështetura në mitologji se sa në shënime të sakta, të cilat për ta ruajtur origjinalitetin e tyre kërkojnë bartje ose transmetim zinxhirore me shkrim dhe gojë, në këtë rast çdo gjë është e mbështetur në thashetheme dhe hamendje, me qëllim që të gjendet mbështetje për një doktrinë të caktuar. Këtë radhë ka të bëjë me mbështetjen e doktrinës së humanitetit në krishterizëm, e sidomos këtë e argumenton fakti se Nikolasi u shenjtërua shumë shekuj më vonë pas vdekjes së tij. Promovimi i shenjtërisë së Nikolasit u bë në vitin 1804 përderisa ai vdiq me 6 dhjetor 327 sipas konkludimeve të pa sakta, sepse një mendim tjetër thotë se ka vdekur në vitin 343 të erës së re.

Nikolasi, sipas disa burimeve ka lindur aty mes viteve 270 – 280 në Patara të Mires, në krahinën Licija të Azisë së Vogël, që sot njihet me emrin Demre në Anatolia të Turqisë.

Nikolasi përveç që është i njohur si Shën Nikolasi i Mires, ai njihet edhe me emrin Shën Nikolasi i Barit, sepse në vitin 1087 pjesëtarët e Kishës Katolike Romake i bartën eshtrat e tij nga Turqia në Bari të Italisë.

Nikolasi ishte biri i një njeriu të pasur që jetoi në kohën e perandorit Bizantin Diklocianus me origjinë Ilire, i cili njihet si perandori më gjakpirës që jetoi në mes viteve 245- 316 dhe i cili mbyti shumë ithtarë të besimit të Isaut a.s., besim ky që ende kishte elemente të besimit në një Zot fuqiplotë, pa kaluar ende në Trini.

Babai i Nikolasit ishte pagan. Ai vdiq i ri dhe i la trashëgim një pasuri mjaft të madhe Nikolasit që e kishte si të vetmin djalë. Nikolasi një kohë kaloi edhe në Aleksandria të Egjiptit për të studiuar në Universitetin e Aleksandrisë Ptolemeane, e cila edhe pasi ta shpall perandori Konstantin (306 – 337) besimin krishterë si fe shtetërore, mbetët edhe për një kohë të gjatë vendstrehim i gjeneralëve bizantin që e urrenin fenë krishtere dhe besonin në forcën e dominimit personal dhe ushtarak. Kjo vazhdon deri në fillim të shekullit të shtatë të erës së re, kur myslimanët me ndihmën e priftërinjve dhe besimtarëve krishterë të Egjiptit arrijnë ta çlirojnë Egjiptin në mes viteve 601-602.

Nikolasi jetoi dhe u rrit si pagan, mirëpo ai kishte një shpirt human dhe ndante dhurata për të varfër dhe për shtresat që shfrytëzoheshin si skllav, siç ishin prostitutat dhe njerëzit e vobektë dhe detarët. Tani të krishterët besohet se Shën Nikolla (Shën Kolli) ju ndihmon këtyre shtresave.

Kështu ishte sa i përket Shën Nikollës, i cili te protestantët, në veçanti ata që flasin anglisht e njohin me emrin Santa Claus, Saint Nicholas, Kris Kringel etj. Francezët e njohin me emrin Pere Noel, gjermanët Weihnachtsmann, arabët Baba Nuel etj.

Në Mitologjinë moderne ai është që sjell dhurata fëmijëve dhe të rinjve me rastin e Krishtlindjeve dhe ndërrimit të motmoteve –Vitit të Ri, ai paraqitet me një veshje të kuqe dhe me mjekër të bardhë që simbolizon vitin e vjetër të lodhur dhe të thinjur por që pas lenë vetëm të mirat- anën pozitive dhe me vete merr anën negative.

Viti i ri te myslimanët

Te myslimanët fundamentalë dhe jolaikë Viti i Ri kremtohet me lutje dhe përpjekje për reforma pozitive me datën 1 Muharrem sipas kalendarit hënor, kalendar ky i cili fillon me emigrimin e Muhamedit a.s. nga Mekka në Medine, që paraqet edhe një ndryshim rrënjësor edhe për botën mbarë.

Ky kalendar islam që ka marrë ngjyrën fetare quhet ndryshe edhe Kalendari Hixhri (i Emigrimit) dhe mbështetet në lëvizjet e hënës dhe jo sipas lëvizjeve të diellit, siç është kalendari Julian dhe Gregorian e të tjerët, dhe brenda vitit ka dhjetë ditë më pak. Kjo ngase ndryshimet e hënës janë më të shpeshta dhe muajt hënor kanë ditë më pak se sa ata diellorë (ata kanë 26 deri 30 ditë, ndërsa muajt diellorë prej 28 deri 31 ditë).

Kjo figurë me këtë veshje për herë të parë na paraqitet në SHBA në vitin 1881 dhe e quajtën Father Christmas që në gjuhen shqipe njihet me emrin Baba Dimri apo Gjyshi i Vitit të Ri.

Krishtlindjet (Christmas) dhe Viti i Ri

Vetë fjala Krishtlindjet nënkupton se ka të bëjë me lindjen e Krishtit apo Isait a.s.. Sipas versionit katolik-romak dhe protestan mendohet se ka lindur më 25 dhjetor të vitit të parë sipas erës së re në qytetin Bejt-Lahem (Shtëpia e mishit) në Palestinë, ndërsa sipas ortodoksëve 7 janari ditëlindja është e Isait a.s.(Paqa e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe për të).

Duhet theksuar se Isai a.s. njëri nga të dërguarit më të shquar të Zotit që iu shpall revelata me emrin Ungjill (Besëlidhja e Re): "E duke u falur ai në faltore, engjëjt e thërrasin: 'All-llahu të përgëzon ty me Jahjanë, që do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga All-llahu, e që do të jetë prijës i matur dhe pejgamber nga të dalluarit!'" Kuran 3:39...

Emri Isa dalëngadalë morri trajtën e emrit nga Isa- në ebreisht dhe gjuhet semite në Isus- Latinisht, e më vonë Isus Kristus (Isai i kryqëzuar).

Kryqi ishte mjet të cilin e përdornin romakët dhe bizantinët për t'i thumbuar dhe dënuar kundërshtarët e tyre, mirëpo kah shekulli i katërt lind një doktrinë e re në fenë krishtere dhe kryqi fillon të shndërrohet në simbol të besimit të krishterë, ashtu siç është edhe sot.

Sa i përket çështjes së kryqëzimit të Isait a.s. vlen të theksohet se në fenë Islame Isai a.s. përveç që duhet trajtuar si i zgjedhur i Allahut- i dërguar, ai në të njëjtën kohë ka qenë argument i Zotit në tokë, që ka argumentuar fuqinë absolute të Allahut dhe ua ka demantuar çifutëve magjinë dhe besimin e gabuar se Zoti ka djalë si dhe ua ka argumentuar vërtetësinë e Tevratit. Këtu na del në pah një argument shumë i fuqishëm që në aspektin tekstual është i theksuar shumë qartë nga Kurani: "Madje për shkak të thënies së tyre: 'Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e All-llahut'. Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytën atë'". Kuran 4:157...

Megjithatë, Krishtlindjet janë bërë festë shtetërore edhe këtu në Kosovë, sipas dy versioneve (kremtohet edhe 24-25 dhjetori edhe 7 janari), edhe përkundër faktit se proklamohemi shtet laik, ashtu siç bëjnë edhe shtetet tjera evropiane.

Sa i përket vitit të ri i cili pason menjëherë pas krishtlindjeve, sipas asaj që u theksua më lartë, viti 1881 është viti që figuron si fillim i kremtimit modern, kur për herë të parë na paraqitet Babadimri me veshjen e tij karakteristike në SHBA, i cili paraqitet me dhurata edhe për Krishtlindje edhe për Vitin e Ri. Kjo nuk ndodh gjithkund njësojë. Më parë kur ekzistonin Blloku perëndimor i përbërë me shumicë nga shtetet e banuara me besimtarë katolikë dhe protestan + Turqia e që kremtoheshin Krishtlindjet e pastaj Viti i Ri dhe merrte formën fetare, në shtetet e Bllokut Lindor-Komunist kremtohej vetëm Viti i Ri.



Kremtimi i Vitit të Ri në mes të kaluarës dhe aktuales

Kremtimi i Vitit të Ri ose ndërrimit të motmoteve është një kremte pagane dhe është nga kremtet ma të vjetra. Sipas një statistike botërore të publikuar nga amerikanët, 96 % e popullsisë së botës pa dallim feje, nacionaliteti, race apo vendi, e kremtojnë ndërrimin e motmoteve të bazuar në kalendarin Gregorian.

Megjithatë popujt e besimeve dhe nacionaliteteve të ndryshme kremtojnë edhe nga një vit të Ri të tyre, jo në janar sipas edhe kalendarit të Julian Cezarit po edhe në shkurt, mars e besa edhe në prill .

Kinezët e festojnë Vitin e ri në mes datës 21 janar-21 shkurt; Siket Nanakashi më 14 mars; persianët ose iranianët kanë kalendarin e tyre dhe e festojnë vitin e ri më 20 mars dhe e quajnë Nevruz; Zoroastritet, (besim i sajuar hindus) e kremtojnë Nevruzin në Parsisi të Indisë; Bahajet e kremtojnë Nevruzin më 21 mars; Viti i Ri Tulugu që festohet te sekti Hindus në Indi herë kremtohet në mars e herë në prill dhe e quajnë Vitin e Ri Maharashtra; Besimi i sajuar hindus Sind-hi e festojnë një festë me emrin Çeti Çand dhe mbështetën në kalendarin Hindus.

Në muajin prill e festojnë:

Sipas Kalendarit Asirian, kremtohet më 1 prill dhe quhet Rish Nissam; Në Pengjabi e kremtojnë me 13 prill dhe i thonë Vaisakhli; Në Kamboxhia viti i ri quhet Lao dhe kremtohet me 13-15 prill; Tamilet në Shiri Lankë e quajnë Sinhalese dhe e kremtojnë në mes të prillit; Në Bangladesh dhe Indi populli Bengal e quan Pohela Baisakh dhe e kremton mes datës 14-15 prill; Te Hebrejët kremtohen shtatë ditët e Kreacionit dhe ripërtëritjes së botës (natyrës) si viti i ri, që mbështetet në kalendarin Hebre; Te Kiptasit Ortodoks-Krishter të Egjiptit, Viti i Ri kremtohet sipas kalendarit Kiptas me 11 shtator; Japonezët gjithashtu kanë vit të ri të veçantë; Te arabët ekziston një kalendar i vjetër arab që në pranverë kremtohet viti i ri, etj.

Siç e pamë, nuk është vetëm një vit i ri por ka disa, mirëpo më i popullarizuari dhe që ka marrë dhenë nëpër të gjitha anët e botës është Viti i Ri sipas kalendarit Gregorian me origjinë pagane.

Mbi të gjitha kremtimi i vitit të ri është krijuar edhe si një ngjarje botërore me leverdi të madhe ekonomike ku shpenzohen shuma të larta për shërbime dhe mjete plasëse e ushqime dhe pije.

Kjo u vërejt qartë edhe në Kosovë gjatë këtyre ditëve festive ku janë bërë shpenzime marramendëse përkundër krizës dhe pa punësisë.

Vlerësojmë se në këtë drejtim ka luajtur rol edhe tradita që u krijua gjatë sistemit të kaluar komunist, i cili sistem i ka kushtuar rëndësi kësaj feste dhe 1 Majit me qëllim që ta largojë popullin nga festat me bazë fetare dhe t'i zëvendësojë me festa pagane dhe që bazohen në hamendje. Një gjë e tillë është bazuar në ideologjinë marksiste. Marksi thoshte që ritualët dhe festat fetare duhet zëvendësuar me argëtim nga teatri dhe muzika. ■

Histori Islame (14)

Kur'ani kishte paralajmëruar për fitoren e Bizantit ndaj Persisë

Sipas rregullave njerëzore, kur një superfuqi humbë luftën ajo nuk është në gjendje ta rimarr veten përpara një shekulli, por rasti Bizantit bëri përjashtim. Kjo mrekulli u vërtetua sepse nëntë vjet më herët Kur'ani kishte paralajmëruar për fitoren e Bizantit ndaj Persisë. Mendohet se nxitësi kryesor për mobilizim dhe fitore për Herakliun ishte sureja e Kur'anit-Bizanti.



Muhamed JUSUFI -KAJOLLI

Mesazhi dërguar Kisras, perandorit të Persisë

I dërguari All-llahut pak vite para se të ndërronte jetë, të gjithë liderëve më të njohur të botës së atëhershme u dërgoi mesazhe, të cilat do ta informonin opinionin e gjerë se në botë është një i dërguar i Krijuesit të botëve, i cili i fton të gjithë në pranimin e Islamit si fenë e zgjedhur prej Atij. Nga arkivat e botës mësojmë se Muhammedi s.a.v.s. u ka dërguar mesazhe të gjithë atyre që koha ia kishte mundësuar atij për t'ju dërguar. Fatmirësisht që, në gjuhën shqipe tani i kemi të përkthyera shumicën e atyre letrave. Por neve do të na mjaftonte të përkujtojmë letrat që ua dërgoi Kisrasë, perandorit të persëve dhe Herakliut, perandorit të popujve bizantin.

Derisa njeriu i lexon ato letra vëren se asnjë letër nuk i ngjason tjetrës, secila ka stilin vet që e bën të dallueshme nga tjetra. Nga letrat të cilat i shkroi Muhammedi s.a.v.s. mësojmë edhe gjendjen e atyre popujve. Mbretërit ose perandorët nëse ishin të mirë me popullin e tyre letra e Pejgamerit s.a.v.s. është letër udhëzuese dhe paqësore, ndërsa atyre që ishin arrogantë ua përkujtonte Fuqinë e Krijuesit. Letrat ishin shkruar në mënyrën më të mirë të mundshme, prej të cilave kuptohej qartë dhe mirë mesazhin Hyjnor. Nga dërgesat e tij mësojmë se çfarë burrë shteti ishte ai, atë nuk e frikonte askush përveç drejtësisë Hyjnore.

Ata të cilët e kuptonin thellësisht mesazhin e pranonin islamin si fe të tyre, ndërsa ata që mendonin se nuk ka forcë mbi forcën e tyre vazhdonin ta injoronin dhe t'ia kthejnë letrat por me ton kërcënues.

Kështu, prej mbretërve (imperatorëve) që nuk deshën u sollën mirë me dërgesën ishte edhe Perandori i persëve. Kjo është përmbajtja e letrës së Pejgamberit:

"Bismil-lahir Rahmanir Rahim! Nga Muhammedi, Pejgamber i Allahut, perandorit të Persisë, Kisras. Paqja qoftë mbi atë që është në rrugën e Allahut, që i beson Allahut, Pejgamberit të Tij dhe që dëshmon se nuk ka hyjni tjetër, përveç Allahut, Një të Vetmit, i cili nuk ka shok dhe se Muhammedi është rob dhe Pejgamber i Tij. Të thërras me Thirrjen e Allahut. Unë jam Pejgamber i Allahut, i dërguar për tërë njerëzimin për ta paralajmëruar atë që është i gjallë (i mençur) për t'u realizuar fjala (dënimi) ndaj jobesimtarëve. (Jasin: 70). Përqafoje fenë islame, do të shpëtosh! Nëse e refuzon këtë, atëherë të gjitha mëkatet e persianëve, do të bien mbi ty."

Kur këtij i ra letra në dorë me shumë nervozë e grisi atë e bëri copë-copë, dhe tha: "Robi i shëmtuar i nënshtetasve të mi, e vë emrin e vet para emrit tim". Kur e informuan për këtë, Resulullahun s.a.v.s. tha: "Allahu ia copëtoftë perandorinë e tij".

"Ashtu edhe ndodhi, siç tha Pejgamberi s.a.v.s., Kisra i shkroi një letër mëkëmbësit të Jemenit, Bazanit, në të cilën thotë: "Dërgoji tek ai njeri në Hixhaz dy njerëz, të aftë dhe të fuqishëm, e le të ma sjellin!" Bazani dërgoi dy njerëzit e vet, me anë të cilëve i dërgoi edhe një letër Resulullahut s.a.v.s., ku e urdhëronte të shkonte tek Kisra. Kur erdhën këta dy në Medinë dhe, kur u takuan me Resulullahun s.a.v.s, njëri prej tyre tha: "Shahin-shahi, mbreti i mbretërve, Kisra, i dërgoi një letër mbretit Bazan për të dërguar dikë që të të sjellë tek ai, andaj kemi ardhur që të vish me ne". Ai shqiptoi edhe disa kërcënime, kurse Resulullahu s.a.v.s. i urdhëroi që të vinin nesër.

Ndërkohë në oborrin mbretëror të Kisras shpërthyen trazirat, pasi ushtria persiane pësoi disfatë të rëndë prej ushtrisë së Cezarit.

Shirevahi, i biri i Kisras, u ngrit kundër babait të vet dhe e mbyti atë, e pastaj mori fronin e Persisë. Kjo ndodhi ditën e martë, më dhjetë xhumadel-uhra të vitit 7 h. Resulullahu e kuptoi për këtë lajm me anë të Vahjit - Shpalljes, andaj, të nesërmen, kur erdhën ata dy, Resulullahu s.a.v.s. u tregoi se ç'kishte ndodhur, kurse ata thanë: "A e di ti se ç'je duke folur? Ne për ty i thamë disa shpifje të lehta, e ti dëshiron të themi atë çka thua? Ti dëshiron që këtë t'ia përcjellim mbretit Bazan, apo jo?"

Resulullahu e tha: "Po, përcilljani të gjitha këto prej meje, përveç kësaj i thoni atij se feja ime dhe pushteti im do të arrijë gjer te kufijtë ku ka arritur pushteti i Kisras, dhe kjo do të zgjerohet gjer atje ku mund të shkelë këmba e njeriut. Dhe i thoni atij: nëse e pranon Islamin, do të mbetet ende në pushtet në mbretërinë e vet...

Këta dy u larguan prej Resulullahut edhe vajtën te Bazani, të cilit ia treguan të gjitha me radhë. Ndërkohë arriti lajmi nga Persia se Shirevahi kishte mbytur babain e vet. Në të njëjtën letër Shirevahi i shkruan Bazanit: "Kërkoje njeriun për të cilin të ka shkruar babai im, por mos e sulmo derisa të vijë urdhri im për të".

Ky rekomandim i Shirevahit ishte shkas që Bazani me të gjithë persianët e vet në Jemen të pranonin Islamin".

Mesazhi dërguar Herakliut perandorit bizantin

Buhariu personi më meritor i cili ka përrshkruar jetën e Pejgamberit s.a.v.s. nga të gjithë paraardhësit e tij, dhe të gjithë të tjerët deri më ditët tona të sotme na transmeton, edhe për letrën e Pejgamberit

s.a.v.s. dërguar perandorit të Bizantit, Herakleut, me këtë përmbajtje: “Bismil-lahir Rahmanir Rahim! Nga Muhammedi, robi dhe Pejgamberi i Allahut, Herakleut të madhit të Bizantit. Paqja qoftë mbi atë që e ndjek rrugën e Allahut. Pranoje fenë Islame do të shpëtosh. Pranoje Islamin, Allahu do të të jep shpërblim të dyfishtë. Nëse e refuzon atë, mbi ty do të bjerë mëkati i gjithë erisianëve".

“O ithtarë të Librit, ejani të bashkohemi rreth një fjale të përbashkët edhe për ne edhe për ju: të mos adhurojmë tjetër përveç Allahut, asnjë send të mos ia bëjmë shok Atij, që njëri-tjetrin mos ta konsiderojmë për zot në vend të Allahut! E nëse ata refuzojnë atëherë ju thoni: "Bëhuni dëshmitarë se ne njëmend jemi myslimanë."

Mendoj se letra është e qartë, Pejgamberi s.a.v.s. i është drejtuar një njeriut i cili sapo kishte dalë triumfues nga lufta e përgjakshmë me persët. Ai ishte i krishterë dhe kishte dituri të saktë për dërgesat Hyjnore. Kur këtij i erdhi mesazhi i Pejgamberit, u soll mirë me letërdërguesin. Nuk dihet saktë, por shkrimet arabe vende vende thonë se Herakliu iu bind letrës së Muhammedit s.a.v.s., sepse inspiruesi kryesor për hakmarrje ndaj persëve për paska qenë Kur'ani, i cili ka paralajmëruar fitoren e bizantinëve pas një kohe relativisht të shkurtër. Sipas rregullave njerëzore kur një superfuqi humbë luftën ajo nuk është në gjendje ta rimarë veten përpara një shekulli, por rasti bizantit bëri përjashtim. Kjo mrekulli u vërtetua sepse nëntë vjet më herë Kur’ani kishte paralajmëruar për fitoren e Bizantit ndaj Persisë. Mendohet se nxitësi kryesor për mobilim dhe fitore për Herakliun ishte sureja e Kur'anit-Bizanti.

Këtë sa më sipër thamë, e bën edhe më të besueshme fakti se përfundimi i Herakliut ishte i tmerrshëm. Ky perandor i madh disa vjet para se të vdiste kishte kaluar në çmenduri. Supozoj se ajo i ka ardhur nga presioni i vazhdueshëm që ia bënin priftërit dhe këshilltarët e tij, që ndaj islamit dhe myslimanëve t’ishte i ashpër.

Sido qoftë, myslimanët e ruajnë me shumë kujdes transmetimin e Buhariut i cili ka sjellur gjithashtu edhe dialogun e Herakliut me Ebu Sufjanin, kusheririn e Muhammedit s.a.v.s. Në kohën kur Herakliut i kishte arritur mesazhi Pejgamberit, Ebu Sufjani kishte shkuar me karvanin e tij në Sham (Damaskus). Herakliu e ka ftuar atë për t’ia bërë disa pyetje:

“Pyeti, ***cili është më i afërt për nga origjina me atë njeri që po pretendon se është Pejgamber***?" Ebu Sufjani u përgjigj: ***"Unë jam më i afërmi i tij***". Herakleu tha: "***Ma afroni atë, e shokëve të tij u thoni që të radhiten prapa tij.***" Pastaj Herakleu i tha përkthyesit: "***Këtë njeri këtu*** (Ebu Sufjanin) ***do ta pyes për atë njeri*** (Resulullahun s.a.v.s.), ***e nëse e fsheh të vërtetën, shokët e tij le të reagojnë.***" Ebu Sufjani tha: "***Për Zotin!, sikur të mos më vinte turp që prej meje të dëgjojnë gënjeshtra, unë do të gënjeja për të.***"

Ebu Sufjani rrëfen: "***Pyetja e parë që më shtroi ishte***:

"***Çfarë lidhjesh keni mes jush?***" Iu përgjigja: "***Më të afërt***".

- Herakleu: "***A ka folur ndonjëherë kush prej jush fjatlë të tilla para tij?***"
- Ebu Sufjani: "***Jo***".
- Herakleu: "***A ka qenë ndokush prej etërve të tij mbret?***"
- Ebu Sufjani: "***Jo***".
- Herakleu: "***A e përkrahin atë njerëzit me pozitë apo njerëzit e varfër?***"
- Ebu Sufjani: "***Njerëzit e varfër***".
- Herakleu: "***A është duke u shtuar numri i tyre apo duke u pakësuar***?"
- Ebu Sufjani: "***Duke u shtuar***".
- Herakleu: "***A e lëshon ndonjëri prej tyre fenë e tij nga urrejtja ndaj saj pasi ta ketë pranuar atë?***"
- Ebu Sufjani: "***Jo***".
- Herakleu: "***A ka qenë gënjeshtar para kësaj?***"
- Ebu Sufjani: "***Jo***".
- Herakleu: "***A e thyen fjalën e dhënë?***"
- Ebu Sufjani: "***Jo - por që prej kur nuk jemi bashkë nuk e kemi të ditur se ç’është duke bërë*** (dhe më nuk më ka lejuar që të them së paku një fjalë timen)".
- Herakleu: "***A keni luftuar kundër tij?***"
- Ebu Sufjani: "***Po***".
- Herakleu: "***Si ka qenë rezultati i luftës midis jush dhe tij***?"
- Ebu Sufjani: "***Ndërmerrnim luftëra mes nesh, luftëra garuese, herë fitonin ata, herë fitonim ne***".
- Herakleu: "***Çka është duke kërkuar prej jush?***"
- Ebu Sufjani: "***Është duke thënë adhuroni vetëm Zotin dhe përveç Tij mos i besoni zotave të tjerë, braktisni besimin e gjyshërve dhe të etërve tuaj, na urdhëron që t’i falemi*** (namaz) ***Zotit, të flasim të drejtën, të jemi të ndershëm, t’i mbajmë lidhjet farefisnore...***"

Pastaj Herakleu i tha përkthyesit: "**Përkthеja atij:**

Të pyeta për marrëdhëniet farefisnore me të, e ti më the se jeni më të afërt. Kështu janë Pejgamberët e Zotit, më së pari kanë ftuar farefisin dhe popullin e vet. Të pyeta nëse ka folur dikush prej jush fjalë të tilla, para tij, ti the jo. Sikur të kishte folur ndokush fjalë të tilla para tij, do të kisha menduar se ky njeri ishte duke i imituar të tjerët. Të pye-ta nëse ka qenë ndokush prej të parëve të tij mbret, ti më the jo. Sikur të kishte qenë dikush prej të parëve të tij mbret, kisha menduar se qenka njeri i cili kërkon sundimin - pushtetin e të parëve të tij. Të pyeta nëse jeni duke e akuzuar që ka gënjyer para se të thoshte këtë që është duke thënë, ti më the jo, e unë e di se ai nuk ka mundur të jetë i sinqertë ndaj njerëzve, e rrenacak ndaj Zotit. Të pyeta se a janë duke iu përgjigjur thirrjes së tij paria e popullit apo shtresa e ulët (masa e gjerë) e tij, ti më the se janë duke iu përgjigjur populli i thjeshtë dhe i pambrojtur, e zakonisht të tillët kanë qenë ithtarët e të gjithë Pejgamberëve. Të pyeta nëse janë duke u shtuar apo duke u pakësuar, e ti më the se numri i ithtarëve të Pejgamberit është duke u rritur. Kjo është zakonisht me besimin derisa shpallja të plotësohet tërësisht. Të pyeta nëse e ka braktisur ndonjëri prej tyre fenë nga urrej-tja ndaj saj, pasi e ka pranuar atë, ti më the se jo, kështu ndodh kur njerëzit e pranojnë besimin me gjithë zemër. Të pyeta nëse është besëthyes apo tradhtar, ti më the se jo, ndërsa Pejgamberët nuk e tradhtojnë besimin e vet. Pastaj të pyeta se çka ju urdhëron të besoni, e ti më the se ju urdhëron të besoni Allahun dhe përveç Tij të mos i besoni hyjnitë - zotat e tjerë, që do të thotë se ju ndalon t’i adhuroni idhujt. Pastaj ju urdhëron të kryeni namazin, të jepni sadaka, të jeni të ndershëm, e nëse është kështu siç thua ti, atëherë ai së shpejti do të sundojë me këto vise ku tani gjendem unë. E kam ditur se ai do të dërgohet, por nuk e kam ditur se do të jetë prej jush (Arab). Sikur ta dija se do të mundja të arrija tek ai, do të kisha bërë ç’mos për t’u takuar me të. E, sikur të isha pranë tij, do t’i kisha larë edhe këmbët.

Pastaj urdhëroi që t’ia lexonin mesazhin e Resulullahut e. Kur përfundoi leximi i mesazhit, u ngrit zëri i atyre që ishin përreth tij dhe na urdhëruan që të dilnin përjashta. Dola prej tij duke u thënë atyre që na përcillnin: "E përkrahu djalin e Ebu Kebshit (emri përbuzësh i të parëve të Resulullahut e). Ka frikë prej tij për pushtetin e vet." Atëherë isha fuqimisht i bindur në suksesin e Resulullahut e, andaj e kam ndjerë se edhe mua Allahu do të ma përshkojë zemrën me Islam." ■

ISLAMI, NJË TRADITË PROGRESISTE

Kur një luftëtar i rezistencës uellsiane, i zënë rob u soll përpara perandorit në Romë tha: "wDëshira jote për të pushtuar botën nuk do të thotë medoemos se bota dëshiron të pushtohet nga ty." Sot, po këto fjalë, mund t'ua ofrojmë liberalëve perëndimorë: Dëshira juaj që vlerat tuaja të sundojnë kudo në botë, nuk do të thotë medoemos se bota dëshiron t'i përvetësojë ato. Zëri kolonizator bazohet në injorancën lidhur me traditat e pasura të qytetërimeve të tjera dhe në një optimizëm krejt të pavend mbi atë që perëndimi është duke bërë me botën politikisht, ekonomikisht dhe ambientalisht.

Besimet e rrënjosura që shumë perëndimorë i shfaqin haptazi lidhur me Islamin, shpesh nxjerrin në pah më shumë lidhur me perëndimin sesa lidhur me Islamin dhe myslimanët. Otomanët ishin dinastia që ka zgjatur më shumë në histori; kohëzgjatja e tyre diç duhet të ketë pasur të bëjë me aftësinë e tyre për të sunduar një perandori shumë-fetarëshe, në të njëjtën kohë, teksa Evropa ndante, përcaktonte e përkufizonte llojet e besimtarëve të krishterë.

Sot thuhet se Islami është më pak, jo më shumë tolerant se perëndimi, dhe neve na duhet të pyesim se cilat më saktësisht janë vlerat "perëndimore" me të cilat Islami është kaq i papajtueshëm? Disa besojnë se qëndrimi i Islamit ndaj gruas është burimi i problemit të myslimanëve. Perëndimorët duhet t'i kthejnë sytë nga vetë qëndrimet e tyre lidhur me këtë e të pranojnë që në perëndim, vetëm tani vonë, strukturat patriarkale kanë filluar të shpërbëhen. Tradita islame vërtet që shfaq disa zona ku ka një papajtueshmëri të dukshme lidhur me përcaktimin e qëllimit të gruas ashtu si në perëndim, dhe myslimanët kanë përpara tyre një rrugë të gjatë për të bërë lidhur me qëndrimet e tyre ndaj gruas. Por, padija e fesë – edhe një herë – është të shfaqësh injorancën tënde, si lidhur me fenë, ashtu edhe me përpjekjet historike për barazi të grave në shoqërinë myslimane.

Një lexim i kujdesshëm i teologëve myslimane do të bënte që gruaja perëndimore të mbetej e mahnitur nga rregullimet ligjore të nënshkruara përpara mese 1000 vjetësh, për shembull, që u jepnin grave të drejtë ligjore për të qenë të ndihmuara në punët e shtëpisë nga burrat. Tre nga katër shkollat juridike, punët e shtëpisë i konsiderojnë jashtë përfshirjes së përgjegjësive ligjore të gruas kundrejt burrit të saj. Krahasojeni këtë me sondazhet amerikane që tregojnë se gratë që kanë një punë edhe jashtë shtëpisë ende vazhdojnë të kryejnë 80% të punëve shtëpiake. Perëndimorët, në apelin e tyre për konformizëm global, shpesh flasin për "progres" dhe për refuzimin e të kaluarës feudale jo shumë të largët, ndërsa janë më pak të pirur për të nxjerrë në shesh sikletin e tyre mbi hegjemoninë e korporatave dhe implikimet e vërteta njerëzore lidhur me globalizmin.

Ndërsa misionarët e vlerave perëndimore aq që përpiqen për të gjykuar pse Evropa, zemra e perëndimit, të ketë gjeneruar dy luftëra botërore në të cilën janë vrarë më shumë civilë se në të gjitha luftërat e mëparshme përgjatë tërë 20 shekujve. Ashtu siç e theksojnë myslimanët, ne na kërkohet që t'i quajmë "luftëra botërore", edhe pse ato realisht janë luftëra perëndimore, që shënjestronin civilë me armë të shkatërrimit në masë në një kohë kur vendet myslimane kanë kaluar tërësisht në paqe mes tyre. Ne myslimanëve nuk na bëjnë përshtypje pretendimet triumfaliste në llogari të perëndimit, por jemi të kënaqur me vlerat në themel të atij qytetërimi. Si një perëndimor, fëmijë i një aktivisti kundër luftës dhe propagandues i të drejtave qytetare, përqafimin e Islamit nuk e përjetova si një braktisje të vlerave të mia, të përftuara pothuajse tërësisht nga tradita progresiste, por si një afirmim të tyre. Që atëherë, kam studiuar ligjin islam për 10 vjet me radhë me dijetarë tradicionalistë, dhe ndërkohë që disa veçanti në disa tekste mesjetare më kanë shqetësuar, asnjëherë të përgjithshmet nuk kanë rënë në kundërshti me asgjë prej atyre që nëna ime progresiste nga Kalifornia më ka mësuar. Përkundrazi, jam mrekulluar se si pjesa më e madhe e shoqërisë perëndimore, ato që i pretendon si idealet më të larta të saj, janë të rrënjosura thellë në traditën islame.

Shovinizmi i shfaqur mes ca perëndimorëve në mënyrë tipike shkaktohet nga ekstremizmi islamik. Të pakët janë ata që përpiqen për të dalluar se Islami i rrymës kryesore, po aq sa edhe perëndimi, nuk e aprovon aspak ekstremizmin. Ajo që unë kam frikë, është se mund të jetë gjetur ndonjë justifikim, duke i pajisur këta perëndimorë me një zëvendësues për shprehinë e tyre më të hershme të antisemitizmit. Transformimi nuk ka pse të jetë kaq i vështirë. Arabët, në fund të fundit, janë semitë, dhe mësimet e profetit arab janë më afër Judaizmit në teologji dhe në legjislaturë sesa Krishterimit. Ne myslimanët në perëndim, ashtu si hebrenjtë para nesh, ndeshemi me të njëjtat probleme që kanë ndeshur hebrenjtë në të kaluarën: integrim apo izolim, traditë apo reformë duke kontribuar në shoqëri, apo duke u skematizuar nëpër geto dhe duke qenë mizorisht mospërfillës ndaj higjienës personale.

Filmat vizatimorë me arabë nuk kanë shumë ndryshim nga karikaturat me çifutë në gazetat gjermane të periudhës naziste. Në vitet 1930, imazhe të tilla siguronin se vetëm pak njerëz do të kishin kurajën për të folur mbi pasojat e mundshme të demonizimeve të tilla, tamam si sot, kur vetëm pak njerëz shqetësohen realisht përballë retorikës anti-myslimane të partive të së djathtës ekstreme në mbarë Evropën. Myslimanët në përgjithësi dhe arabët në veçanti janë bërë "tjetra" e re. Vitin e shkuar, kur takova presidentin Bush, i dhashë dy libra. Njëri ishte Kurani, përkthyer nga Tomas Kleari. I dyti ishte një tjetër përkthim po nga Kleari, "Rrufe në qiell: sekrete të marrjes dhe të përdorimit të pushtetit". Ky libër, shkruar nga një i urtë kinez, pasqyron vlera universale popujsh të tjerë.

E bëra këtë sepse, si një amerikan, i rritur në më të mirën e traditave perëndimore, dhe si një i kthyer në mysliman që gjen shumë kuptim e thellësi në filozofinë kineze, unë besoj që teza e Hantingtonit se këto tre qytetërime të mëdha, medoemos duhet të përplasen mes tyre, është një gënjeshtër. Çdo qytetërim flet nëpërmjet shumë zërave; më të mirët në secilin prej tyre kanë shumë të përbashkëta. Jo vetëm që qytetërimet tona mund të bashkëjetojnë në pjesët përkatëse të globit, por mund të bashkëjetojnë edhe në zemrën e një njeriu, si kjo e imja. Ne mund ta pasurojmë njëri-tjetrin nëse zgjedhim të përqafojmë thelbin e njerëzores brenda nesh; mund ta shkatërrojmë të tërë botën nëse zgjedhim të jepemi pas ndryshimeve. ■

Hamza Jusuf - SHBA

Vrasja e Benazir Bhutto-s i ka futur në lojë amerikanët dhe islamistët

Atentati që trazoi Lindjen e Mesme

Nëse nuk do të jetë në gjendje Amerika ta kontrollojë rajonin politikisht me anë të presidentit aktual Pervez Musharaf, ajo është e interesuar që armët bërthamore t'i ketë nën kontrollin e saj. Se sa do të ketë Musharafi përkrahjen e popullit mbetet të shihet në të ardhmen e afërt pasi të rishpallen zgjedhjet kombëtare.



Mehmet **SHKËMBI**

Për herë të parë në fund shekullin e XX-të, bëhet lider politik (femra e hekurt) Benazir Bhutto, e bija e ish presidentit të Pakistanit Zulfikar Ali Bhutto. Kjo trashëgoi postin e babait të saj, si presidente e Partisë Popullore Pakistaneze e cila mbështetje kryesore e kishte krahinën Sind, për t'u bërë kryeministre e Pakistanit në vitin 1988.

Zulfikari Ali Bhutto me t'u pavarësuar Pakistani në vitin 1949-të, themeloi Partinë Popullore në Sind, njëra prej katër krahinave sa ka Pakistani. Këto krahina themelojnë federatën, ndërsa për kryeqendër kanë Islamabadin. Penxhapi, është krahina më e madhe në numër dhe njihet si rivalja kryesore e Sind-it familjes Bhutto. Lideri i kësaj krahine tani është ish kryeministri Nazar Sherif i cili është forca kryesore në vend.

Që kur është njohur sistemi pluralist, fatkeqësisht asnjë lider nuk është pensionuar. Të gjithë janë likuiduar me atentate, ekzekutime ose në forma të ndryshme janë vrarë. Këtë fat e kishte edhe babai i Benazir Bhuttos, Zulfikari i cili u ekzekutua me varje. Ai si president i vendit kishte udhëhequr politikën e ndarjes midis Pakistanit perëndimor dhe atij lindor, gjegjësisht Bangladeshin. Kjo politikë e keqe e tij bëri që Gjykata Supreme të merr vendimin fatal për liderin e Sind-it.

Familja Bhutto vlerësoi se vendin e ish presidentit të ndjerë duhet ta zë e bija e tij Benazir Bhutto, e cila ishte shkolluar në shtetet perëndimore. Si femër, dhe si një oratore e zonja ajo arriti që për një kohë të shkurtër ta përfitojë masën e cila ishte dëshpëruar nga babai i saj. Ajo arrin që në vitin 1988 të bëhet kryeministre e vendit. Në vitin 1990 rrëzohet nga ky post, për t'u rizgjedhur sërish në vitin 1993 deri më 1998. Këtë vit ajo detyrohet të ik nga vendi për shkak të aferave të mëdha që ia shkaktoi bashkëshorti i saj. Ajo largohet në Emiratat e Bashkuara Arabe dhe herë pas here punonte si mësimdhënëse në disa prej universiteteve të Londrës.

Benazir Bhutto kthehet në vend, vetëm atëherë kur kryeushtaraku dhe presidenti i vendit Musharaf kishte amnistuar atë dhe rivalin e saj Nazar Sherif i cili gjithashtu ishte në arrati.



Vendimi fatal!

Vendimi për kthimin e këtyre dy liderëve rival ishte marrë nga presidenti aktual i cili ishte shkaktar i pasigurisë në vend. Ky vendim qe fatal për familjen Bhutto, Pakistanin dhe tërë rajonin. Që në ditët e para të kthimit të Benazir Bhuttos në Pakistan, ajo u prit me atentate. Ajo u shpëtoi disa atentateve për një kohë të shkurtër, por që shkaktoi mbi 760 viktima të pafajshme dhe shumë vetura, lokale dhe institucione shtetërore të shkatërrohen. Lideren e Sind-it nuk e trembnin atentatet, ajo do të vazhdonte të dilte para turmës dhe përkrahësve të saj sepse populli i Sind-it atë e shikonte si të vetmen alternativë për shpëtimin e vendit.

Pakistani në këto trazira hyri në fushatë elektorale. Fillimisht presidenti Pervez Musharaf kishte gjasat reale të rizgjedhej në këtë post përderisa kishte përkrahjen e Benazir Bhuttos. Pas disa ditë fushate ajo kërkoi nga ai të jepte dorëheqjen e tij të parevokueshme. Në mitingun e saj të radhës në qytetin Ravapindi të krahinës rivale në Penxhap më 27.12.2007 kundër saj bëhet sërish atentat. Fatkeqësisht ky atentat ia mori edhe jetën.

Qeveria pa kurrfarë argumentesh akuzoi Partinë Islame të Nazar Sherifit, e mbështetur në vendin e atentatit si zonë tradicionale e kësaj Partie. Vërtetë Nazar Sherifi ishte rivali saj kryesor, por ai akuzohet pa argumente. Pse duhej ta bënte ai kur mendohej se do t'i fitonte zgjedhjet e vitit 2008.

Një ditë më vonë nga qeveria akuzohet Al Kaida. Po në këtë ditë qeveria del me një deklaratë e cila informon popullin pakistanez pasi ishte bërë "ekspertiza" e vrasjes së Benazirit. Në të thuhej se ajo nuk kishte vdekur nga



plumbat, por nga goditja në kokë kur ajo ishte munduar ta fuste kokën në brendi të automjetit në momentin kur u bë atentati. Vdekja e saj doli si fatkeqësi e rastit!? Por bashkëshorti i saj menjëherë të nesërmen e përgënjeshtroi versionin qeveritar të atentatit, duke thënë se ajo ishte goditur me plumb prapa në kokë. Nga kjo deklaratë e tij del se ai që organizoi atentatin ishte vetë presidenti Pakistanit Pervez Musharaf.

Populli nuk të fal...

Benazir Bhutto gjeti përkrahje në një pjesë të madhe të popullit, por ajo nuk kishte politikë të qartë kombëtare. Lëvizjet e saj gjatë fushatës po linin shenja pakënaqësie në popull. Ajo sikur po ndihmonte në hije politikën amerikane në rajon. Ishin përhapur thashetheme se ajo kishte ndërmend ta ndante Krahinën e Sind-it nga Pakistani mu ashtu siç kishte vepruar i ati i saj me Bangladeshin.

Populli nuk të falë. Ata nuk janë në gjendje t'i kuptojnë politikat e mëdha, por nuhatjen e kanë të saktë. Kështu kishte ndodhur edhe me Esat Toptanin tek shqiptarët. Në esencë myslimanët për këso sjelljesh nuk vrasin njeri e aq më tepër një femër, por ajo që më së shumti kishte mundur të ndodhte do të ishte largimi saj përfundimtar nga politika. Këto opinione dhe raste më së shumti i shfrytëzojnë grupet e interesit të cilët marrin vendime të shëmtuara dhe fatale për vendet dhe rajonet.

Aktorët në rajonin e trazuar

Nuk do të merrem me spekulime se kush ka mundur të bënte atentatin, por do të merrem me aktorët që vazhdojnë të janë në lojë.

Lindja e mesme është përfshirë në një rajon krize që kur u shemb muri Berlinit. Derisa ishte aktuale politika e Luftës së Ftohtë, Lindja e Mesme nuk shkaktonte rrezik global. Kur ndodhte të përmendej ky rajon në lajmet e përditshme, jepte shenja të një rajoni me konflikte lokale, sikur lufta palestinezo-izraelite, pakistanezo-indiane, lufta irako-iraniane etj.

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë, politikanët që zhvillojnë politika të mëdha konkluduan se Islami rrezikon botën. Ndërsa shteti më i rrezikuar nga këta është Izraeli, i cili kufizohet me këto shtete të "rrezikshme". Në fillim të këtij mileniumi doli në skenë Lufta kundër terrorizmit. Luftë së cilës nuk po i shihet fundi. Nga një luftë lokale që thuhej në fund të mileniumit të dytë. Në këtë milenium doli se na qenka një luftë globale. Këtu kemi të bëjmë me civilizimin islam dhe atij perëndimor në mes të tyre si "viktimë" është Izraeli.

Në këtë rajon përveç Izraelit armë bërthamore ka Pakistani dhe, ashtu siç thuhet në media, këtë armë mund ta ketë edhe Irani për një kohë relativisht të shkurtër. Për të siguruar shtetin çifut, Amerika po përdorë të gjitha mjetet e mundshme, dhe si e tillë sipas mendimit tim vetes po i shkakton dëme që do të janë të pa riparueshme për të ardhmen e saj.

Atentati ndaj Benazir Bhuttos në të vërtetë i ka futur në lojë amerikanët dhe islamistët. Të parët janë shumë të interesuar që shteti Pakistanez të jetë në duar të sigurta sepse në të kundërtën rajoni do të rrezikohej sikur të vinin forca antiamerikane.

Nëse nuk do të jetë në gjendje Amerika ta kontrollojë rajonin politikisht me anë të presidentit aktual Pervez Musharaf, ajo është e interesuar që armët bërthamore t'i ketë nën kontrollin e saj. Se sa do të ketë Musharafi përkrahjen e popullit mbetet të shihet në të ardhmen e afërt pasi të rishpallen zgjedhjet kombëtare. ■

Islami në esencë nuk është kundër femrës të merret me politikë. Ajo nuk mëkaton sikur të merrej edhe me ndonjë post tjetër udhëheqës në shoqëri. Që në kohët e hershme të islamit, menjëherë pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s. gruaja e tij Aishe r.a. e bija e Ebu Bekrit, kishte marrë pjesë si udhëheqëse e ushtrisë myslimane. Pas Aishes r.a. kishte edhe shumë femra të tjera, sikur Shexheretul Dur e të tjera femra. Thënë realisht, raste të tilla në botën islame ka pasur shumë rrallë, por ato nuk janë injoruar e as nuk janë urryer për shkak të postit të tyre udhëheqës. Si duket të praktikuarit e saktë të islamit ka qenë e pamundur në kohërat e mëhershme, si rezultat i mentalitetit dhe opinioni të gjerë. Kjo dukuri ka qenë e rrallë jo për faj të mos njohjes së Islamit, por për shkak të implementimit në praktikë. Femra nuk mund të perceptohej në vende udhëheqëse në të gjithë popujt e atëhershëme, ndonëse Kur'ani askund nuk i ka dhënë prioritet gjinisë mashkullore. Femra sipas tij është e barabartë me mashkullin.
Sidoqoftë, këto dy shekujt e fundit bota Islame nuk kishte dëgjuar se një grua të ketë udhëhequr një post të lartë politik.

Interpretime të teksteve

Drithërimat lirike të dashurisë ndaj urrejtjes

Vështrim për veprat poetike "Madhështi mitike", "Anadrini" dhe "Mesudha" të Lumnije Thaçit-Halilit

Nijazi RAMADANI

Në përmbledhjen e parë "Madhështi mitike" me 41 poezi të cikleve: Kohë e çmendur, Sfidë territ, Engjëjt rojtarë, Djepi i ngadhënjimit, Itaka ime dhe Prehje e përjetshme, por edhe në përmbledhjen e dytë me titull "Anadrini" që mbërthen sërish 41 poezi të tufëzuara në 6 cikle të autores Ana Drini e cila ruajti me xhelozi motivet dhe temat e një subjekti lirik nga Anadrini, qoftë në përmbledhjen "Mesudha" të autores Lumnije Thaçi-Halili, kemi hetuar se pas përjetimit e rileximit merrnim mbi supe dhe bartnim në shpirt edhe barrën, që para lexuesve ta shpalosim malin e mbresave e të perceptimeve që nxit me një vërshim me tërë fuqinë mitike prej lashtësisë antike e deri në mitiken dhe të pathyeshmen e ditëve tona, kur Kosovës ende i rrinte njeriu prapa grilave.

Autorja Thaçi- Halili shtrihet në madhështi mitike prej traditës deri në modernitetin e mesudhës duke kalëruar nëpër Iliri e Anadrini, në mënyrë që gjatë këtij fluturimi mbi pegazin e imagjinuar, të na i nxjerr nga një det i shqetësuar këto tri perla të një tufe që u ngjan flokëve të mëndafshtë të zanave të Fishtës e të Mjedës, e që lexuesi e ka vështirë për t'i kapur në një kodhele e për t'i bërë gërsheta. Kështu, më shumë për botën poetike, për integritetin lirik dhe për autonominë e drithërimave subjektive të intimes poetike të kësaj poeteshe që me mjaft modesti na i dhuroi me shpresë se janë nektarë lulesh të cilave duhet marrë erë e duhet shijuar, na mbetet të kënaqemi me tërë botën motivore brenda qarqeve tematike që zhvillon kjo krijuese e që arriti të bëjë emër në plejadën e krijuesve të poezisë së sotme shqipe në përgjithësi dhe të krijueseve të gjinisë më të bukur në veçanti, plejadë të tëra sot i ndjek edhe shumë premtuese Lumnije Thaçi-Halili.

Në anën tjetër poezia lirike që mëton ajo është e vjetër sa edhe vetë njerëzimi, sa edhe ndarja natyrore e punës, e lindur pikërisht atëherë kur sajohet distanca e cila reflektoi mallin reciprok, e megjithatë lashtësi, përherë del e freskët e del vitale sepse përthith nektarët e epokave, të periudhave, të shekujve, dekadave e të viteve qofshin të mbarë apo të mbrapshtë dhe kështu përherë lirika del moderne ashtu siç del edhe te libri me poezi e që mban titullin "Mesudha" me dyzetë vjersha lirike. Padyshim se këtu ka diçka më tepër se vjershërim, edhe jehojnë klithmat e thirravajet e "Zanave Alpike" të ushqyera e të rritura me qumështin e fjalës së ndrydhur, fjalë kjo e cila me decenie kërkonte për t'u zgjuar prej gjumit edhe në "kohën kur më ishte ndalue", kohë mekuliane e vendosur atëherë kur "plisi ishte i shkelur me shekuj". Vjershat e Lumnije Thaçit-Halilit zbërthejnë dhe mbërthejnë tonet dhe drithërimat lirike të dashurisë ndaj urrejtjes, të guximit ndaj frikës, të fitores ndaj disfatës, të butësisë ndaj vrazhdësisë, të stoicizmit ndaj trishtimit, të altruizmit ndaj egoizmit, të humanizmit ndaj kanibalizmit, të pritjes ndaj fatalizmit, të polifonisë ndaj monotonisë, të rapsodisë ndaj elegjisë, të dritës ndaj territ e të jetës ndaj vdekjes, ndërsa këtyre mund t'u përballojë vetëm një shpirt i kredhur në meditime për perspektivën më të ndritshme të frymës së plejadës e femrave krijuese, mbesave të Elenë Gjikës, bijave të Elenë Kadaresë e motrave të Florë Brovinës, të Adelinë Mamaqit, të Valentinë Dafos, të Edi Shukriut e të Musine Kokollarit e plotëson edhe Lumije Thaçi – Halili me këtë trilogji në dorë e me fjalën shqipe në gji, patë konstatuar me të drejtë prof. dr. Sabahajdin Cena me rastin e promovimit të tri veprave të znj. Halili.



Prandaj edhe mund të thuhet se në rrafshin tematik, motivor, komponues e struktural, krijuesja Lumnije Thaçi është gjetur mirë në udhëkryqin ndërmjet traditës dhe modernitetit. Edhe në përmbledhjen e tretë, "Mesudha", hetohet se kjo krijuese e ka të qartë se është në sprovë para sfidës kah avangarda e strukturimit të fjalës poetike dhe të formësimit të mesazhit për pasardhësit, por edhe për dëshmitarët e këtyre kohërave katile imazhet e të cilave i sendërton me kujdes dhe seriozitet krijues.

Me këto përmbledhje, veçanërisht kur jemi para kërkesave për shijimin e vjershës lirike, krijohet një përshtypje se në rrafshin poetik, por edhe semantik, Lumnije Thaçi operon mirë dhe bukur në të gjitha kaptazhet gjatë dhënies të formës për imazhin e vjershës moderne lirike në harmoni me kohën dhe vendin, ku në radhë të parë vendosen katrahurat e përjetuara që njeriu normal nuk mund t'i shkulë as nga zemra e lënduar e as nga kujtesa e ndrydhur, sepse të gjitha katrahurat e ndjekin si hije. Këto krijime s'ka se si të mos dalin akuza kundër kanibalëve, korbave të mortës, valleve të vdekjes, ofshamave, dhembjeve, pikëllimeve, çmendurive, ngatërrimeve, etheve, gëlltitjeve dhe përgjakjeve që stimulojnë imazhet e tmerrit, të frikës e të trishtimit përballë optimizmit që shtrihet deri në përjetësi. Mesazh i poezive të saj mbetet në qarkun motivor e tematik të klirensit poetik në klimaks e antiklimaks si jetë e vdekje, përjetësi e ringjallje. Si mesazhe të këtilla lexuesit do t'i mbeten vjershat "Kohë e çmendur", "Zgjim nga hipnoza", "Sfidë territ", "Magjia e fjalës", "Testament për epitaf"dhe "Kangjelë e vrarë" nga tufëza "Madhështi mitike", vjershat si: "Atdheu", "Anadrinia", "Muranë e gjallë", "Tharmëtim lirik", "Me Lumën" e "Fjala" të tufëzës "Anadrini" dhe krijimet si: "Luzioni i kohës", "Tejjetësia", "Miti i Përjetësisë", e "Larjelotësh" të tufëzës së fundit "Mesudha" nëpër të cilën parakalojnë pritjet, zhgënjimet, kutitë e Pandorës, punët e Sizifit", pikëllimet e Orfeut, ringjalljet e atyre që nuk janë më në mesin tonë; feniksët, apollonët, artemidat, ifigjeniat në Aulidë, në Tauridë e në Kosovë, vashave duke mbrojtur nderin dhe orët e liga. Gjatë leximit të përmbledhjeve poetike "Madhështi mitike", "Anadrini" dhe "Mesudha", Lumije Thaçi-Halilit, të botuar më 2005, 2006 dhe 2007 nga SHB "Ura", Prishtinë, shihet qartë se me këto tri vepra kjo krijuese ia bë vetes vendin në rendin e krijuesve të nderuara të letrave shqipe, duke krijuar individualitetin e saj krijues e intelektual përballë sfidave që përjetojnë krijuesit e ditëve tona. ■

Studim letrar

DISKURS PËR TOKËN E BRAKTISUR (2)

Dhembja sa vjen e rritet, që në strukturën e tekstit poetik mbetet si përhershmëri për një vajtim dhe trishtim. Mirëpo tek autori trishtimi bëhet kërkim, sepse është bërë qetësi, strehë, ëndërrim, shpresë. Kjo është figurshmëria e diskursit, ku tani trishtimi është bërë çdo gjë në jetën e tij personale.



Flamur MALOKU

Bilal Xhaferri në poezitë e tij dhembjen dhe humbjen e tokës - Çamërisë, e përshkruan dhe koncepton në situatë të përjetimit, çka edhe bëhet pozicionim përballë një bote të tërë emocionale. Kështu, zbulimi i një bote të vuajtur shpirtërore, e shprehur esencialisht në figurë si zbulim dhe si plotësim në jetën dhe në botën e rëndë personale, e dyfishon edhe më shumë dramatiken shpirtërore. Dihet se te Bilal Xhaferri dramatika është e dyfishuar në jetën e tij personale, dyfishimi i kësaj dramatike në rrafshin personal bëhet zi shpirtërore. Tërë kjo vjen nga largimi i tokës së shtrenjtë çame, dramatikë kjo që vazhdon edhe më vonë, ku në vitin 1969 largohet fshehurazi edhe prej Shqipërie, se rrezikohej për t'u burgosur nga sistemi komunist i asaj kohe. Jeta e ligë dhe fati i rëndë e ndjek në çdo hap të jetës, i cili fat padyshim reflektohet edhe në krijimtarinë tij poetike. Tani poeti ka arsyeje të shprehë dhe të shënjojë jetën e mjerë personale dhe jo rastësisht shkruhet teksti "Eja trishtim", që është njëra ndër poezitë më të prekshme dhe më të realizuar në kuptimin e shprehjes dhe theksimit të gjendjes personale. Është poezi që të futë në jetën e tij personale dhe që shpreh një botë të vuajtjes. Nuk kërkohet trishtimi si kotësi; tani trishtimi ka kaluar në jetë dhe është bërë mbështjellës i trupit dhe shpirtit në dramatiken e dyfishuar jetësore;

Eja, trishtim
eja me hapa fletësh që bien nga degët
eja me hapa shiu që këputet nga fletët...
Eja, trishtim,
Eja me hapa tingujsh që dridhen në mbrëmje
eja me hapa zemrash që rrahin me dhimbje...
Eja trishtim.

Njeriu i vetmuar dhe i braktisur në jetë nuk ka më gëzim, atë e shoqëron vetëm trishtimi dhe vuajtja e tmerrshme, e cila bëhet ego dhe alter-ego subjektive në jetën e mërzitur. Emocioni nis dhe prek situatën në thurjen e gjakimit, që shtrihet përbrenda tekstit. Nata sjell trishtimin, që tani përkufizohet nëpërmjet shtresimit të përhershëm shpirtëror. Dhembja sa vjen e rritet, që në strukturën e tekstit poetik mbetet si përhershmëri për një vajtim dhe trishtim. Mirëpo tek autori trishtimi bëhet kërkim, sepse është bërë qetësi, strehë, ëndërrim, shpresë. Kjo është figurshmëria e diskursit, ku tani trishtimi është bërë çdo gjë në jetën e tij personale, apo siç thotë Agim Vinca "Në vend se elegji, ai i thur ditiramb trishtimit; e glorifikon atë". Pra, trishtimi nuk zvogëlohet në idenë autoriale, ai tani bëhet kushtëzim dhe përkufizim për një jetë personale, duke dalë si gjakim për vetë jetën e tij, madje edhe duke u identifikuar më të;

o prehër i ëmbël që nuk më braktise kurrë,
o strehë e qetësisë sime,
o ëndërrime të mia,
o gji i shpresës sime
Eja, trishtim,
trishtim,
eja

Figura e trishtimit, si identifikim vjen para së gjithash nga modeli dhe paramodeli jetësor, kodo që ta kapësh dramatika është e dyfishuar, prandaj trishtimi bëhet kod i kërkimit personal. Mirëpo dramatika vazhdon, subjekti nuk largohet nga ky shqetësim dhe nga kjo gjendje as në poezinë, "Vallë ku më çon kjo rrugë e largët". Tani te kjo poezi shënjohet dhe artikulohet largimi i dytë i përjetuar në kohë, që për subjektin ky largim është shumë i përflakur. Përmbysja shpirtërore theksohet në personalen, njëherësh duke u përgjithësuar në strukturën e tekstit figurativ siç janë: mjegulla, qefini shtatori, errësira, gjem-



bat, të cilat figura e përbëjnë normën e zakonshme të paraqitjes së gjendjes së arratisurit.


E para mjegull e shtatorit
Porsi qefini të mbulojë
Sa shpejt nga sytë atdhe më humbe
Sa shpejt errësira të gallbërojë.

Plaga për atdheun rritet në dramën e rrëfimit, në tragjedinë e vdekjes. Tragjedia e atdheut shtresohet si identifikim ndërmjet personales dhe fatit të atdheut. Atdheun tani e ka mbuluar errësira e vdekjes. Dhe sipas kësaj, figura e mjegullës i përshtatet idesë së përshkrimit. Largimi nga atdheu bëhet hapje e plagës, plagë kjo e dëshmuar në figurë, si konceptim dhe artikulim. Vetë përshkrimi i bërë shënjon atdheun e humbur, zjarrmia shpirtërore është e madhe, shqiptuese dhe dëshmuese

Ashtu të lash i shtrenjti vend
dhe rrugën mora për këtej
Ku vallë më çon kjo rrugë e largët?
Kur vallë sërish tek ti do të kthej?

Ngjyrimet e theksuara personale, si diçka të paparë në kuptimin e vetëpërkufizimit të kësaj tragjedie shpirtërore, flasin qartë edhe në pyetjet e parashtruara nga subjekti ligjërues. Pyetja "kur vallë sërish tek ti do të kthej", brenda koncentrimit dhe dhembjes subjektive, shprehet si shpërthim i zhgënjimit, me një intensitet të madh emocional. Emocionaliteti së bashku me figurën në kuptimin gjithëpërfshirës, sjellin një brendi, një individualitet të mbushur me dhembje dhe me përjetim. Përjetimi dhe humbja e rëndë, Bilal Xhaferrin e përcjell edhe në dashuri, një humbje e këtillë shënjohet edhe në poemën "Mjegulla". Poema hapet me fjalë të shkrimtarit të njohur Majakovskit "Dhe jeta kështu do të ikë një ditë si këto brigje të Avazit". Këto fjalë bëhen paratekst për në hyrje të poemës ndërmjet dhembjes dhe përjetimit të mallit. Jeta për subjektin ka qenë e rëndë dhe kotësi në kuptimin e realizimit. Kjo vjen nga shkaku i sprovave jetësore, që kanë ardhur si rezultat i jashtësisë. Jashtësia është bërë përmbysje, shkatërrim shpirtëror, pa e kuptuar as vetë subjekti. Jeta ka krijuar largësi personale dhe mosrealizim të shumë gjerave jetësore, që tani janë të njohura në diskursin e poezive. Tani çdo gjë është mall, prandaj figurat e artikuluara shënjojnë një trishtim, një mall në pozicionim kur kujtohet (ajo). Nuk është vështirë të dallohet ky mall, sepse figurat shtresojnë një gjë të tillë:

Muzgu i mbrëmjes
erë deti me shi
Ti më shfaqesh në mëndje
si atëherë:
Me dorën e ngritur gjerë tek tëmthat,
nën dritat e dobëta
pranë shinave të lagur.



Figurshmëria e shënjuar me ngjyrime emocionale përbrenda shtresës tekstore, krijojnë një sintezë të tërë asaj që subjekti shpreh në mallin dhe në gjakimin për të. Këtu sjellët afshi i brendisë e thelluar në përjetim, këtu para së gjithash zbulohet jeta e larguar personale, që për Bilallin është si të thuash mall dhe dramatikë në vete. Thurja e figurës së shinave (binarëve), në idenë e subjektit perceptohet në rrugën e pambarimit në raport me jetën. Çdo gjë i përshtatet tekstit në mënyrën e realizimit dhe në shprehjen e saj. Të gjitha figurat në konceptimin ideor, përfaqësohen nga uni i subjektit të përmallshëm në kohë dhe në jetë:

Treni rreh rrugën e largët
si krah të shtrirë në hapësirë
zgjaten binarët e shinave,
drejt në qyteti të panjohur
të mbuluar nga mozaikët e yjeve.

Brenda një konteksti jetësor realizohet ajo që bëhet e kërkueshme në kuptimin e shprehjes së një gjendje të vështirë, përballë dashurisë dhe dhembjes që subjekti ka për të. Natyra e përshkruar dhe e realizuara në tekst kalon në figurshmëri poetike, krejtësisht autoktone në fushë të realizimit, apo siç thotë kritiku A. Aliu "figurshmëria poetike është në lidhje, në nivel dhe në përputhje të plotë me zërin, me forcën e brendshme autoktone, me atë forcë që e mban përherë të hapur, aktive dhe aktuale lidhjet e poetit me përkatësinë e vet". Çdo figurë është zgjedhje në shprehjen e mallit, të cilat shënjojnë fat dhe fatalitet jetësor, krejtësisht të matura në kuptimin e idesë dhe në shtjellimin e asaj dashurie që tani ndihet mungesa e saj. Dashuria merr përmasat e një zjarrmie subjektive në shtresimin e mosrealizimit, si sprovë e rëndë personale. Kodi tematik vijëzon një sprovë të tillë edhe pse tekstit, sipas shënimeve i mungojnë disa vargje dhe strofa. Poema është shkruar disa ditë para së Bilall Xhaferri të arratisej nga Shqipëria. Mirëpo, mbi të gjitha shpallet tërë ajo që autori ka deshtë të theksojë në diskursin e tekstit. Varësisht mungesës së vargjeve, poema ruan anën artistike, si në konceptim dhe në artikulim të figurës dhe shprehjes subjektive- emocionale. Një anë të tillë artistike, në fushë të realizimit dhe në figurshmërinë e artikuluar tekstore, e ruajnë të gjitha poezitë e Bilall Xhaferrit. Poezia e tij është poezi e vuajtjes, trishtimit personal, e cila shprehet në figurshmërinë tekstit. ■

(Fragment i shkëputur nga pjesa e dytë)

Poezi

Kjo botë ka për të hyrë në shpirtin tim



Syhejl HAVOLLI

VETMIA

Sado që unë dhe muzika së bashku këndojmë,
Dashuria ëndërruese tash më fle në gji,
E dallgët e detit peshqit i trazojnë,
Lart fluturoj qiellit më prit se po vij.

Hedh hapa kah dielli për të gjetur një si ty,
Në zemrën e yjeve ti udhëton pa mua,
Ah sa larg më je – thellë të kam në sy,
Thirre këngën bashkë me përqafimet e tua.

Ato ditë të vjetra a të kujtohen në verë,
Ende dëgjoj melodi thellë në trupin tënd,
I mbytur e i lumtur me ty isha atëherë,
Sonte krejt i vetmuar mbeta pa askënd.

TRI LULET QË LOTOJNË

Mburojë janë duart që mbetën në gji,
Unë zog i vetmuar që lahem nëpër shi.

O Sy i thellë, o gjumë mashtrimi,
O dhembje e gjatë, o ëndërr amshimi;
Zgjohu ta këndojmë atë këngë përsëri

Tri lulet tona lotojnë veç natën,
Ah ëndrrat e mia, net të tilla patën.

Gjithmonë kur vjen Blerta përgjumshëm flas ngadalë,
Bri vatrës që mbet pak zjarr me një un të thatë.

Kur vjen Blerimi ëndrra përtërihet, nuk vdes,
Atë zjarr në shpirt je Ti që ma ndez.

Tash Bulza kërkon zemrën vetëm nëpër gur,
Shpirti im që endesh e nuk u çlodhe kurrë.

Pse, o Sy vetmia më ndahet në dy pjesë,
Njëra vdes në heshtje, tjetra më jep pak shpresë.

DO TË LAHEMI NË LOT

S’të shoh më ashtu siç të kam parë një herë,
zemra po më digjet askush nuk më vëren,
pse nuk më kthehet buzëqeshje e parë
nëpër ballin tim shkruhet poema e vrarë.

Më thuaj, më thuaj tashti një fjalë,
se takimi që na bashkoi atëherë qe i bukur,
eja pranë meje se lotët më janë tharë,
jetën ta jetojmë në dashuri të strukur.

S’të shoh dot se mbi tokë po bie shi,
O shpirti im, o dritë e syve behar plot,
e zbërtheva formulën e kthimit kah ti,
tash jemi bashkë do të lahemi në lot...

REFREN I PËRJETSHËM

Kjo botë do të ndryshohet dikur,
por ngjyra Jote në zemrën time kurrë.

Kur dielli lind atje ku si çdo mot,
mos kërko shpëtim në asnjë pikë lot.

Kur dielli perëndon atje ku lind,
mos kërko takim pashë të dy sytë.

Kjo botë ka për të hyrë në shpirtin tim,
unë feniksi Yt do të mbaj mbi krah
për ta parë gjithë botën nga lart.


Të lutem Zjarrta ime që kuvendon me heshtjen,
tri Lulet Tua gjithë jetën që i deshe,
formulën e amshimit ma thuaj ku e fshehe.

O sot, o nesër kam për të takuar Ty,
midis zemrës behar dhe shpirtit që pret aty,
megjithatë kjo botë do të ndryshohet dikur,
por ngjyra Jote në zemrën time kurrë.

Interpretime të poezive

REZERVA E DORIT!

Poezia e Lasgush Pogradecit "Kur të më jesh e zemëruar", "Ata u deshën", e Henri Hajnes, "Një vajzë" e Ismail Kadaresë kanë një zinxhir poetik figurativ të njëjtë: mallin. Te poezitë e tyre femra figuron mbretëreshë e poezisë



Berat DAKAJ

Malli për dashurinë*

Dashuria, malli për vashën, vetmia në skajin tjetër, e thurin dashurinë edhe për poezinë. Këtë e kemi të pranishme te poezi e Lasgushit "Kur të më jesh e zemëruar".

Ti m'u rrëfeve për së pari shkreptimtare në stoli,
Un' ëndërrova se në zemër po më valon një mall i ri.

Midis rrëfimit ëndërrues dhe krijimit real (kohës reale dhe hipotetike) niset të lidhet shpirti me poezinë ndaj një qenie që mungon, që shfaqet nganjëherë, ose që përfytyrohet si figurë kozmike (ylli – vasha), por që ikën me mëngjes, ndërpritet ëndrra (ikën terri), ngaqë bëhet ditë. Dhe në ëndërr poetit nis t'i rrëfehet femra. Ai nis t'i kërkojë trajtat e fytyrës së saj dhe tutje, nis të shkruajë poezi për mungesën e saj.

Prej largësisë së pa anë kalon durimi mot-me-mot...
Pas kaq kohë dhembshurije, ndaj vënd-i lum as éja sot!

Në këtë mes të jetës dhe ëndërrimit lidhen dy kontekstet, ai i vendit dhe i kohës, të cilët edhe e ndezin farën e vetmisë për dashuri që i adresohet vashës, dhe në këtë tip teksti të adresuar (për Ty) nis të përafrohen çiftet, malli shuhet me poezi. Subjekti real tashmë shkruan për objektin. Para fytyrës së vet sheh figurën e saj. Edhe vetë atmosfera e figurave letrare poezinë e Lasgushit e bën të ndjejë mall për vetveten.

Malli për femrën në kërkimin e një lidhjeje të fortë shpirtërore i jep jetë edhe më të madhe poezisë së Lasgushit, saqë estetika e saj e bën tekstin që të funksionojë në një rreth të tërë metaforash.

Gazi midis dhembjes*

Poezia "Ata u deshën", e Henri Hajnes, frymon drejt rrugës së dashurisë. Personat kanë edhe karakteret e tyre, të cilat theksohen që në fillim: një çapkëne dhe një kusar, dhe midis tyre afshi i dashurisë.

Raporti mes çapkënes dhe kusarit ndërlidhet si raport i afërt mes dy të dashuruarve të zjarrtë, të cilët realizimin e dashurisë e bëjnë në një ambient krejtësisht të thjeshtë. Çapkënia nuk tronditet nga fjalët e pamenduara (mufkat) mirë të kusarit.

Ai i fliste, "O, eja këtu
se me merr malli kaq fort për ty.
Ty të thërres se do vdes", - i thoshte,
ajo tundte kokën dhe qeshte.

Ajo ndihet gazmore me mufkat e tij. Veprimet e saj janë të lazdruara. Nuk korrigjon të qeshurën e vetë, as veprimet e kusarit.

Mashkulli/kusari barazohet me njeriun që e vjedh dashurinë me dhunë, mirëpo përskaj tij qëndron edhe femra e papjekur, e cila këtyre veprimeve nuk ua vë vëmendjen.

Konvencioni kohor ditën-natën ("Ditën shkonin për bukuri; Natën ajo flinte mbi gjoksin e tij"), përforcon edhe më tutje qëndrimin ndaj njëri-tjetrit.

I dashuruari me fjalë çapkënesh i bën ftesë personit femër. Kjo pranon ofertën e dashurisë. I tërë afshi (zjarrmia) i mbledhur ditën realizohet natën. Mirëpo, dashuria e tyre shkëput marrëdhëniet. Kusari futet në burg. Çapkënia e mbetur vetëm nuk mërzitet. Sërish stili i saj gazmor e mbizotëron poezinë. Megjithëqë erosi është "infektuar", ai nga qelia e burgut sërish kërkon çapkënen.

Kujtesa e puthjes*

Poezia erotike e shkruar nga Kadareja ka një emocionalitet të fortë, një ritëm mjeshtëror. Matja e figurave të përzgjedhura e japin edhe më tutje të veçantën e saj. Këtu vërehet një vështrues. Poeti ka përpara dy personazhe, mashkullin/femrën.

Duke të puthur, pa të dashur
Në shpirt ai ty të plagojë
Buzëpërgjakur nga të kuqtë e tu,
si vrasës tinëz shkoi.

Përplasja e fshehtësisë së dashurisë, një dashuri e nisur me një puthje të rastësishme e ka bërë një histori rrëfimi. Vështruesi nis e rrëfen puthjen e tyre dhe ajo kalon në gojën e subjektit dhe më pas merr hapësirën, gjen pranim në vend të akëcilit. Një vajzë lidhet drejtpërdrejt me kujtimin e një të puthure, dhe nga këtu shenja e shfaqjes së personales mund të lakohet në situata të ndryshme të strofave. Komunikimi me vajzën ndërpritet. Kujtimi i asaj të puthure të befasishme nis të rrëfehet në prani të shokëve dhe nga aty nis të shpërthejë emocionaliteti. Në këtë kufi të figurës dhe emocionit, hyn edhe meditimi. Ai shfaqet si kapërcim nga gjendja e parë, dmth. në mungesë të ritmit emocional hyhet në bashkimin e kujtim/meditimit, nga ku tutje relacioni tredimensional: tekst, kujtim, ambient e bëjnë edhe farën e rrëfimit, një rrëfim hyrës, vazhdues dhe mbyllës për një kujtim të vetëm.

Diskursi i tekstit erotik ka një vetë, Ty. Pra teksti ka dy situata, një që i shmanget vetes së lirikës Unë, dhe tjetrën që lidhet veçmas me rrëfimin, Ty.

Kur paradokset e jetës i bëjnë miqtë të bashkuar në një atmosferë dhe në të shohin mikën përskaj rrugës, aty e rigjejnë edhe temën e bisedës. Vajza identifikohet me miken. Nuk i vihet emri, nganjëherë në prani të dialogut shqiptohet edhe me fjalët "filane", "E sheh filanen? E ke pas..." . Pikat e heshtjes e kanë edhe nëntekstin e tyre të veçantë, nëntekst i fshehur, ose i treguar në kafene, por jo në poezi, i cili nuk mund të thuhet drejtpërdrejt, ngaqë mund të zbulojë nëpërmjet gjuhës konotative disa situata të qeta, të buta, të cilat ruhen, luhen dhe rifreskohen në kujtesën personale.

Teksti mbyllet me kujtimin e vjetër që mund t'i rikthehet ndjenjës së rinisë, kur ashtu papritmas ndeshen midis rrugës dhe fillon dialogu mes shokëve për miken. Për ta ruajtur edhe më tutje shenjën e identifikimit të saj, asaj në dialog miqësish i thuhet: "E sheh filanen? Ishim miq...". ■

Udhëzues për nënat përkthyese

SI TA BËSH NJË KARRIERË NË SHTËPI SI PËRKTHYESE?

Një zyrë në shtëpi, veçanërisht një zyrë mamaje rrallë duket si një zyrë e vërtetë. Ndonjëherë një tavolinë kuzhinë pretendon të jetë një zyrë dhe një dollap muri ka dosje klientësh, që qëndrojnë pranë librave të fëmijëve. Por është e rëndësishme mbajtja e një imazhi profesional për klientët tuaj…



Elda CENALIA

Në këtë shkrim do të fokusohem mbi aspekte të rëndësishme të punës si përkthyes në një zyrë me bazë në shtëpi. Ky do të jetë një udhëzues i shkurtër i kësaj pune për përkthyesit, të cilët kanë fëmijë dhe të cilët të themi të vërtetën, janë përgjithësisht gra dhe nëna. Sigurisht, ky shkrim, gjithashtu u referohet edhe përkthyesve meshkuj, që punojnë në shtëpi, të cilët janë baballarë. Ata mund të zëvendësojnë fjalët nënë/grua/ajo në artikull me fjalët baba/bashkëshort/ai dhe anasjelltas – dhe sigurisht pranoni ndjesën time.

Caktimi i prioriteteve

Kur jeni një nënë që punon në shtëpi si përkthyese, gjëja më e rëndësishme është caktimi i prioriteteve. Sigurisht askush nuk pret nga ju të deklaroni nëse fëmijët tuaj ose puna juaj janë gjëja më e rëndësishme për ju, por është e qartë se prioritetet priren të ndryshojnë, duke u varur mbi disa faktorë. Kur vjen një projekt i rëndësishëm nga një klient, pjesa tjetër duhet të presë. Organizimi i kujdesit të fëmijëve, duke lënë pas dore detyrat e shtëpisë për pak kohë dhe duke u fokusuar në projekt, bëhet më e rëndësishme këtë herë. Kur rrjedha e punës është e ngadaltë, është më e rëndësishme të përqendrohesh te fëmijët, shtëpia dhe porositë e tjera. Për një të pavarur, i cili ka gjithashtu një punë të dytë me kohë të plotë si nënë dhe amvise, rrjedha e punës priret të vijë valë-valë (luhatet) për faktin se ajo nuk mundet dhe nuk do t'ia lërë gjithë kohën e saj sferës së reklamës, marketingut, ofertave për punë të reja etj. Prandaj një afrim real nuk do të llogariste mbi një karrierë kryesore menjëherë, si edhe një sasi parash pas një muaji përkthimi. Një zhvillim i ngadaltë, bazë e qëndrueshme e klientëve dhe caktimi i cilësisë para sasisë është qëllimi i suksesit. Nëse ju jeni i/e mirë, ata do të kthehen. Vetëm mbani në mendje prioritetet tuaja ditore.

Një afrim fleksibil (elastik) i Programit Tuaj

Ju mund të planifikoni në të ardhmen, por ju gjithashtu duhet të mbani mend se të gjitha planet mund të përfundojnë, duke qenë të padobishme. Afatet e fundit (deadline) të arsyeshme janë çelësi. Nëse ka ndonjë punë urgjente, ju nuk do të donit ta refuzonit, siguroni një ose dy mbështetje përsa i përket kujdesit të fëmijëve dhe çështjeve të tjera në këtë ditë ose javë. Nëse njëri nga fëmijët tuaj është i sëmurë ose ka një ndërprerje nga shkolla ose parashkolla, ju mund të zgjidhni të njoftoni disa klientë se ju nuk do të jeni në zyrë për disa ditë dhe shmangeni nga kërkesa ose pranimi i detyrave të reja. Kur gjithçka vjen menjëherë dhe zakonisht kështu me ndodh mua, përpiqu mos të lini në baltë asnjë. Duke punuar ore suplementare, duke marrë ushqim jashtë, duke neglizhuar shtëpinë për disa ditë dhe duke i shkarkuar fëmijët ndonjëherë tek tuk te një mik ose anëtar i familjes nuk do të lëndojë asnjë.



Ndërto disa plane emergjente të vogla. Mund të jetë e dobishme t'i shkruash ato në një kalendar muri – numrat e telefonit të miqve, pediatrit, duke lënë fundjavat të paplanifikuara, madje edhe duke shënuar kohët e ditës plot tension ose ato më pak të tensionuara me ngjyra të ndryshme në kalendar mund të ndihmojë. Mbani mend që të mbani mendjen tuaj të qetë.

Dikur pranova një detyrë mjaft të lehtë të caktuar në disa ditë, pagova një mik të mirë – një nënë që – qëndronte në shtëpi – që te rrinte me fëmijët e saj në shtëpinë time gjatë gjithë ditës për një javë dhe e mbaroi punën shkëlqyer – klienti ishte i gëzuar, fëmijët kishin shokë loje dhe mikja ime fitoi një sasi dollarësh për t'i mbikëqyrur ata.

Një Plan Rezervë

Një plan rezervë mund të përfshijë një mik siç u përshkrua më sipër. Mund të jetë një fqinj që kujdeset për një ditë ose bashkëshorti juaj mund të marrë disa orë pushim nga puna. Kur ju jeni i vetëpunësuar, nuk ka ditë të sëmura ose ditë familjare. Ju duhet të vini me zgjidhjet tuaja dhe mbani mend, në qoftë se u thoni "jo" shumë shpesh klientëve, ata mund të priren të largohen. Kështu që shkruani disa plane rezervë në rast të emergjencave të ndryshme, duke mos pasur ndërmend vetëm fëmijët e sëmurë, por gjithashtu një djalë riparues që vjen për të rregulluar çatinë tuaj ose marrja me një problem skedari HTML.

Mbajtja e një imazhi profesional

Një zyrë në shtëpi, veçanërisht një zyrë mamaje rrallë duket si një zyrë e vërtetë. Ndonjëherë një tavolinë kuzhinë pretendon të jetë një zyrë dhe një dollap muri ka dosje klientësh, që qëndrojnë pranë librave të fëmijëve. Por është e rëndësishme mbajtja e një imazhi profesional për klientët tuaj. E-mailet dhe fakset gjithmonë duhet

të shkruhen në një letër me kokë, të pastër, me firmë dhe në stilin e vetë biznesit. Nuk është e mjaftueshme kontrollimi i e-mail dhe faksit dy herë në ditë dhe nuk ka justifikim për këtë. Shumica e klientëve presin një përgjigje të shpejtë dhe profesionale për kërkesat e tyre dhe kini parasysh gjithashtu se, ata jetojnë në zona kohore të ndryshme. Ju keni nevojë për një linjë telefon dhe faksi të veçantë për biznesin tuaj. Përgjigjuni në telefon në mënyrë profesionale dhe mbani zërin e fëmijëve në sfond sa më në minimum – fëmijët e vegjël mund të "zaptohen" në rrugë të ndryshme, zakonisht duke lozur me diçka të qetë dhe/ose të ndaluar – enë kuzhine, gjë a gjëza të komplikuara, afishe, shënues me shkëlqim, ndërkohë që i rrituri në të vërtetë dëgjon kur ju u kërkoni atyre të qëndrojnë të qetë për 10 minuta. Mbani një vend të fshehtë për këto pranë telefonit tuaj të biznesit, që të jetë lehtësisht e arritshme në situata krize. Është e favorshme të merrni në telefon klientët tuaj kur fëmijët janë jashtë shtëpisë, por me thirrjet hyrëse kjo nuk është gjithmonë e mundur.

Opsione për kujdesin e fëmijëve


Ka opsione të ndryshme për kujdesin e fëmijëve, në varësi të moshës së fëmijëve tuaj, si edhe të situatës financiare tuaj. Fillimi është gjithmonë i vështirë, sepse ju merrni pak ose aspak para, por akoma përpiquni të kërkoni biznese të reja dhe të ndërtoni një bazë klientësh. Prandaj opsionet më të lira janë më të mirat në fillim. Duke punuar ndërkohë që një fëmijë është në shkollë, duke përdorur një kooperativë kujdestare fëmijësh ose duke dërguar fëmijët tuaj tek një i afërm ose miku juaj, i cili ka dëshirë t'i takoje ata falas (ka dëshirë), duken si zgjidhjet më të mira, në këtë pikë. Më vonë kur është themeluar një bazë klienti e fortë dhe ju vareni nga rrjedha e vazhdueshme e punës, një zgjidhje për kujdesin e fëmijëve më e qëndrueshme dhe më e shtrenjtë mund të aplikohet – një kujdestare fëmijësh, një ndihmës i nikoqires, një çerdhe fëmijësh ose një program pas shkolle etj. Mundësitë ndryshojnë në varësi të zonës, ku ju banoni. Rekomandohet t'i hidhni një sy të gjitha këtyre, shkruajini ato dhe vendosni për disa nga më të mirat, që ju përshtaten juve para se ju të nisni biznesin tuaj.

Qëndroni të qetë!

Gjëja më e rëndësishme e kësaj pune shumë të ngarkuar është bindja e vetes tuaj se ju mund ta bëni atë. Dy ditë nuk do të jenë të njëjta dhe ju nuk mund ta mendoni atë. Por mbani në mendje: ju jeni një individ elastik, i fortë, i cili mund t'u bëjë ballë ditëve të vështira dhe të gjata për të arritur qëllimin e saj ose të tij – stabilitet financiar pa i lënë fëmijët tuaj tetë orë në duart e një të huaji. Kënaquni! ■

Psikologji sociale

Zhurma, grumbull tingujsh që dëmton



Arber ZEKA

Zhurmë, konsiderojmë ç'do tingull, intensiteti i të cilit, mundë të shkaktoj dëme fizike apo psikike.

Perceptimi i zhurmës si gjendje stresuese, është dukuri psikologjike e cila në qoftë së ekspozohet shpesh, siç mund të ndodhë në rrugët përplot trafik, etj, mund të ndikojnë në mënyrë të padëshiruar në jetën e përditshme.

Zhurma është lloj gjykimi, së mesazhi i cili pranohet nga auditori është mesazh i pa pëlqyeshëm, i padëshiruar dhe irritues. Kështu për shembull tingujt e muzikës në autobus, përgjatë udhëtimit në një relacion, mund të jenë të këndshme për dikë, ndërsa për dikë tjetër që udhëton me të njëjtin autobus nuk paraqesin gjë tjetër përpos një zhurme, e cila i shkakton nervozizëm. Andaj, çdo tingull të padëshiruar, mund ta quajmë zhurmë.

Tingujt e zhurmës prodhohen nga ndryshimi në presionin e ajrit, dhe pastaj kapen nga organet e dëgjimit.

Si dallohet tingulli nga zhurma?

Ekzistojnë tri parime të cilat dallojnë tingullin nga zhurma:

I - sa më i madh është volumi i tingullit, aq më tepër ka mundësi të quhet zhurmë.

II - tingujt e paparashikuar dhe të pa kontrolluar, janë tinguj irritues se sa tingujt të cilët mund të kontrollohen, dhe

III - përcaktimi i zhurmës varët edhe nga qëndrimet dhe besimet tona për zhurmën dhe burimet e saj.

Forma se si Zoti i ka krijuar njeriun është e përsosur, por kjo i përket aspektit fizik të tij, dhe nuk përfshinë atë psikik. Kjo nënkupton se njeriu duhet të mësohet edhe t'i përshtatet rrethit të tij, i cili jo rrallë pengon individin në forma të veçanta. Shembull i kësaj mund të jetë takimi me zhurmën. Fillimisht stresohemi dhe gjithashtu irritohemi nga ajo por pastaj nevoja na shtyn të mësohemi me të, dhe bën që t'i përshtatemi ambientit ku jemi, duke frenuar vetën nga ndonjë veprim i pa hijshëm.

Përshtatja në këto raste ka çmim psikologjik, për arsye së individi shpenzon energjinë e tij psikike, në procesin e adaptimit.


Pragu i dëgjimit është 0 decibal (dB)
Biseda normale është 40 decibal (dB)
Zhurma në një rrugë përplot më njerëz dhe trafik të stërngarkuar është 70 decibal (dB)
Zhurma e një koncerti të rokit është deri në 130 decibal (dB).

Dëmton apo nuk dëmton zhurma?

Dëmton apo nuk dëmton zhurma është një pyetje që e ka shtyrë psikologun social Cohen dhe shumë kolegë të tij të merren më këtë fenomen përgjatë viteve 1980-1986, me të vetmin qellim, që të kuptohet efekti, dëmi apo dobia e zhurmës në njerëz.

Hulumtimi i tyre ka treguar anën negative të zhurmës te njeriu, si në aspektin fizik edhe në atë psikik: dhimbje koke, sëmundje zemre, alergji dhe çrregullime të tretjes, rritje të mortalitetit te fëmijët e të rriturit, sëmundje mendore si dhe konflikte ndërpersonale dhe impotencë.

Nga studiues të ndryshëm (Smith, Mathewes, Canon dhe Stanfeld) është konstatuar s zhurma ndikon në sjelljet prosociale dhe antisociale, dhe në këtë rast jo vetëm që redukton altruizmin, por edhe rrit agresivitetin, dhe ky i fundit (agresiviteti) mund të ulet vetëm në qoftë së zhurma mund të arrihet të futet në kontroll dhe të arrihet procesi i adoptimit.



Një studim i bërë nga Smith dhe Stanfeld në njërin nga universitetet e psikologjisë sociale në SHBA, ka zbuluar se zhurma ndikon te të rriturit në jetën e përditshme. Në këtë studim është vërtetuar së njerëzit të cilët jetonin të rrethuar nga zhurma, kishin prirjen të bënin më shumë gabime në detyrat e thjeshta që u parashtrheshin, të harronin gjerat e zakonshme dhe madje shumë lehtë t'iu binin sendet nga dora.

Zhurma sigurisht së është e pa pëlqyer, por shpesh ne jemi të detyruar të pajtohemi më të.

Studjusit si Mathewes dhe Canon kanë zbuluar se njerëzit kishin më pak të ngjarë t'a ndihmonin dikë të ngrinte librat e rrezuara, kur ata ndodheshin në një zhurmë prej 85dB. Rezultati ishte i njëjtë edhe në kushte laboratorike, por edhe në kushte të lira, përkatësisht në rrugë, ku zhurma u krijua nga një makinë që kosiste barin.



Studimet e tjera kanë treguar se njerëzt cilët jetojnë të rrethuar nga zhurma, kanë më pak ndërveprime shoqërore, janë më agresiv dhe kanë tendencën më të madhe të mos i pëlqejnë fqinjët.

David Glass dhe Jerome Singer, gjatë një studimi të tyre, kanë vendosur njerëzit në një mjedis zhurme dhe njërit grup i kanë thënë se mund ta kontrollojnë zhurmën më një çelës, ndërsa grupit tjetër se nuk mund ta komandojnë zhurmën. Më pas, të dy grupeve iu parashtrua një detyrë mjaft e thjesht me ç'rast grupi i cili kishte mundësinë e kontrollimit të zhurmës kishte dalë më i suksesshëm së sa grupi tjetër i cili nuk e kishte këtë mundësi. Kjo ka bërë që studiuesit Glass dhe Singer të përfundojnë se zhurma është burim stresi dhe së stresi i pa kontrolluar të qon të një ndjenjë e pa shpresë. Kështu, pjesëtarët me mundësi kontrolli të zhurmës mund të çliroheshin nga ndjenja e të qenit i pa shpresë në saje të besimit se ata mund ta kontrollonin shkakun e saj, pra zhurmën. Andaj kjo tregon se zhurma si stersor luan rol të madh në përcaktimin e reagimeve tona. ■

PËRÇAPJET DREJT FAMILJES SË SHËNDOSHË

Nëse raportet prindër fëmijë janë të ftohta, të largëta dhe nuk ka një afinitet të mirëfilltë ndërmjet tyre, si konsekuencë e saj, fëmija kur të rritet do të ketë vështirësi të shumta



Mirsad KUTELI

Kur përpiqemi të krijojmë një familje të shëndoshë, duhet që një rëndësi të veçantë t'ua kushtojmë edhe imtësive, për të cilat shpeshherë nuk na ka rënë ndërmend më parë. Ne kemi përgjegjësi për familjen, por në veçanti për fëmijët tanë. Nuk duhet harruar se fëmijët janë trashëguesit më të denjë të prindërve të tyre. Me këtë rast, ne duhet që së pari të kemi sjellje shumë korrekte, në mënyrë që këtë t'ua bartim atyre, që t'u shërbejë si bazë e fortë për të ardhmen.

Kur prindërit fillojnë të krijojnë raporte rigjide me fëmijët e tyre, duke u paraqitur qartë dy shkallët dalluese, si ajo e superioritetit dhe e inferioritetit lidhur me trajtimin e fëmijëve; pra niveli i më të fortit ndaj më të dobëtit; me këtë rast fëmija gjithnjë do të ketë ndjenjën e frikës, ndjenjën e më të dobëtit etj. Andaj, kjo ndjenjë do ta përcjellë atë edhe kur ai të jetë rritur.

Nëse raportet prindër fëmijë janë të ftohta, të largëta dhe nuk ka një afinitet të mirëfilltë në mes tyre, si konsekuencë e saj, fëmija kur të rritet do të ketë vështirësi të shumta. Si vështirësi primare do të jetë raporti i tij me shoqërinë dhe rrethin ku jeton, studion apo punon. Gjatë punës, ai gjithnjë do të qëndrojë larg. Nuk do t'i afrohet realitetit, për shkak të frikës së trashëguar. Në këtë rast, fëmijët nuk duhen frikësuar, duke ua paraqitur botën reale me atë areale, si fantazia apo fantazmat. Mirëpo, në këtë drejtim duhet të ndodhë e kundërta. Ata duhen të kurajohen dhe të trimërohen, në mënyrë që kur të rriten të bëhen të guximshëm që të përballen me sfidat e jetës që do t'ju paraqiten. Me vet faktin se jeta është përplot sfida. Ndaj, duhet që të jemi të përgatitur qysh në këtë fazë, që fëmijët të kaliten në atë mënyrë që në të ardhmen të jenë në gjendje të përballen me probleme dhe rreziqe.

Në vijim do t'i elaborojmë veçanërisht raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve që shpeshherë është debatuar si përplasje e gjeneratave, apo si një problem që gjithnjë duket të jetë aktual.

Raportet shoqërore prindër fëmijë

Nëse prindërit arrijnë të krijojnë raporte të mira e shoqërore me fëmijët e tyre, ky do të ishte një lehtësim shumë i madh për fëmijët që në fazën e rritjes së tyre të shoqërohen me shokët dhe shoqet që mund të hasin gjatë rrugës së tyre jetësore. Mirëpo, si çdo gjë tjetër e tepërt që është e dëmshme, duhet një kujdes i veçantë edhe në këtë pikë. Nuk duhet tepruar edhe shoqëria me fëmijët, ngaqë mund të ketë kundërefektet e veta, si: humbja e respektit si prindër, shakaja e tepruar, që mund të bëhet shprehi dhe të aplikohet pastaj edhe në praninë e të tjerëve etj.

Këto janë disa nga efektet negative. Mirëpo, nuk duhen lënë pa përsëritur edhe efektet pozitive. Nëpërmjet raporteve të mira shoqërore prindër-fëmijë, arrihet një gjuhë e përbashkët, ku liria e shprehjes do të jetë shumë më e madhe nga të dyja anët. Por, më e theksuar do të jetë liria e shprehjes së fëmijës, që te ne deri më tani ka qenë shumë e limituar. Kjo dhe është më e rëndësishmja, për faktin se në shoqërinë tonë ka çuar drejt shumë problemeve të mëdha, madje ka pasur edhe viktimat, si konsekuencë e relacioneve të dobëta prindër-fëmijë, apo thënë më mirë raporteve ndërfamiljare.


Në këtë aspekt, duhet gjithashtu ta dimë se fëmija gjatë periudhës së adoleshencës ka kërkesa të mëdha. Një prej këtyre kërkesave është edhe liria e të shprehurit apo thënë më mirë, liria e bashkëbisedimit të lirë, në mënyrë që të krijohen raporte të tilla, ku do të merrte sugjerime pa hezitime. Kjo, rëndom nuk ka ndodhur në shoqërinë tonë. Biseda dhe këshillimet e tilla me prindërit ende konsiderohen të turpshme në një masë të gjerë të popullatës sonë. Këtu bëhet fjalë për shprehjen e emocioneve dhe ndjenjave të privatësisë së fëmijëve. Posaçërisht raste të tilla paraqiten në fazën para maturisë, kur ata e ndjejnë se kanë hyrë në atë periudhë, por që faktikisht gjenden në zgrip të saj, por edhe gjatë fazës së maturisë kur duhet vendosur për fatin e tyre.

Nëse arrihet të tejkalohet me sukses kjo fazë, atëherë të gjitha gjërat do të kishin konsekuenca pozitive. ■



DIABETI - EPIDEMI E SHEKULLIT

Sipas hulumtimeve dhe studimeve të OBSH-së (Organizata Botërore e Shëndetësisë) në vitin 2025 do të ketë mi 300 milionë të sëmurë nga diabeti, ndërkohë që në këtë vit numërohen rreth 170-180 milionë diabetikë. Ndërkaq në vendin tonë numri i diabetikëve ka arritur në 2 deri 3% të popullsisë dhe kjo shifër, sipas hulumtimeve të bëra, do jetë gjithmonë në rritje. Diabeti si sëmundje përfshinë rreth 5 % të popullsisë së botës, kurse afër 7 % janë paradiabetikë.



Artan BEJTA & Iliriana ALLOQI

Diabeti është sëmundje e çrregullimit të metabolizmit të glukozës (sheqerit) që reflektohet me paraqitjen e sasisë jonormale të saj në gjak. Ky defekt i metabolizmit të glukozës qëndron në pamundësinë e insulinës (hormon i prodhuar nga pankreasi), për të mbajtur nivelin e sheqerit në gjak në vlerat normale. Arsyeja pse rritet niveli i sheqerit në gjak qëndron në atë se insulina ose prodhohet pakë (pamjaftueshmëri e pankreasit) ose nuk vepron si duhet për ta ftuar sheqerin brenda në qelizat e indeve të organizmit (pamjaftueshmëri e insulinës), e si pasojë e kësaj qeliza vuan për sheqer ndërsa në gjak ka sasi të madhe të tij. Kjo sasi e sheqerit në gjak manifestohet me shenja të ndryshme si etja, shtimi i oreksit, shtimi në peshë, nevoja për urinim të shpeshtë, lodhja e shpejtë e sidomos gjatë punëve të rënda, ulja e vëmendjes dhe e përqendrimit...

Sipas hulumtimeve dhe studimeve të OBSH-së (Organizata Botërore e Shëndetësisë) në vitin 2025 do të ketë mi 300 milionë të sëmurë nga diabeti, ndërkohë që në këtë vit numërohen rreth 170-180 milionë diabetikë. Ndërkaq në vendin tonë numri i diabetikëve ka arritur në 2 deri 3% të popullsisë dhe kjo shifër, sipas hulumtimeve të bëra, do jetë gjithmonë në rritje. Diabeti si sëmundje përfshin rreth 5 % të popullsisë së botës, kurse afër 7 % janë paradiabetikë.

Sipas shkakut që u përmend më lart diabeti ndahet në dy forma ose tipa dhe atë: Diabetes Mellitus tip I dhe Diabetes Mellitus tip II që sidoqoftë kanë lidhje të përbashkëta.

Diabeti tip I

Quhet ndryshe edhe diabeti juvenil ose diabeti i të rinjve. Siç vërehet edhe nga vetë emri që ka marrë, fillon në moshat e reja nën 25-vjeçare madje shpesh fillon në fëmijërinë e hershme. Sëmundja paraqitet papritmas dhe fillimi i sëmundjes është i rëndë.

Te ky tip i diabetit pacienti ha shumë, pi shumë, urinon shpesh, humb në peshë, dhe mund të ketë kriza të ketoacidozës diabetike. Pasi që rezervat e insulinës te ky tip i diabetit janë të ulura është e nevojshme që ai të mjekohet me insulinë. Me fjalë të tjera të sëmurët me diabetin juvenil janë vartës të insulinës.

Insulina merret nën lëkurë, çdo ditë në kohë të caktuar, gjysmë ore para marrjes së ushqimit. Doza e insulinës përcaktohet me njësi internacionale. Në fillim insulina jepet nga personeli mjekësor e më vonë pacienti (ose anëtari i afërm i familjes) mësohet dhe edukohet për mënyrën e dhënies së insulinës.

Diabeti tip II

Njihet edhe me emrin diabeti adult ose diabeti i të rriturve. Fillon në moshat e rritura në mënyrë graduale, shpeshherë në mënyrë të pakuptueshme.

Rezervat e insulinës në pankreas gjatë diabetit adult janë normale, prandaj te ky tip nuk ka nevojë mjekimi me insulinë. Në përgjithësi kuptohet se ky tip i diabetit është më i lehtë se diabeti tip I.

Shenjat dhe simptomat te ky tip i diabetit janë: dehidrimi, polidipsi (pirje e madhe e ujit), polifagi (oreks të shtuar), poliuri (urinim i shpeshtë), humbje peshe, lodhje etj.

Parandalimi

Rritja e moshës, prania e mbipeshës dhe aktiviteti i ulët fizik janë faktorë që favorizojnë shfaqjen e sëmundjes. Për shkak të shkallës së lartë të glikemisë, mund të

Personat e predispozuar nga diabeti

Kohët e fundit është arritur në përfundim se gjinia mashkullore kanë predispozitë për t'u sëmurë nga sëmundja e sheqerit. Po ashtu shumë studime flasin se sëmundja e sheqerit paraqitet më shpesh te:

-Personat me anamnezë familjare të diabetit;

-Personat me anamnezë familjare me sëmundje kardiovaskulare;

-Personat me masë trupore të rritur;

-Personat që kanë çrregullim të oreksit (ndjejnë mundim në rajon të lukthit, djersitje, ngacmueshmëri);

-Gratë me shtatzëni patologjike (lindjet e parakohshme, abortet spontane, fëmijë të lindur me peshë mbi 4 kg, fëmijë të lindur të vdekur) etj.



vijë edhe deri te koma diabetike, dëmtimi i syve dhe komplikime të tjera përcjellëse.

Për të mos ardhur deri te kjo gjendje, për të sëmurit me diabet janë shumë të rëndësishme: dietat dhe aktiviteti fizik. Të kemi parasysh që: ushqimi të ketë përbërje adekuate; të jetë i shumëllojshëm dhe me shije; të jetë i shpërndarë në intervale kohore të rregullta gjatë ditës; të sigurojë energji të mjaftueshme etj.

Gjatë dietës duhen të merren së paku 100 g karbohidrate, më pak yndyra dhe proteina, sheqeri duhet të eliminohet, ndërsa buka mund të përdoret por është e posaçme për diabet.

Nga pemët mund të përdoren mollët e tharta, qershitë, kivi, dredhëza, vishnje, limonë, portokaj, mandarina etj.

Është mirë që perimet të merren në formë sallatash ose të ziera.

Duhen të përdoren lëngjet e pemëve pa sheqer, çaj, kafe në sasi të vogël dhe ujë mineral.

Yndyrat me prejardhje shtazore është mirë të eliminohen nga ushqimet, ndërsa vajrat dhe yndyrat me prejardhje bimore mund të përdoren.

Sa i përket mishit preferohet ai i peshkut, i shpezëve dhe i viçit. Nëse është dieta hipokalorike apo pacientja është shtatzënë atëherë duhet shtuar minerale dhe vitamina në formë tabletash.

Ndërsa ato që nuk lejohen të përdoren dhe që duhet gjithsesi të informohen pacientët janë: Duhani, alkooli, buka e bardhë, brumërat, gjalpi, ëmbëlsira, çokollatat, bonbonet, akulloret, sheqeri, majoneza, qumështi me shumë yndyrë, kosi i deleve, kajmaku, djathi i yndyrshëm, mishi i konservuar, të verdhët e vezës, bananet, shalqiri, pjepri, rrushi i tharë etj.

Aktiviteti fizik po ashtu është masë ndihmëse për mjekimin e diabetit. Në rreth 80 % të personave është shumë i domosdoshëm aktiviteti fizik i cili duhet të jetë i përditshëm - 2 herë nga 20-30 minuta (ecje e shpejtë, ngasje biçiklete, gjimnastikë etj).

E gjithë kjo ndihmon në një funksionim normal të organeve të ndryshme e po ashtu edhe organizmit në tërësi dhe ruajtjen e peshës normale.

Sipas një studimi të këtyre ditëve, të kryer në spitalin e Brighamit në të cilin janë përfshirë 150 gra, është vërtetuar se ushqimi i foshnjave me qumësht gjiri ndihmon jo vetëm për mirërritjen e tyre, por edhe për pakësimin e rrezikut të diabetit te nënat. Mjekja Alison Stuebe nga spitali Brigham thotë se gjatë studimit është vënë re që ushqimi i foshnjave me qumësht gjiri për një vit ul 15 % rrezikun e prekjes nga diabeti te nëna.



Mjekimi simptomatik

Për lehtësimin e sëmundjes mjekët rekomandojnë që mjekimi të bëhet duke i luftuar pasojat (simptomat) dhe jo shkaqet që e shkaktojnë atë. E me këtë nënkuptojmë se shumë ilaçe për diabetin parandalojnë atë që diabeti shkakton si: etjen e tepruar, urinë, urinimin, iritimin, dobësinë dhe lodhjen.

Komplikimet e “diabetit mellitus”


-Infeksionet nga bakteret e ndryshme;

-Sëmundja vaskulare (e enëve të gjakut): Prekja e enëve të mëdha, sëmundje koronare;

Neuropatia: pakësim i ndjeshmërisë në gjymtyrë, parestezi, djegie e duarve, pamjaftueshmëri autonomike - parezë gastrike dhe impotencë.

Këshillë për fund

Nëse keni simptomat (shenjat) e cekura më lart është shumë e arsyeshme që ju ta vizitoni endokrinologun (mjeku specialist për këtë lëmi), në mënyrë që sëmundja të zbulohet sa më herët. Kjo do të ndihmonte që i sëmuri mos të pësojë lëndime të tjera, të ketë kujdes se çfarë ushqimi të konsumojë, ta kontrollojë sa më shpesh që mund nivelin e sheqerit në gjak etj. ■



Fjalëkryqi

fjalekryqi.com

Renesansa shqiptare

Djalë

Kongresi i Alfabetit

Aziz Nimani

fjalekryqi.com

Që ka valuar në ujë

Lidhja kur u formua qeveria e parë shqiptare

Lloj peshku, lojbë

Vajzë e bukur nga mitologjia greke e romake

Shpend uji

Hov, vrull / Ai (fr.)

Të qesëndisurit

Natyralisti suedez, Karl

Jepem shumë pas dikujt / Austria

Nyja e përparme e mbiemrave mashkullorë

Galiumi / Lloj vepre muzikore

Spanja, jodi / Fyt (anatomi)

Fluori / Copë e rrjepur lëkure

Shpend i madh uji

Periudha gjuhësore / Te, tek

Një nga pesë kohët e namazit

Eduard (shkurt)

Kali i shalës

ISh-lideri palestinez, nobelisti, Jaser

Atëherë / Njëri prej bijve të Adamit

fjalekryqi.com

Tërësia e të dhënave numërore

Fuqidhënëse (barna)

Radiusi

Amperi

Ngjyra e lëkurës së fytyrës

Babai / Lumë në Austri

Vezët e peshqve

Shkrimtari arbëresh, Albert

Poet i madh i Rilindjes Kombëtare

Toriumi

Eci nëpër trap

Shumë i madh / Zero

Përzierja e bakrit me karbon

Film i Stiven Spilbergut

Tërësia e fjalëve me kuptim të kundërt

Shkresë zyrtare

Numri / Radikal

Televizioni / Pikërisht

Qytet bregdetar në Liban

Intensiteti / Ujdhesë kroate

Pus uji / Zbukurimet në rroba

Aktorja frënge, Anuk

Fluturuesi i parë mitologjik

Lëmsh fijesh / Radio

Tokat që mbillen

Fytyrë / Barabar

Punim i veçantë shkencor

Personeli / Cohë leshi (sh.shq.)

Metri / Impresionet

Toni

Ilir Berani / Vegël që kreh kafshët

Diçka që ndodh / Mënyra e veprimit

Tempi / Besnik (dim.)

Numër i panjohur

Lloj pushkësh të vjetra / E dashura e Nik Petës

Bori, azoti / Lloj rrjete e madhe peshkimi

Kafshë pune

Gur qiellor / Nocion shkencor

Direk / Njeri i guximshëm

Akishtat

Bisk, filiz

Pemë bregdetare / Lloj qëndisjeje

Shkrij diçka të ngurtë / Gari Kuper

fjalekryqi.com

Aerodrom / Mehmet Kajtazi

Kallamaz / Në ç'masë?

Mirënjohja

Ai që rrëshqet me ski / Italia

Zotëroj diçka

Plogështia

Krahinë jona